

SHAQIR FONIQI

BIBLIOTEKA

FB
F 78

**NEXHMIJE
PAGARUSHA**

Billili i Kosovës

BOTIMET TOENA


F8.071 (= 18:497.115)(092,
929/497.115) [Gaga ku. Lu,
Nexlimije.]

78
F 78

Shaqir Foniqi

NEXHMIJE PAGARUSHA

Bilbili i Kosovës



BOTIMET TOENA
Tiranë, 2003

Botues: Fatmir Toçi
Redaktor: Skënder Hasko
Recensentë: Ramiz Kelmendi, Rexhep Munishi
Korrektor letrar: Tahir Foniqi
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Lavdie Cenmurati
ISBN 99927 - 1 - 695 - 9
© Autori

BOTIMET TOENA

Rr. "Muhamet Gjollësja", K.Postare 1420, Tiranë
Tel.: (355) (4) 240116; 240117
Tel./Fax: (355) (4) 240117
E-mail: toena@icc.al.eu.org
Http://www.toena.com.al

*“Nexhmijen nuk mund ta krahasoj me
asnjë këngëtare, sepse mendoj do ta fyeja”*

Juliet Greko
Prishtinë, 1995

BILBILI YNË
(fragment)

Nexhmije Pagarushës, që me zërin e saj na e rrit namën.

...Kur ia thotë këngës Këngëtarja - disi ta pahit edhe malli i kurbetçinjve, edhe shkrumi i të privuarve të drejtash; dhimbja dhe rebelimi i dikurshëm: mospajtimi me padrejtësitë dhe robërinë.

Kosovën, duhet ta dish e ta ndiesh me tërë qenien.

...Pse, ai që njëherë e njeh, do t'i mbetet në zemër perherë?

Edhe natyra e saj,

Edhe njerëzit e saj,

Edhe vallet e këngës e saj, që mahnisin gjithkënd që i sheh dhe i dëgjon.

Në këtë bukuri, në atë vrere dhe në këtë gazmend, lindi dhe u rrit Këngëtarja... Ajo që, si askush tjetër, këndoi me gjuhën e shpirtit e të gjithë neve për fushat pjellore dhe malet tona flladitëse, pikëllimin e thellë për kurbetçinj që s'kthehen më, për të shpërngulurit e mjerë.

Dashurinë që, askund si këtu, në këngën e Saj, të çon peshë, të lartëson...

Sepse - Nexhmija është, kjo moti thuhet: Bilbili i Kosovës, bilbili i Këngës sonë.

Esad Mekuli
(*"Feta e re" nr. 4/ 1974*)

Në vend të parathënies

Nexhmije Pagarusha u lind më 7 maj 1933 në Pagarushë të Malishevës, nga i ati Veseli dhe e ëma Sahidja.

Ishte fëmija i parë, gëzimi i parë në familje. Ajo pati shtatë vëllezër: Abdylkadërin, Burhanin, Fitimin, Tarikun në jetë dhe Burhanin, Tarikun e Siberajn, të cilët kanë vdekur.

Qysh në moshën katërvjeçare Nexhmija mbetet pa nënë, prandaj kujdesin për të e merr përsipër i ati, Veseli dhe më vonë njerka Zymrytja, për të cilën Nexhmija do të shprehje me këto fjalë: “Më duhet të them se krah të fortë dhe ndihmë të madhe gjatë jetës më ka ofruar njerka ime Zymrytja. S’kam fjalë për të shprehur mirënjohjen time ndaj saj për të gjithë të mirat që më ka bërë. Atë e kisha prehrin e dytë të nënës...”

Babai i Nexhmijes, Vesel Pagarusha, ishte ndër mësuesit e parë të kësaj ane dhe ithtar i zellshëm i arsimimit. Përhapjen e alfabetit shqip e bënte përmes një shufre të zgavruar përbrenda, e cila nuk linte përshtypje se aty, në shufër, mund të ketë “material propagandues armiqësor”. (Shkolla në Pagarushë tani mban emrin e tij).

(Vesel Pagarusha u lind me 25 maj 1903 në Pagarushë të Malishevës. Qysh në rini ishte përcaktuar për liri sociale dhe nacionale të shqiptarëve, prandaj shpejt u bë mësues dhe demokrat i kohës. Kur ishte 15 vjeç, ai u njoh me Azem Galicën dhe Hasan Prishtinën, duke siguruar vend nderi në mesin e burrave me influencë në Lëvizjen Kombëtare Demokratike të

kohës. Ai ishte ndër mësuesit e parë të mësimit laik shqip në rajonin e Drinisë (Podrimë). Disa herë u keqtrajtua nga regjimi i kohës për shkak të veprimtarive të tij patriotike.

Ishte përkrahës i Qeverisë së F. S. Nolit, prandaj Veseli në këto rrethana shpejt u gjend i burgosur në Krujë (1924) bashkë me Shote Galicën. Si luftëtar i paepur, shpërndante kudo librin shqip dhe mbillte me kujdes idetë për rezistencën shqiptare. Në vitin 1928 Veseli mbaroi në Tiranë Medresenë e cila kishte rang të gjimnazit klasik. Në Shqipëri Veseli qëndroi deri më 1932 e pastaj kthehet në Kosovë, ku shpejt bie në sy të xhandarmërisë dhe futet në indeksin e tyre. Veprimtaria e tij patriotike nuk u shua deri në fund të jetës. Vdiq më 1960, por respekti për të përcillet brez pas brezi. Shkolla tetëvjeçare e fshatit Pagarushë tani mban me mburrje emrin e tij.) (M. Pirraku)

Veseli kishte dëshirë që vajzën, Nexhmijen, ta bënte shembull të femrës së shkolluar shqiptare, e cila edhe do të thyente “akullin” e para.

Shkollën tetëvjeçare Nexhmija e kreu në Rahovec e Prizren, kurse tre vjetët e shkollës së muzikës i mbaroi në Beograd.

Qysh në fëmijëri te Nexhmija u vu re një talent i jashtëzakonshëm për këngën.

“A thua lindi një yll i këngës”? - pyesnin ata, që kishin rastin të dëgjonin zërin e saj të ëmbël.

Këtu ekziston një koincidencë, jo e rastit. Emri Nexhmije, në gjuhën arabe, do të thotë yll.

“Isha në klasën e katërt të shkollës fillore në Rahovec. U organizua një shfaqje për nxënësit. Unë këndova, natyrisht, pa përcjellje muzikore. Nuk e prisja se kënga ime do t’u pëlqente aq shumë”, kujton sot Nexhmija dhe shton: “Babai im, Veseli, shpesh këndonte, ndoshta kështu përpiquej të bënte që të harroja nënën, të cilën nuk e njoha mirë. Pra, babai dhe unë shpesh këndonim në duet. Por, më duket se këngën ma mësoi melosi i bukur popullor shqiptar.”

“Nexhmija shpesh këndonte në orët e muzikës, por mund të thuhet se dëgjuesin e parë besnik e kishte babain, i cili e përkrahu gjatë gjithë jetës.

Megjithatë, ai nuk arriti ta shihte Nexhmijen, ashtu siç dëshironte. Vdiq më 1966, kur Nexhmija ishte 28 vjeç.” (Z. Çelaj)

Pas gjashtë vjetësh, Nexhmija nga Pagarusha shpërngulet në Prizren, kurse më 1947 shkoi në Prishtinë, ku u regjistrua në gjimnaz, por angazhohet edhe në teatër, në shfaqjet “Martesa” dhe “Zjarri e hiri”. Ishte femra e parë që, bashkë me Meribane Shalën dhe Katarina-Kati Josipin, luante në dërrasat e teatrit.

Për Katarina Josipin, Nexhmija shprehet kështu:

“Kati ishte një. Ka qenë dhe do të mbetet jona dhe jo vetëm jona. Jetoj në një vend të vogël dhe fatkeqësisht nuk mundi të njihej në botë. Kati jetoj vetëm për skenën”.

Pasi mbaroi shkollën tetëvjeçare, me pëlqimin e babai dhe tani me përvojë këndimi, më 1950 Nexhmija shkoi në Beograd. Me këngën: “Dashnor t’u bana” kaloi audicionin rigoroz, që i hapi rrugën e afirmimit. Meqë babain e kishte të sëmurë, braktisi Beogradin, për t’u kujdesur për vëllezërit. Më 1956 inkadrohet nëpunëse në Radio Prishtinë, ndërkohë që martohet me kompozitorin e shquar Rexho Mulliqin, i cili tashmë kompozonte për Nexhmijen, duke e afirmuar bashkë me melosin shqiptar.

Më 1948, për herë të parë, mori pjesë në audicionin e Radio Prishtinës. “E kisha një shoqe që këndonte bukur, të cilën shpesh e shoqëroja në këngë. Ajo, Melihate Hasani, profesoreshë e anglishtes, më tha, se edhe unë kisha zë të bukur. Kështu, me propozimin e saj, u futa në studion e Radio Prishtinës, për t’i mbetur besnike gjithmonë këngës”.

Me mirëkuptimin e babait, Veselit, Nexhmija i dha krahë këngës dhe u nis drejt rrugës së afirmimit të plotë, me çka shprehu gjenialitetin e saj. Nexhmija tashti do ta përsosë zërin dhe do të bëhet interpretuese e denjë e melosit popullor. Ajo nisi t’i japë hov këngës aty rreth viteve pesëdhjetë, bashkë me Zyhra Mulën,

Meserete Çavollin, Melihate Hasanin, Vera Shahtën e Sanije Shalën.

Zëri i saj i çiltër dhe kumbues bëri që t'i përfitojë të gjithë adhuruesit e këngës shqiptare. Kur mernte hov kënga e saj, "kutia e vogël" - radio, sikur pëlciste nga mëria!

"Kur këndonte Nexhmija, zogjtë këngëtarë heshtnin", - do të thoshte poeti. Me zërin e saj, melosin e bukur shqiptar do ta ngrinte në nivel të lartë artistik dhe do ta afirmojë kudo nëpër botë.

Nexhmija këndoi vetëm shqip, krahas Marie Krajës, Naile Hoxhës dhe Vaçe Zelës. Për V. Zelën shprehet kështu: "Nuk kam parë shkëlqim më të bukur që del nga shpirti i njeriut sesa tek ajo".

Më vonë Nexhmije Pagarusha do të marrë me meritë epitetin "Bilbil i Kosovës".

U quajt me të drejtë "Poezia e gjallë e kombit", "Primadona e melosit shqiptar", "Mbretëresha e këngës shqipe", "Ima Sumak shqiptare", "Madam Baterflaj", "Zëri i artë", "Fyti i kristaltë" etj.

Kënga popullore shqiptare do të bëhet bashkëudhëtare e Nexhmijes plot dyzet vjet. Ajo kishte lindur për këngën, jetoi me të dhe, siç thotë vetë, "do të vdes me të".

"Kënga nuk po ma linte shpirtin të qetë dhe më kishte rrëmbyer të tërën", rrëfen Nexhmija e thyer në moshë e cila, së bashku me djalin Leonardin, të renë Janën (sllovene), mbesat e nipin, jeton në lagjen "Dardania" të Prishtinës me kujtimet e stuhishme të së kaluarës.

Filloi me këngën e parë "Çou, more Rexho", për të kënduar pastaj dhe rreth 150 këngë të tjera, si: "Baresha", me tekst të Rifat Kukajt, "Dashnor t'u bana", "O kjo anë e lumit ka bilbila shumë", "Shtatë palë lodra", "Kur ta fala një tufë gërshetë", "Një lule", "Lulëzoi fusha", "Sytë për ty i kam të njomë", "Unë ty, moj të kam dashtë" e sa e sa këngë të tjera të kompozuar nga Rexho Mulliqi, Lorenc Antoni, Isak Muçolli, Fahri Beqiri, Krist Lekaj, Gazmend Zajmi, Severin Kajtazi e të tjerë.

Nexhmija kishte një ambitus të gjerë prej altoje e deri në sopran të shkëlqyeshëm.

“Zëri i saj i pastër, si një burim, buçiste si rrjedhja e ujit të ujëvarës, i këndshëm si puhia e verës e kaplon njeriun, e bën për vete, e magjeps, duke u detyruar që ta ndjekë këtë deri në fund rrugën dredharake, me kthesa të pandieshme, të këtij zëri.” (R. Surroi).

Nexhmije Pagarusha, interprete, artiste e merituar, ambasadore e miqësisë, heroinë e ditëve tona, e bëri të njohur këngën shqipe në “Shtatë Evropa”, siç thotë populli. Zëri i saj argëtoi, por edhe emancipoi.

Zëri i thekshëm i Nexhmijes grisi fereksenë dhe shpërndau mykun shekullor.

Ajo kurrë nuk u pendua që iu përkushtua këngës. Madje është këngëtarja e parë që këngën e pati profesion. Kënga e bëri të madhe dhe nga ajo mori shumë duartrokitje e falënderime.

Ishte në Izrael, Shtete e Bashkuara të Amerikës, Gjermani, Austri, Shqipëri, Itali, Bullgari... Në Tel Aviv e popullarizoi interpretimin e këngës, “Hava Nagilla”, për të cilën i thanë se atë askush nuk e ka interpretuar më mirë.

Ajo kudo sillte mallin e vendlindjes, kurse bashkatdhetarët i mbushte jetë e mallëngjim. E për gjithë këtë kishte një porosi të madhe: Të mos harronin atdheun e tyre - Kosovën.

“Suksesi i çdonjërit është sukses i këtij trolli”, thotë Nexhmija. Sado që kishte oferta të mëdha që të shkonte jashtë, në ndonjë metropol, ajo i mbeti besnik këtij trualli - atdheut të vet të dashur!

Nexhmije Pagarusha pati një varg paraqitjesh brenda dhe jashtë. Për këtë ajo mori shumë letra falënderuese, kurse muret e banesës së saj janë të mbushura me mirënjohje dhe falënderime.

Nexhmija ishte në “Riva Del Garda” të Italisë, ku këndoi këngët “Po vijmë krushqit”, dhe “Ku po shkon, moj kuqëloshë”.

Mori pjesë edhe në manifestimin, “Fusha e Elizesë”, në Berlin, ku këndoi karshi Zhak Revallit të madhe”

Disku i saj u shit edhe në, “Galeri Lafajet” të Francës, bashkë me atë të Zhilber Beko, Edit Piaf etj.

Nexhmija ishte disa herë në Shqipëri, ku u prit me dashuri të madhe. Ajo thoshte: “Ju keni mundësi ta shprehni kënaqësinë tuaj, unë... jo” dhe një lëmsh ekstaze e pushtonte në grykë, kurse lotët ia njomin sytë”.

(N. Vinca)

“Takimi me publikun e Shqipërisë, më 1971, ishte i paharruar. Vizituam Tiranën, Vlorën, Elbasanin, Korçën... Kudo pritje e përzemërt, që nuk harrohet kurrë, që për këngëtarin, i cili “jeton nga duartrokitjet”, është gëzimi më i madh.

Në Shqipëri pata takime edhe me punëtorët e uzinave të Krujës, takim ky që më mbetet në kujtesë të gjatë. Kudo pritje e ngrohtë vëllazërore”.

Ëndërroi Nexhmija të shkojë në Shqipëri. U nis, bashkë me Zef Turpecin dhe, më 19 prill 1971 “zbarkoi” në Tiranë. Sapo u vendos në hotelin “Dajti”, Liri Çela, redaktore përgjegjëse e programit muzikor të Radio Tiranës i uroi mirëseardhje. Pritje madhështore në çdo hap. Më 20 prill Nexhmija mban koncertin e parë me rroba kombëtare. Orkestra, drejtuar nga kompozitori Agim Krajka, hapi koncertin e paparaparë të Nexhmije Pagarushës. Këndon këngët: “Unë ty të kam dashtë”, “Na ka dalë nusja e mirë”, “Ani mori nuse, ani qafë gastare” dhe “Ti moj bukuroshe”. Pasojnë duartrokitjet frenetike. Të gjata. Përsëriten strofat e këngëve. Përfundon koncerti me duartrokitje të gjata, lule, urime, përqafime...

Ngazëllehet Nexhmija, qan...

Të nesërmen, nëpër rrugët e Tiranës, dëgjohej refreni: “O, moj bukuroshe, shtatin kur ta pashë”, i cili u bë refren në Tiranë. Nxorën gazetatat fjalët më të ngrohta.

“Skena dhe ekrani” shkruante:

“Rrafshi, rrethuar malesh vigane: me Sharrin njomak dhe të vrazhdët, Bjeshkë të Nemuna, me Kopaonikun shpatullgjërë:

Rrafshi që s’kapet me sy. Në këtë bukuri, në atë vrer dhe këtë gazmend, mbiu dhe u rrit një artiste e vërtetë interpretuese, Nexhmije Pagarusha. Ajo, si askush tjetër, këndoi me gjuhën e shpirtit tonë për fushat pjellore dhe malet flladitëse tona,

pikëllimin e thellë për kubetlinj që s'kthehen më, për të shpërngulurit, dashurinë që askund si këtu, në këngën e Nexhmijes, nuk të çon peshë, nuk të lartton..."¹⁾

"Me këngë e kam jetuar e përjetuar çdo moment të jetës sime. Edhe të gëzuar edhe të pikëlluar. Nuk më është dhimbsur asgjë, askurrë për këngën. As vetja. Kurdo dhe kudo që është dashur të jem me të, nuk e kam kursyer veten. As atëherë kur s'kam pasur mundësi, as atëherë kur kam qenë e sëmure"... - rrëfen Nexhmija.

Edhe me bukurinë e saj, edhe me zërin e saj, edhe me këngët e saj, Nexhmija mahnitë secilin dhe kurdoherë: në çaste të vrerosura dhe të hareshme. Eci e eci kjo artiste e madhe. Në shumë podiume të botës: Tunizisë, Italisë, Francës, Çekosllovakisë, Shqipërisë. Dhe kudo Nexhmija gjeti miq të vërtetë të muzikës, të këngës... Dhe ngado u kthye ballëhapur e krenare. Një jetë, pra, le të quhet këngë, le të quhet Nexhmije".²⁾

Në sajë të zërit, që njohësit e muzikës e pagëzuan me epitete të favorshme u dëgjua kënga jonë e bukur edhe në Bullgari, Gjermani, Austri, Itali e deri në Izrael. E Nexhmija ishte përherë e njëjtë: modeste dhe e afërt kur këndonte këngë popullore, argëtuese edhe kur këndonte arie operash.

"Këngëtimi i bukur i Nexhmijes, zëri i saj i mrekullueshëm, muzika e jetës, më zgjon zemrën dhe më ngjall mendjen". (A. Sutaj)

Sa herë në "Akorde" e festivale dëgjuetit ia dhanë votën Nexhmijes pa hamendje, sepse ajo këtë e meritoi. Sepse, kur këndoi Nexhmija, këndoi malli e këndoi brenga, këndoi veshi e këndoi zemra. "Kur këndonte Nexhmija, zogjtë këngëtarë heshtnin" (R. Kelmendi)

1) Musa Ramadani: *Koncerti (i paparë) i Nexhmijes, Rilindja, 1 prill 1971, f. 8.*

2) Bajram Sefaj: *Një pllakë që nuk është vetëm e gramafonit, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 27. 11. 1974, f. 28.*

“Lakmi ia kishte gardalina e bilbili, zili ia kishte lauresha e mëllenja, nuk bëzante më para saj gushëkuqi e larashi, bëhej veç vesh zboraksi i malit e parosi, e dëgjonin me ëndje gjelbërusha e çerla e verdhë, mblidheshin si me një gjithë trishtilat: i madhi e i ziu, ai me qafë, bishhtëgjati kokëbardhë dhe i kaltëri, nuk fishkëllonte më fishkëllenjësi gushëverdhtë, as qesh e qesëndis përqeshësi i gjelbër, cucuron veshët bengu, çakërrisin sythit garguli e cercja... Kur këndonte Nexhmija”. (R. Kelmendi)

Nexhmija na mësoi ta duam këngën, ta duam jetën, ta shtojmë gëzimin dhe ta tresim mërzinë. Nexhmija ia dha shpirtin këngës, e pushtoi me ngrohtësi dhe shpirtin edhe këngën, e ngriti në pedestalin më të lartë të gëzimit dhe të haresë sonë. Poeti do të thotë: do të vijmë pas saj edhe shoqe të tjera të saj të këngës, edhe shoqe të shoqeve të tyre të këngës edhe do të këndojnë këngën e saj dhe këngën e re. Por: një këngëtare, do të thonë, pati kënga: Nexhmijen. Këtë e pranoi edhe Zhyliet Greko e famshme, e cila për Nexhmijen do të shprehet me këto fjalë: “Nexhmije Pagarusha ka një zë të jashtëzakonshëm. Ky zë është i ngrohtë, i ndieshëm, i dridhshëm” (R. Ramabaja)

Kënga e saj u bë zog në fluturim të përjetshëm. Ato melodi të kuqërremta përhapeshin përherë edhe në fshatrat e largëta, edhe maleve të larta e të ashpra.

“S’është vështirë të mësohet teknikisht kënga, por duhet të lidhet çdo frazë, çdo notë, me ndjenjat, të bëhet pjesë e jetës”, thotë Nexhmija. Kënga, “O, kjo anë e lumit ka bilbila shumë” e Ismail Kadarese gjendet si “motiv i përjetshëm” dhe në repertorin e Nexhmijes është njëra ndër këngët, që shpreh thellësinë lirike, lidhjen e pandashme të qenies si interprete e përkryer.

Dhe, sa e sa herë i përcollën njerëzit mëngjeset, mesditat e mbrëmjet me këngët e saj. E, ajo thotë: “jashtë skenës jeta ime është si e të tjerëve, e atyre njerëzve të rëndomtë, ndoshta edhe me më shumë halle...” Vitet iknin e ajo jetonte me këngën. “Po të kisha, siç kanë disa, vetë do ta paguaja një pedagog, i cili do të

ushtronte me interpretët tanë, të cilët kanë talent për këngën, por zërin ende s'e kanë të shkolluar", thotë Nexhmija e cila kurrë nuk u pasurua nga kënga.

Pa fije dyshimi Nexhmija mbetet fytyra më e shquar e muzikës sonë. "Ajo ishte një thesar, të cilit as që mund t'i dihet vlera. Një zë i tillë i mrekullueshëm lind njëherë në pesëdhjetë vjet. Përzemërsia e shprehur gjatë këndimit të saj mbetet joshëse përgjithmonë. Sipas kualiteteve, ajo qëndron në piedestalin e emrave më të mëdhenj të muzikës".³⁾

Nexhmija është përfaqësuese e denjë e melosit tonë shqiptar, kurse thjeshtësia në jetë sikur ia shton shkëlqimin.

"Kështjella përrallore ngriti "Bilbili i Kosovës". Primadona e këngës shqiptare - N. Pagarusha me zërin e saj, jo vetëm ndërtoi kështjella të pamposhtura, por kudo u pagëzua Madam Batërflaj. Ç'e do që dielli nuk lind nga perëndon. Ama vepra - ajo të amshon". (N. S. Hoxha)

Brohoritjet nuk i mungonin asnjëherë. Nexhmija derisa dilte nga skena, dukej e përmallashme, e drojtur, madje edhe e ngazëllyer, si atëherë kur doli për herë të parë para mikrofonit. Disi sikur i përziheshin dy kohë: "Jam shumë e lumtur". Kurse publiku i duartrokete dhe kërkon që ta këndojë edhe një këngë.

Kthehet, i përulet artit, përsëritet ngrohtësisht publikun e dashur. Vlerat artistike mbeten vlera. Nexhmija është e patejkalueshme në artin e kënduarit. Nexhmija është më shumë se artiste. Ajo është metaforë. Kënga shqiptare gjithë melankoli, plot shpresë dhe guxim, i ka ndihmuar këtij populli nga më të vjetrit në këto hapësira, për të ruajtur identitetin e vet kombëtar kundër të cilit u vërsulën gjithmonë më të fuqishmit.

Ja si e përshkruan Miss Edit Durham këngën shqipe:

3) Rashid Krasniqi, të kthehem nga gjërat kapitale, Prishtinë, 12. 02. 1967, f. 8.

“Shkalla shqiptare nuk është si shkalla moderne evropiane, por është e tëra me gjysmëtone dhe me tone të thyera. As muzika nuk ka kohë të rregullt. Ritmi i saj është i shpejtë ose i ngadalshëm, sipas ndjenjës dramatike të këngëtarit, dhe fjalët janë të zgjatura në mënyra të pabesueshme me kthesa minore të gjata, me ngritje dhe ulje zëri që pak gurmazë anglezësh do të mund t’i imitonin. Për një të pamësuar me to, ajo duket sikur nuk fillon askund dhe nuk mbaron diku, derisa pas pak javësh, veshi i mësuar me të si të ishte një gjuhë e re, dallon si tonin ashtu edhe ritmin dhe meloditë, që në fillim dukeshin të njehta, tani bëhen të dallueshme. Ato janë kombëtare dhe origjinale, plot hijeshi dhe këndohen gjithmonë me gjithë forcën e zërit, me një zë posaçërisht të lartë për burrat, dhe të ulët për gratë. Të dy sekset këndojnë kaq ngjashmërisht sa që njëherë unë e ngatërrova zërin e një vajze trembëdhjetëvjeçare, që këndonte në dhomën tjetër, me atë të një burri...”

Bujku, 8 mars 1995, f. 13

Ndërkaq Kadri Halimi, në përmbledhjen, “Studime etnologjike”, thotë se folklori dhe muzika shqiptare dëshmon se populli ynë ka një fantazi të gjallë dhe prirje për të bukurën. Muzika jonë popullore për nga ritmi e melodia është shumë e pasur dhe ruan shumë arkaizma.

Baza harmonike e muzikës shqiptare është e thjeshtë, por origjinale. Muzika popullore shqiptare ka disa veçori, që muzika e popujve të tjerë të Ballkanit nuk i ka. Meloditë popullore shqipe kanë kthjelltësi dhe fuqi burrërore, prandaj muzika artistike e kohës së tashme dhe të ardhme duhet të ushqehet me motive të shumta të muzikës popullore, me ritmin interesant dhe harmoninë e pasur.

Nexhmija çfarë nuk e njohim

II

Data e lindjes	7 maj 1933
Vendlindja	Pagarushë (Malishevë)
Pesha	65 kg.
Lartësia	170 cm.
Flokët	Gështenjë
Sytë	Të kaltër
Shkolla e kryer	Tre vjet të muzikës (BG)
Gjuhët e huaja	Turqisht
Sporti	Pastrimi i dyshemesë
Virtyti	Sinqeriteti
Adresa	Kurrizi, Rr. E pestë,
Çfarë ju bën të lumtur?	Lamella 4 nr. 8: (Pr)
Dëshira:	Nuk e di, lum ai që kënaqet me pak.
Çfarë urreni?	Shkëmbi operistike.
A kursëheni nga diçka?	Dyfytyrësinë.
Çfarë ju shqetëson?	Nga asgjë
Çfarë ju nervozon?	Bomba atomike.
Koha e lirë:	E padrejta.
Garderoba:	Duke lexuar.
A zgjoheni herët?	Fustanet.
A rrini deri vonë?	Kur jam e detyruar, po.
Si e kuptoni jetën?	Herë-herë.
	Si një ëndërr: herë e mirë, herë e keqe

60351

Keni pasur ndonjë aksident?	Kisha një në Qafë të Duhles, ai vend quhet, "Kthesa e Nexhmijes".
Vetura?	Kurrfarë.
Pija?	Jogurti.
Romancieri?	Bak, Kadare.
Poeti?	Esenini, Lorika.
Piktori?	Mona Liza.
Kompozitori?	Bet'hoveni, Verdi.
Vepra muzikore?	Traviata.
Instrumenti?	Violina.
Virtuoz?	Paganini.
Këngëtarët?	Karuzi, Gjili.
Këngëtare?	Kalas, Sumak, Tefta Tashko.
Artistja?	Xhoan Kraford.
Figura artistike?	Skënderbeu.
Idhulli?	Maria Kallas, Marie Kraja, Ima
Sumak.	
Miq të më të mirë?	Prindërit.
Ai besoni dashurisë	
në shikim të parë?	Jo.
Bukuria?	Sytë.
A jeni xhelozë?	Kam qenë dikur.
A jeni anëtare e ndonjë	
partie politike?	Jo.
Gjendja familjare?	Djali Leonardin, mbesat Mirjeta,
Fleta, Bleta dhe nipi Sardiani.	
Çasti më i rëndë në jetë?	Vdekja e babait.
Ku e rregulloni frizurën?	Vetë.
Cilin vend kishit	
dëshiruar të vizitoni?	Italinë, djepin e operave.

Aforizma të Nexhmije Pagarushës

III

- *Degjenerimi i njeriut është i vështirë të ndreqet në mungesë të pjesëve rezervë.*

- *Dikush më shumë fiton nëpërmjet linjave telefonike, sesa “telit” të zërit.*

- *E hedh me dru e me gurë, e ai prej tyre ndërtoi vilë.*

- *Dikush jeton prej zërit të mirë, kurse të tjerët edhe pa të.*

- *Jeta për dikë është shkollë, kurse për disa argëtim.*

- *Ngado që sillesh shumë orë e pak kohë.*

- *Dikush e mbyt e dikush e prin para.*

- *Dielli ngroh njësoj, por fatkeqësia është shpërndarë në mënyrë të barabartë.*

- *Jeta ka lule e gjemba: lum ai që i përvishet punës.*

(Bilbili)

Përse këngëtarja jonë më e njohur, Nexhmije Pagarusha, nuk ka në treg ekonomik pllaka, kaseta, video me këngë nga repertori i vet?

(Bilbili duhet të këndojë i lirë dhe s’e duron kafazin!)

Kënga - dashuri e përgjegjësi

“Të këndosh një këngë nuk do të thotë me e thënë mirë e me zë të çiltër, por duhet të ketë një plasticitet, të dalë edhe diçka vizuale”.

N. Pagarusha

IV

“Muzika jonë popullore dallohet prej muzikës së popujve të tjerë, sipas mënyrës së përdorimit të elementeve të muzikës dhe sipas mënyrës së të kënduarit. Metrika jonë popullore shquhet edhe për nga shpejtësia e lëvizjes së kronos sportive” (H. Hoxha).

Pikërisht këtë teknikë përfilli Nexhmija e cila lindi me këngën, u rrit me të dhe jetoj me këngën.

“Është mëkat i madh nëse ne këngëtarët nuk i ofrohemi publikut. Jemi shumë larg tij. Jam shumë e bindur se ata na duan. Në Kosovë jemi shumë këngëtare. Jemi si të humbur, askush nuk çan kokën për ne... Unë jam këngëtare, dua të këndoje e të jetoj me këngën. Të gjithë këngëtarët janë të tillë. Beso, nuk e kam për vete. Të gjithë këngën e kanë dashuri. Po, po jemi shumë larg publikut, e ata na duan. Tërë frikë isha në Tetovë, Gostivar, Dibër, Manastir...

Isha edhe në disa mjedise të Kosovës. Jam mahnitur. Dësh kam qarë. Në vend se, në ato qendra e gjetiu për çdo tre muaj të mbajmë koncerte, ne harrohem.

Asnjëherë në vit nuk mbajmë koncerte, në dy vjet, tri... Kur t'i tekjet dikujt. Mëkat, besa. Shumë mëkat për këngëtarët, të cilët gjithnjë janë të etshëm për të dalë para publikut i cili na pret.”⁴⁾

4) Ibrahim Kadriu, *Dua të këndoje e të jetoj me këngën*, Prishtinë, 27. 11. 1971, f. 12.

Nexhmija vazhdimisht interesohej për pozitën e këngëtarit. Thotë: “Unë mjaft kam kënduar, për mua nuk është më e rëndësishme se a paraqitem para publikut apo jo. Por, t’iu mundësojmë të rinjve. Kam dëshirë që kolegët e mi të mos presin angazhimin si toka shiun në verë të thatë. Nganjëherë kisha përshtypjen se veprohej kundër talentit tim. Ne qysh në atë kohë kishim soliste të diplomuara, si Hermina Delhysa, Afërdita Fehmiu, por nuk arritëm ta formonim operën tonë kombëtare”.

Përjetimi e pëlqimi i këngës duhet të jetë motivi kryesor i çdo këngëtari. E Nexhmija i kishte këto tipare. Pena sikur nuk është e zonja të përshkruajë tërë atë që bëri ajo për muzikën tonë. Ajo vazhdimisht iu qas seriozisht këngës. “Kënga duhet të lidhet me ndjenjat e publikut. Unë së pari e mësoj melodinë e pastaj fjalët dhe, të shkruara në këngë, i fus në shpirt. Duhet edhe në melodinë më të rëndomtë ta zbulojmë karakteristikën e saj dhe atë ta potencojmë, sepse ajo duhet ta bartë këngën”, thotë Nexhmija.

Më tej ajo shton: “E dua ngritjen dhe përparimin e popullit tim dhe të mos e bjerrim kohën kot. Por të punojmë më shumë, e të flasim më pak”. Pikërisht në saj të punës, dëshirës dhe kurajos Nexhmija vite me radhë qëndroi në pikën më të lartë të famës.

Në secilën këngë Nexhmija gjente diçka të bukur. Muzikantët, për nga natyra e profesioni, janë njerëz humanë. Njerëzimi ka pasur me të vërtetë yje të shumtë por një yll i nënqiellit tonë - Nexhmija, nuk do të shuhet kurrë.

“Unë kam kënduar, të thuash, pa farë kompensimi. Po të mirrja para, kisha përshtypjen se e shisja gjënë time më të shtrenjtë: muzikën, së cilës ia kushtova tërë jetën, duke sakrifikuar gjithçka për të”, thotë Nexhmija.

Duke evokuar kujtimet ajo shton se prezantimet përpara publikut gjithmonë i ka përjetuar si premierë dhe thotë: “kurdoherë kam pasur përshtypjen se po këndoje për popullin tim. Prandaj punën time dhe besimin e rrethit tim e kam kuptuar shumë seriozisht”.

Nexhmije Pagarusha kudo foli me gjuhën e popullit të vet dhe bota e kuptoi. “Nga njëherë çuditëm si munda të jetoja vetëm me këngën? Më ka përcjellë tërë jetën një entuziazëm i madh. Energjinë e kam harxhuar në këngë. E, të paktë, shumë të paktë kanë qenë ata që kanë thënë “Lumja ajo”! S’ka qenë aspak lehtë të vazhdoja deri tash me këngën. Po, kurrë s’kam menduar a do të fitoj, do të mbes pa bukë, apo do të mbes edhe në rrugë... Çdo punë më jep jetë. Duke punuar njeriu as lodhet, as plaket. E vetmja gjë me kuptim është puna. Të marrim këtë: kur e pastron dhomën dhe e sheh ashtu të rregulluar, ndjen kënaqësi. Ose, për mua është njësoj e madhe kur dikush më thotë: “Kjo shtëpiake është nënë e mirë”!

Dhe më mjafton pastaj të kem konsideratë të plotë ndaj asaj gruaje, si për njeriun që, në sajë të titujve të vetë, ka bërë punë të mëdha. A ka detyrë më humane se rritja e shëndetshme dhe edukimi i fëmijëve? Kam pasur një dëshirë dhe më vjen keq që s’e kam përmbushur: të kem shumë fëmijë.

Shpesh kam menduar të bëhem mësuese në ndonjë fshat plot fëmijë. Nuk ka profesion më të mirë se të jesh mësuese. Por, kënga vulosi fatin tim. Kam dëshiruar të këndoja në opera. Provova të këndoj këngë serioze. Këndova disa arie të operave. Mirëpo, shpesh bindjen se një ditë që do të kemi operën tonë. Më mirë vonë se kurrë. Do të jem shumë e lumtur, kur t’i shoh këngëtarët e rinj, të cilët do ta përmbushin dëshirën time. Unë kam besim te të rinjtë. Ata po e mësojnë solokëndimin dhe do ta ngrenë operën. T’i përmend disa: Inva Mula, Alma Bektashi, Merita Juniku... A nuk janë talente të rralla? Dhe unë i admiroj ato. Besoj, edhe kushtet do t’i kenë”.

Sigurisht njëra, prej atyre që do të vijjnë, është edhe Aida Pagarusha, mbesa e Nexhmijes, e cila, në RTP, pati inçizuar dy këngë: “Dashuria” dhe “Të këndojmë si përherë”. Aida Pagarusha tani jeton në Belgjikë, ku ka studiuar për muzikë. Merret me balet dhe teatër. Është e bukur, ka një sharm dhe, ç’është më me rëndësi,

ka zë shumë të bukur. Mbase Aida do të jetë trashëgimtare e Nexhmijes nga familja Pagarusha.

Që Nexhmija të jetë kjo që është ndikoi mjaft edhe kompozitori Rexho Mulliqi, me të cilin ajo hyri në jetën bashkëshortore. I lidhi profesioni, mirëkuptimi. Me Rexhon, Nexhmija jetoi dymbëdhjetë vjet në bashkëshortësi. Si u njohën, si u lindi dashuria?

Në pranverë 1947 amatorët e Teatrit Popullor përgatisnin premierën e parë.

“Si quheni vajzë”, i tha Nexhmijes një burrë trupgjatë. Ishte Rexho Mulliqi, kompozitor.

- Quhem... Pse po më pyetni?

- Unë jam Rexho Mulliqi.

- Ju jeni kompozitori? Unë jam Nexhmije Pagarusha. Kam dëgjuar shumë për ju. Dëshiroj të këndoju...

Ka qenë e bukur, artiste e vërtetë, nuk kam mundur të mos i ofrohem, - rrëfente Rexho.

- Edhe ai ka qenë i bukur edhe shumë i popullarizuar, - shton Nexhmija.

Ai ishte i pari që më ndihmoi. Kështu u njohëm dhe filluam të dashurohemi”, thotë Nexhmija, duke mbrojtur mendimin se secili mashkull dëshiron të takojë femrën me pamje të bukur dhe me shpirt të mirë. Edhe unë kam pasur “prototipin” e bashkëshortes së ardhshme, qysh nga fëmijëria”, shtonte Rexho Mulliqi. “Në atë çast që e kam takuar Nexhmijen, e kam pasur të qartë se kam gjetur atë që e kam kërkuar. Mirëpo, ajo me mua u dashurua me shikim të parë, kurse unë jo. Unë dëshiroja ta njihja sa më mirë dhe, sa më shumë që kalonin ditët, gjithnjë e më shumë dashurohesha në të. Mendoj se vendimtare ka qenë kënga e saj. Kur kam dëgjuar si këndon, tashmë nuk kam pasur ku të shkoj më tej, veç kam qenë i dashuruar marrëzisht”, tregonte Rexhoja. Ndërkaq, Nexhmija rrëfen kështu për bashkëshortin: “Kur e patëm tejkalar fazën e dashurisë, kur u bëmë bashkëshortë, u shfaq diçka e re që edhe më shumë plotësoi jetën tonë bashkëshortore: opera. Edhe unë,

edhe ai, kemi ëndërruar që në Prishtinë të themelohet opera. Me përpjekje të jashtëzakonshme kam kënduar për herë të parë shqip disa arie operistike. Muzika ishte ajo që më bashkoi me Rexhon. Të mos ishte Rexho nuk do të arrija agjë”. Kurse, Rexho do të shtonte: “Po të mos ishte Nexhmija, do të përfundoja si kompozitori i mesëm, i muzikës së lehtë. Ajo ishte vajza e ëndrrave të mia”. Ndërkaq Nexhmija shton: “Ai ishte djaloshi i ëndrrave të mia!”

“Muzika është dashuria ime e parë dhe e fundit. Ajo për mua domethënë jetë. Madje, edhe më shumë - jetë për të tjerët” - thoshte Rexho Mulliqi, duke e pohuar këtë edhe me veprën, edhe me personalitetin e tij. Biografia e tij, e marrë nga enciklopeditë dhe leksionet e thjeshtësuar në faktet themelore, duket kështu:

U lind në Guci më 18 mars 1923, vdiq në Prishtinë më 11 shkurt 1982. Është muzikanti më i rëndësishëm, më i dëgjuar dhe më i frytshëm kosovar. Shkollën e mesme e mbaroi në Shkup. Akademinë muzikore në Beograd. Qe profesor i shkollës së mesme muzikore të Prizrenit, redaktor përgjegjës i programit muzikor të Televizionit të Prishtinës dhe kompozitor i Radio-Prishtinës. Me arsimim të përgjithshëm, jashtëzakonisht i talentuar, kompozoi pothuajse çdo gjë: nga muzika vokale, kamere, skenike, filmike, simfonike dhe për fëmijë. Është fitues i çmimeve të shumta në vend dhe në botë. Veçohet si melograf dhe pedagog, që krijoi kuadro të rëndësishëm. Kompozimet etij ekzekutohen në mbarë Evropën, veçmas në Austri, Gjermani dhe Francë. Veprat e tij më të rëndësishme: “Dy simfoni”, “Fantazi”, “Pastorale dhe lojë”, “Aktuarele të Prizrenit”, “Legjendë për violinë dhe piano”, “Elegji për violonçel, violinë dhe piano”; muzika për filmat “Kapetan Lleshi”, “Era dhe Lisi”, “Uka e Bjeshkëve të Nëmuna”, “Qërim hesapesh”, si dhe për një varg filmash dokumentarë: muzika për shfaqjet skenike “Bësa”, “Eroheja”, “Tregimi i irkut”, “Pelinovo” dhe të tjera; vokale - “Kosova”, “Suitë e vogël e popullarizuar”, “Vjersha II” - fituese e çmimit të parë në festivalin botërorë të Langolenit, në Angli: kantatat “Poema për ata”, “Baresha”; muzika për balet “Legjenda për fitoren” dhe “Nita”, një numër i madh i kompozimeve për kor. Përpunoi mbi 150 këngë popullore shqiptare dhe të tjera...

(“Nita” mbeti e pakryer. “Simfonia e parë kosovare” humbi përgjithmonë, kurse disa do të mbeten edhe një kohë të gjatë, së paku te ne, të paekzekutuara, duke pritur kuadro dhe mundësi më të mira teknike.)

Të gjithë ata që shkruan për muzikën e R. Mulliqit, konsiderojnë” Simofoninë e dytë kosovare” verpën e tij më të arrirë, por edhe më të përshtatshme për vlerësimin dhe kuptimin e poetikës së R. Mulliqit, ritmi i pasur, orkestrimi i bujshëm, metaforika dhe refleksiviteti, fantazia dhe freskia, poetizimi magjik në melodi dhe harmoni, dalldia në formë, gjuha e fisnikëruar muzikore dhe përshkrimi i emocioneve - që nga më personalet deri ato epike. R. Mulliqi është artist që gjurmoi parreshtur pas valereve të reja, ndaj përdori shpesh dhe mjeshhtërisht instrumentet e lashta, duke shprehur, si në “Simfoninë e dytë Kosovare”, tingujt e tamburit - “çiftelisë”...

Në këtë pikë e shohim lidhjen shpirtërore dhe inspirative të R. Mulliqit me nënqiellin kosovar, me të kaluarën dhe fatin e tij, të nxitur, mbase edhe nga titulli i kompozimit. Artisti jetoi më së gjati në Kosovë, por, veç mundësitë për t’u dëshmuar, atje nuk gjeti asgjë që nuk e bart nga Guica e tij. Pa qëllim që të përvoetësojë pa të drejtë (sa më shumë u takon të tjerëve, aq më shumë është ymi), ai që nuk e zgjodhi muzikën, po që muzika e zgodhi atë, nga vendlindja shkoi jo vetëm si muzikant i lindur, por pothuajse i mbaruar. Gjithë atë që në veprën e tij e njohin si “ngjyrë të gjelbër të Kosovës”, mbart me vete tingujt, erëhimet dhe ngjyrat e peizazhit të Gucisë, të qiellit dhe të lumenjve, të jetës dhe të etikës së njerëzve të tij, të gjërësisë së shpirtërave të tyre, të freskisë së burimeve dhe ujërave ndanë të cilave u rrit artisti.

Natyrish, artisti që ecte para kohës, duhet edhe shumë kohë të presë kohën e tij... Sepse, kaluan, themi dekada, derisa një Belina Bartok, arstisti më popullor prej të gjithëve, u kuptua dhe u pranua siç duhet. Artistët e vërtetë, e Rexho Mulliqi është njëri prej tyre, gjenden në Parnas, në majë të të cilit çojnë shtigje të shumta, por që arrihet me vështirësi. Por, edhe horizontet që zbulohen nga majat e arritura shqetësojnë edhe magjepsin ofrojnë kënaqësi dhe gëzim të plotë...

“Si të gjithë lumenjtë e mëdhenj, edhe Sena vjen nga provinca” - thotë **Zhak Prever**.

Nëse në muzikë priret nga Vrujica e vendlindjes, Rexho Mulliqi në të u bë lumë, që e pasuroi dhe e fisnikëroi visin, duke e shndërruar në fusha të plleshme dhe lugina të buta. I qetë, i sigurt në vete, i njohur nga ngjyra e gjelbër e jegës, ai rrjedh nëpër kohë dhe hapësirë pothuajse sikur nëpër Kosovë, por burimet i ka në Bjeshkët e Nëmuna (në Gucinë e Rexhës, reale dhe mitike, të amshueshme dhe të përjetshme), burimet e pastra dhe të patrazuara, të narta dhe të fuqishme (sa më shumë japin, aq më shumë janë!), në to pasqyrohen edhe qielli, edhe guri, edhe natyra, edhe njerëzit mu si në muzikën e Mulliqit... (Z. Hoxhiq)

Titrimë e një stine

Elegji për Rexhë Mulliqin

*Titrimë e një stine
Buloi n'gjethin e parë,
U shndërrua n'blerinë rudine,
Kur e çike me një fanar.*

*Me harfë zogun e mbyte,
Pse prora t'pat zili.
I dehur në këngë u zhyte,
U bëre vetë melodi.*

*Një zogzë këndoi me ty,
Kur ia puthe yllin në sy.
Eshtrat t'u kthyen n'kaltri,
Kur zjarrit i re si stuhi.*

*Ti në fjalë e shkëndi
Gishtat i dogje n'pranverë.
E ne për lavd e krenari
N'vatrën tonë të ruajmë përherë.*

Enver Gjerqeku

*FLATRIMI I FJALËS, përmbledhje poezish, f. 103,
botoi Rilindja, Redaksia e botimeve, Prishtinë, 1987.*

Violina, qan, posi

Kënga s'ka korniza. Zëri çan shkëmbin. Bilbili e thyen krahun e dallëndyshja topoit sqepin. Kënga të djeg. Erë pranvere. Erë bjeshke. Këpucët, dy numra tej madhësisë së këmbëve. Arnat në trup e njollat në shpirt. Njeiu fluturon. Trupi shkrihet në përmendore. Nuk lëviz vendit. Një orë: violina qan, posi. Rrethi belbëzon: "I krisur!" Rrethi më i gjerë murmurit: "Si bëhet të qajë njeriu pa lot!" I vendos erërat në tel e harku flet si njeriu vetë. Këshillat e mbulojnë si jorgan i shqyer: "Ti je Pitagora i ditëve tona..."

Shi pranvere. Prej Gërmisë vinte plymi i beharit. Ai nën strehë. Violina qan, posi. Nata s'ka dëshmitar. Në telat e hollë shkrihen bjeshkët e gjallërojnë fushat. Hyn e tërë vendlindja e tij. Ecën njeriu. Dëgjon zërin e popullit. "Çou more Rexho dil te dera..." Duartroket deri sa nuk i dhembin eshtrat. Profesorët kërcënohen: "Ardhmëria jote është humnera! "Dueqte plot ari. Gishtërinjtë të lirë. Dhuratat me vlerë për jetë. Edhe pyetja e madhe: "A thua ariu kafshon më keq mushkëritë sesa brenga ime?"

Dhe rishtas, vjen e hyn në zemrën e tij nëna e Rexhës. Pa lot. Eshtrat brinca. Shpirtin plumb. Përsërit: "Jam bisedar në çdo tragjedi!" Me bark shkrin shpatëzat e acarit. Violina qan, posi. Më dhimbshëm se foshnja pa nënë. Të gjithë mendojnë: pse nuk i këputen telat. Gishtërinjtë si fytëza. Sytë të fjetur. Buzët të qëpur. Për dy dashuri s'gjen vend në shpirt. Me numra, cok do ta godiste edhe një botë. Me nota do ta zbusë këtë botë.

Dhe fijet shkëputen. Në ditët e lirisë: shoqërohet me këngën. Ia fusin nën sqetull ditarin dhe urdhërojnë: "Ti e di mirë matematikën!" Para nxënësve është trupore pa mish e gjak. I tejdukshëm. Ama e tij rreptë

rrjedh diku larg. I gatshëm të gjuhet: në valët e çmendura dhe të rrëmbyera. Mbështet ditarin pa fjalë. Rrok violinën, pa premtime. Dhe vazhdon deri në vdekje, përsëritjen e të vetmes së vërtetë: “e të rrojë kënga...”

Violina qan, posi. Lotët - helm. Qe aq i ri, me moshë, shekullor me vepra, vdiq kraharorin plot këngë, Rexho Mulliqi. (M. Shehu)

Nexhmija u flijua për artin muzikor. Gjithmonë mbajti përgjegjësi për këngën.

Çdo gjë e përballoi me këngë. Nexhmija ishte njeri dhe artiste. Të gjithë mahniteshin e pyesnin:

Si është e mundur që një këngëtare pa nota dhe pa akademi të mbaruar ta njohë aq thellësisht shpirtin e popullit dhe t’ia veshë zërit të vet ngjyrën e thellë psikologjike? Këtë mund ta bënte vetëm Nexhmija, një talente e rrallë, e lindur për këngën, të cilën e kishte dhunti të natyrës.

Po nëse Nexhmija i ka dalë hakut këngës, a i kemi dalë ne hakut Nexhmijes?

Me siguri jo. Koncertet e saj me “Shotën” nuk janë filmuar, ka pak inçizime të ruajtura (vetëm dy disqe!) dhe një emision tridhjetëminutësh, i xhiruar për herë të fundit më 1979, “Nexhmija në mënyrën e vet”, por (sigurisht) i asgjësuar më vonë! (Vallë, a fshihet arti padashje?!)..

Ja çfarë i shkruajnë dy bashkëshortë Nexhmijes: “E dashura shoqe Pagarusha, më pëlqejnë shumë këngët, të cilat i interpretoni, vetëm se më vjen keq që s’mund t’i gjej askund. Kurse, në një letër nga Parisi, thuhet: “E nderuara Nexhmije, gjuhën shqipe nuk e njoh, megjithëkëtë kjo nuk më pengon që ta shijoj bukurinë e zërit tuaj. Jam adhures i disqeve tuaja, porse për fat të keq, askund nuk mund të gjenden!...”

(Ekziston vetëm një disk “Long-Play” i Nexhmijes me 13 këngë popullore burimore, inçizuar nga RTB dhe Lidhja Turistike e Kosovës!)

Për këtë anomali u shkrua mjaft. “E dëgjoj vetëm Radio Prishtinën dhe asnjë radiostacion tjetër. Disa interpretime të të rinjve tanë më entuziazmojnë, shkurt më kënaqin. Kur e dëgjoj kompozimin “Moj e mirë, o të pojata”, nuk e di çfarë të them se si ndjehem”.

“Folklori ynë është shumë i begatshëm, e begatinë e tij ne e shfrytëzojmë fare pak. Kemi mjaft zëra të rinj e prej të rinjve rezultate inkurajuese po tregojnë sidomos Shpresa Gashi, Bashkim Paçuku, Shkurte Fejza, Iliri Shaqiri. I përmenda këta, se me ta kam pasur kontakte, i kam dëgjuar më shpesh dhe kam përshtypje se këngës sonë do t’i kontribuojnë shumë”, thotë Nexhmija. “Kemi edhe një numër këngëtarësh. Për këtë u bindëm me rasin e ekzekutimit të operës së parë në Kosovë, “Goca e Kaçanikut”. Ky sukses më ka gëzuar shumë... Sa i përket Radiotelevizionit nuk diçka të them. Pak angazhohen për t’i pasuruar diskotekat dhe programet e tyre. Por, njeriu bie edhe në dilemë: fjatorë janë interpretët apo produktioni? Duhet interesim më i madh. Të punohet më shumë me këngëtarët, e jo sot futet në studio dhe inçizon këngën. Kjo është një traditë jo e mirë e producentëve. Tekstet duhet kontrolluar më tepër, se po emetohen këngë pa përmbajtje, bile po jepen bukur shpesh në program...”

Duhet të nxjerrim në sheh një fakt të hidhur: shumë interpretime të Nexhmijes nuk ekzistojnë më. Janë fshirë gjatë viteve të shkuara, ngase shiritat e njëjtë (shih çudinë) qenkan dashur për inçizime të tjera kushedi të kujt!...

Është kjo papërgjegjësi, jokonsideratë, apo hap i qëllimtë, mbetet dilemë e madhe dhe e pashpjeguar deri në fund. Pse nuk ka emision për Rexho Mulliqin, pse nuk ka emision për Nexhmije Pagarushën? Papërgjegjësi ndaj vetvetes!

“Unë nuk kam lindur para 200 vjetësh, kur nuk kishte kamera e shirita manjetofoni”, thotë paksa e zemëruar Nexhmija. “Koha është gjykatorja më e mirë, e gjen “ngushëllimin” ajo”. Por, a mjafton kjo? Megjithatë, një mbrëmje artistike e organizuar në

Prishtinë, për nder të Nexhmijes, sikur ka zgjuar kujdesin e gjetur për të. Për herë të parë, pas shumë vitesh, ndodhi një mbrëmje e bukur dhe simpatike. Nexhmija ishte mysafirja e parë e emisionit të parë shqip të TVB, që e kishte përgatitur M. Çoça.

Ansambli “Shota” dhe Nexhmija

Vetëm puna të sjell dritë.

Nexhmija

V

Suksesin më të madh Nexhmija e arriti me ansamblin folklorik “Shota” të Prishtinës. Me “Shotën” ajo u paraqit në mbi 100 koncerte. Ansambli “Shota” kishte një yll - Nexhmijen, që dëgjuesit e pritnin me padurim. Me mijëra.

“Loja me shpata” e Rugovës dhe “Vallet e Prizrenit”, kudo impresionin publikun, kurse Nexhmija, me zërin e saj të kulluar, i bënte spektatorët për vete. Përfaqësuesit e Radios Gjermane (VDR) dhe disa muzikologë të tjerë deklaruan se Nexhmija është një këngëtare e madhe dhe se paraqitja e saj në këtë ansambël ka bërë që vlera e tij të jetë edhe më e madhe.”⁵⁾

Ansambli “Shota” u paraqit kudo si një “muze i gjallë”, ku programet e tij bazoheshin në ndërshmërinë karakteristike shqiptare dhe, ku plastika koreografike ruante fizionominë e thellë origjinale, duke ruajtur dhe kultivuar vetitë më të bukur të popullit, si qëndresën, krenarinë, trimërinë etj.

Te “Vallja e Rugovës”, bie fjala, krijohet një sfond, që jeton i tëri me emocionet e atyre çasteve epike.

“Zëri i ëmbël i këngëtares së mirënjohur Nexhmijie Pagarusha u prit me duartrokitje frenetike. Ai timbër i pastër, ajo dashuri për këngën popullore, për të ruajtur në të, nëpërpjet një interpretimi origjinal, atë specifikë dalluese e ngrohtësi që të ngre peshë, i dha sallës kënaqësinë të dëgjojë me respekt nga kjo këngëtare këngë të tilla, të preferuar nga publiku. Në secilën nga ato ajo zbuloi një botë tjetër dhe, pa drojë, mund të themi se renditet ndër interpretueset më të mira të këngës popullore shqiptare”. (Z. Hoxha, A. Alijaj, A. Krajka).

5) Jusuf Buxhovi, *Kudo pritje e përzemërt, Prishtinë, 1971, f. 8*

Nechmije Bagarusha

Nga vizita në Shqipëri

(Përshtypje, 1973)

Kaluan dy muaj, por padyshim do të kalojnë edhe shumë të tjerë, madje edhe vite të tëra, e nuk do ta harroj takimin me publikun këngëdashës të Shqipërisë. Paraqitja ime me anëtarët e ansamblit të “Shotës” nuk ishte takimi im i parë me këtë publik: herën e parë, gati para dy vjetësh, gati rastëisht, me dëshirën e shokëve të Radio Tiranës, u paraqita në koncertin e këngëve dhe të valleve që asokohe jepej në sallën e Teatrit Operas dhe Baletit. Ishte ajo paraqitje rasti i vetëm para publikut të Tiranës...

Tani paraqitja jonë para publikut ishte krejt ndryshe: vizitua disa nga qendrat më të mëdha, si: Tiranën, Vlorën, Korçën, Elbasanin e të tjera.

Gjithkund pritje e ngrohtë që nuk harrohet lehtë dhe kurrë.

Pritje që për artistin, për njeriun që “jeton nga publiku” është gëzimi më i madh dhe shumë i dëshiruar: publiku i singertë që di të çmojë përpjekjet dhe angazhimin e këngëtarit, të vallëzuesit dhe di të reagojë me një duartrokitje kurajuese mu në çastin kur duhet. Mu për këtë, gjatë interpretimit të këngëve të mia, ndjeva gëzimin që padyshim nuk do ta harroj kurrë.

Por, nuk është vetëm pritja e publikut në sallë që këtë turne e bën të paharrueshëm. Janë aty edhe shumë takime me njerëzit e njohur në muzikën tonë, kompozitorë dhe punëtorë të tjerë, të cilët, unë më parë i njihja vetëm si emra, si krijues...

Takimi me këngëtarët e estradave të ndyshme, të cilët përherë ishin të gatshëm të paraqiteshin para publikut të tyre dhe para grupit tanë, na mahnitën me përgatitjen e tyre, me gatishmërinë,

gjë e cila më së miri flet mbi mënyrën e organizimit të jetës kulturale dhe argëtuese në qendrat e ndryshme.

Ai takim me punëtorin e një uzine të Krujës, i cili dinte aq bukur të këndojë, që ishte artist në kuptimin e plotë të fjalës, padyshim do të na mbetet i paharrueshëm të gjithë neve...

U bë mirë që gjatë kësaj kohe vizituam edhe qendrat e entet e ndryshme kulturale dhe përmendoret e vendet e njohura historike. Shumë uzina e fabrika.

U gjetëm në shkollën normale të Elbasanit, në shkollën ku u shkolluan shumë mësues, mësuesit tanë të parë...

Biseduam me nxënësit e shkollës së muzikës në Korçë që mbante emrin e këngëtares fort të çmuar Tefta Tashko.

Kjo ishte kënaqësi e posaçme për mua: disi më afërsisht kisha rastin të njihesha me veprimtarinë e këngëtares, të cilën e kam dashur shumë që në fëmijëri. Nëpër koridoret e pastra të shkollës gjithëkund fotografitë e kësaj këngëtarje të njohur edhe jashtë kufijve të Shqipërisë, kësaj artistje zërin e së cilës përpiqesha që herët ta imitoja duke kënduar edhe shumë këngë nga repertori i saj.

Të gjithë flasim për të.

E fjalët e bashkëbiseduesve më tingëllojnë në vesh si muzikë, si këngë e bukur, të cilën dikur e këndonte Tefta Tashko e dashur...

Padyshim për të gjithë ne të paharrueshme janë edhe takimet me publikun, me dashamirët e këngës dhe të valles jashtë sallave ku paraqitje grupi ynë. Takime këto shumë të përzemërta të cilat përcilleshin me lule, duartrokitje dhe buzëqeshje të këndshme. Takime këto që përsëriteshin në çdo qytet, apo fshat ku ishte mysafir grypi ynë...

Lulet e dhuruara nga duart e vogla të një vocërraku, i cili nuk do të ketë mundësinë të vijë në sallën e koncertit të dëgjojë edhe këngën time, për mua janë po aq të dashura sa ato që më janë dhuruar as këngës, si dëshmi se këndova bukur...

E raste të tilla pati shumë.

Për këtë dhe për shumë gjëra të tjera, ky takim me publikun këngëdashës të Shqipërisë, me njerëzit që na përcollën dhe që na pritën aq mirë, padyshim do të mbetet kujtim që nuk harrohet, kujtim që për artistin, për njeriun, - do të thotë shumë... shumë...

Qëllimi kryesor i “Shotës” ishte që t’i ruajë traditat e mira të kulturës popullore dhe lirikën e botës shpirtërore popullore, duke arritur të konkretizojë në mozaik ritmi, tingulli dhe ngjyrash. Pra, koncertet e këtij ansambli folklorik u përcollën me kënaqësi të veçantë, kurse çdo paraqitje e Nexhmijes, ishte ngjarje në vete.

“Kjo këngëtare e talentuar, me një diapazon të gjërë emocional, me një poetizëm dhe mjeshtri të lartë, u dallua për interpretimin e singertë dhe plot ndjenja të këngëve në përgjithësi. Duke zbuluar atë brendi që me aq forcë populli e ka krijuar në këngën e tij, Nexhmije Pagarusha e tregoi veten.

Logjika me të cilën ajo transmeton botën shpirtërore që ndryn në vete kënga popullore, rrjedh në vokalin e këngëtares së natyrshme, me mendime dhe me poetizëm bindës.”⁶⁾

Ansambli “Shota” dallohej me një pasuri të madhe kostumesh, që ngërthente me vete forcën dhe talentin e fuqishëm të një populli. “Duke folur për vlerat e këtij ansambli artistik mund të konstatojmë se ai po bën një punë të madhe në ruajtjen dhe mbajtjen gjallë të folklorit, ku janë mishëruar vetitë më tipike të popullit, siç është dashuria për jetën, ndjenja e patriotizmit dhe lufta për liri”. (Anonim)

Ansambli “Shota”, në sajë edhe të Nexhmijes, korri shumë suksese. Në Francë, bie fjala, zuri vendin e parë në një manifestim ndërkombëtar.

“Shumë kam udhëtuar me “Shotën”, shumë e kam dashur, kemi qenë si një familje, më kanë dashur dhe i kam dashur”, evokon kujtimet sot Nexhmija dhe sikur një lot i rrëshqet mollëzave, që tregon mall, nostalgji, brenga...

6) Çesk Zadeja, *Koncertet e bukura të Ansambliut, “Shota” të Prishtinës, Drita, Tiranë, 8. 03. 1973, f. 13.*

Dhe shton: “Kur i kujtoj të gjitha mund të them se jeta ime ishte shpatë me dy tehe”.

Dhe tani, pas largimit nga skena e nga “Shota”, Nexhmija thotë: “Dola, në ndarje, me “Shotën”, por para se të dal në skenë kam qenë aq e prekur dhe më janë zgjuar emocionet që ma kanë rënduar hapin... Së pari, e ndjeva veten sikur kisha vdekur, por nga gjithë ai respekt, nga ato ragime, sikur u ngjalla përsëri”.

Po ata lot, po ato reagime fëmijësh, sipas ritmit të regëtimës artistike dhe dridhjeve të zërit, me nuancat e dridhjeve të zërit të natyrës; çfarë dhuntie i përplas ato duar të vogla?

A do të thotë kjo se kënga e Nexhmijes është universale dhe e shpalos shpirtin e popullit, duke depërtuar në psikologjinë e secilit, pa dallim moshe e gjinie?

Kështu foli Nexhmija, gati me lot në sy dhe me mallin e kyçur në zemër. Kujtimet për “Shotën” i ruan me krenari. Bashkëjetuan dhe bashkëvepruan shumë vjet. Prandaj, lidhja gati ishte organike, e fortë dhe emocionale. Një “Shotë” kishte “Shota” - Nexhmijen!

Nexhmija - aktore

Filmin e dua pa masë. Kjo tregon se ne kemi forcë për të shkuar edhe më tej.

N. Pagarusha

VI

Nexhmije Pagarusha, krahas këngës, u angazhua edhe në teatër e film. Madje, ajo hapat e parë i bëri në Teatrin Popullor të Kosovës, në Prishtinë, por që, pas një viti, u përcaktua për këngën pa e lëshuar rastin që të angazhohet edhe në film, kur e lypte nevoja.

Për herë të parë u angazhua në filmin “Dasma e përgjakshme maqedonase”, të regjisorit Trajçe Popov, xhiruar nga “Vardar - Filmi”, më 1967. Pastaj pati rolin kryesor në dramën televizive “E kafshoja terrin”, “Rruga pa kthim” dhe në filmin “Tre vetë kapërcejnë malin”, të regjisorit Ekrem Kryeziu. Kishte një rol të rëndësishëm edhe në filmin për fëmijë dhe të rinj të Ismail Ymerit, “Lepuri me pesë këmbë”.

Veç kësaj, “Kënga e Rexhës” është bërë melodramë për radio nga Ymer Shkreli, të cilën nuk arriti ta xhironte Televizioni.

Në filmim “Dasma e përgjakshme maqedonase” Nexhmija luajti rolin e Ulës, një ndër gratë më besnike të Haremit të Osman Beut. Roli i Ulës, më parë, i ishte besuar Olivera Markoviqit. “Jam e befasuar, por edhe e gëzuar. Derisa ta shoh filmin vetë, s’di se çka do të dalë. Dje më thirrën, sot erdha dhe më angazhuan. Do të përpiqem ta realizoj rolin e Ulës sa më mirë. Filmi ka një temë mjaft interesante dhe besoj se do të korri sukses te publiku”.⁷⁾

Nexhmija dëshmoi se ka cilësi të rralla edhe në film. Në dramën televizive “E kafshoja terrin” të Ekrem Kryeziut, ajo luajti rolin kryesor, atë të nënës. Roli i saj u realizua mjaft mirë, prandaj u

7) Adem Gajtani, *Nexhmije Pagarusha zuri vendin e Olivera Markoviqit, Prishtinë, 14. 06. 1967, f. 8.*

shpërblye me çmimin e Portorozhit dhe drama u dha edhe në festivalin më eminent të realizimeve televizive të dramës “Prix-Italia” në Milano.

“Me Ekremin (Kryeziun) kemi punuar disa herë për emisione muzikore televizive. Më premtonte se do të më angazhonte edhe në film dhe kështu, kur e takova njëherë, pa u përshëndetur, më tha: “ta kam caktuar një rol. Ma dha skenarin dhe e lexova. Roli më pëlqeu shumë dhe ia filluam punës. Kushtet nuk ishin të përshtatshme, ngaqë bënte ftohtë. Unë nuk e kam ëndërruar një rol të tillë. Shumë njerëz më kanë thënë se kam luajtur mirë. Xhirimi i një filmi kërkon mund të madh. Ne, në Kosovë, pak i kushtojmë rëndësi këtij zhanri. Duhet bërë edhe shumë gjëra që kanë mbetur pa u kryer”.⁸⁾

Me këtë dramë Nexhmija ishte zbulim, shkëlqeu si aktore, të cilën e lakmuan edhe aktorët profesionistë. “Angazhimi i Nexhmijes në film ishte një rast i mirë që ajo të shfaqë tërë fuqinë artistike të ndryrë edhe si aktore shumë serioze e dramës”.⁹⁾

Aty Nexhmija u paraqit bindshëm, si aktore komplete profesioniste dhe artiste e formuar. Me mjaft sukses luajti edhe në dramën televizive “Fluturimthi i micakut”, sipas skenarit të Hasan Dajakut e me regji të Emin Halilit. Luajti, pra Nexhmija në film e në dramë por, ashtu si edhe vetë jeta e Nexhmijes ishte dhe vazhdon të jetë një dramë e vërtetë.

Fati e deshi që njëra nga mbesat e saj, Fleta, të humbë shikimin, si pasojë e qëndrimit të gjatë në inkubator. E hendikepuar, kujdesin për të e merr Nexhmija. Shpesh e shihnim me Fletën simpatike në shetitje, për t’ia lehtësuar brengën. Ajo (Fleta) nuk e shihte Nexhmijen, por e ndiente shpirtin të bardhë, të madh dhe human të saj.

8) *Shygyri Galica, Kur gërshetohen kënga dhe aktrimi, interpretimi, Prishtinë, 30, 09. 1978, f. 12.*

9) *Vëhap Shita, Zbulimi i një Nexhmije tjetër në dramën televizive “E kafshoja terrin” të Ekrem Kryeziut, Prishtinë, 1. 04. 1978, f. 11.*

Tani Fleta gjendet përkohësisht në Zvicër.

“Të vish në Eichletten e të mos takohesh me vajzën, Fletën tonë, e cila botën e sheh me zemër, ngaqë të shikuarit e ka humbur që në fëmijëri të hershme, është sikur të shkosh në Mekë e të mos kthehesh në Qabe”!

Fleta është nga Prishtina. Ta shikosh këtë vajzë të kujton veprimtaren e njohur gjermane, Eva Brendlin - shqiptare. Sytë e saj të gjithë neve na rëndojnë dritën mbi qepallë, thonë bashkëkombasit e saj. Dhe Fleta e njeh shumë mirë historinë e popullit shqiptar, dhe siç thotë ajo “të jesh shqiptare e të mos e njohësh historinë e popullit tënd...”

Dëshira e saj e madhe është: “T”i regjistroj shkencat politike këtu në Zvicër, për të qenë një ditë në shërbim të Atdheut”. Shqiptarët thonë: “tani me Fletën e kemi më lehtë”. Ajo thotë: “E dua Kosovën”. Fleta (Mulliqi) vazhdimisht potencon: “Liria e Kosovës do të jetë drita e syve të mi”. (F. Brajshori)

Nexhmija është e ndieshme, kur bën fjalë për Fletën. “Ah, sikur të dija të shkruaja, ç’roman do të dilte”, thotë Nexhmija. Dramat e njerëzve janë të ndryshme, por sakrificat për t’i përballuar ato janë të veçanta. Nexhmija, me humanizmin e saj, bën që Fleta ta shijojë jetën me bukurinë e saj. Nexhmija dhe Fleta, tani, sikur kanë të njëjtën detyrë: të mundin errësirën me durim dhe zemërgjerësi. Brenga është e madhe, ashtu si shpirti dhe durimi i Nexhmijes dhe i Fletës.

FLETA

- Fleta Pagarushës -

(Vajzës që e sheh botën me zemër)

*Sytë e tu ma rëndojnë dritën mbi qepallë,
Në bebëza kam ngjyrën e lules kur të shoh.
Gjelbërimi në lot më bëhet barrë përjetë,
Por mburrem që me zemër sheh botën Fletë.*

*Së bashku jemi në teatër, ku me admirim aktrohet jeta,
Tërë skenën me lule e gjelbërim e shndrit, shpirtin e ke dritë
Për ta qesëndisur lojën na jep këshilla vasha
Kur ta pengon dritën kur ti je liqen plot mjellma*

*Sa mirë të mora inat kur të vëreja sonte,
Më bukur se unë e vështron botën me yllin tënd
Dhe me duf thashë: teatër është Jeta,
Ia kam lakmi vajzës që me zemër i bën dritë tokës, apo jo Leta
Sejdi BERISHA, qershor 1993*

Thanë për Nexhmijen - Fenomenin e muzikës sonë

*Zëri i Nexhmijes është i ngrohtë, i ndjeshëm, i
dridhshëm me mundësi të pakufishme.*

Zhyliet Greko

VII

ZHYLIET GREKO:

Kurrë gjer tani nuk kam pasur rastin ta dëgjoj as këtë këngëtare të jashtëzakonshme, as muzikën shqiptare shumë interesante. Më duket se në të ndjej diçka orientale, por paska shumë gjëra specifike. Për mua kjo është një gjë e re. Fatkeqësisht nuk e njoh gjuhën. Sikur ta kuptoja - më mirë. Nexhmije Pagarusha ka një zë të jashtëzakonshëm. Për zë të bukur rëndom thuhet se është i ftohtë, por ky zë është i ngrohtë, i ndjeshëm, i dridhshëm. Tek asnjë këngëtare nuk kam hasur cilësitë që ka Nexhmija. Jam e sigurt se ajo do ta pushtojë publikun frëng. Mundësitë e saj janë të pakufishme. Repertorin me siguri do ta ketë të pasur, që nga muzika popullore e deri tek ajo klasike dhe argëtuese. Menjëherë mund të them se ajo është artiste e madhe dhe talente e rrallë. Kjo që dëgjova tani është një përjetim i rrallë. Jam e sigurt se edhe shtëpitë më të njohura të botës si “Filipsi”, “Pate Markoni” etj., do t’i ofronin të inçizojë disqe për nevojat e tyre. Nexhmijen nuk do ta krahasoja me asnjë këngëtare, sepse mendoj se do ta fyeja. Ajo është unike. Me dëshirën e madhe, do të viheshja në kontakt me të. Do të isha shumë e lumtur, sikur të përkthehej e të adaptohej në gjuhën shqipe diçka nga repertori im dhe ta interpretonte Nexhmija.

Do t’ia dërgoj fjalët dhe notat e, po që se ajo dëshiron, do të bënim një lloj bashkëpunimi.

ÇESK ZADEJA:

Kjo këngëtare e talentuar, me një diapozon të gjerë emocional, me një poetizëm, me mjeshtëri të lartë, e dalluar për një interpretim

të sinqertë dhe plot ndjenja në përgjithësi.

Logjika me të cilën ajo transmeton botën shpirtërore, që ndryn në vete kënga popullore, rrejdh në vokalin e këngëtares së natyrshme, me mendime dhe poetizëm bindës.

RAFET RUDI:

Nexhmije Pagarusha hyn në radhën e atyre personaliteteve, në muzikën tonë, që e shënojnë fuqishëm kohën e vet. Praktikisht periudha kohore në të cilën ajo vepron, mesi në të cilën ajo zhvillon aktivitet si dhe zhanri, të cilin ajo e kultivon, identifikohen plotësisht me të, me zërin e saj, me frymën e saj...

Është fat i mirë i muzikës shqipe që kishte një interprete me mundësi vokale të jashtëzakonshme në diapazon të zërit me çka kënga jonë fiton një shtrirje të ariëve të zhvilluara mirë, interprete me një diksion perfekt, me ç’rast gjuha shqipe kumbon qartë e thekshëm dhe interprete me një ngjyrë specifike të zërit, me çka kënga jonë merr një dimension, të një muzike “distinguee”, të veçantë dhe elegante. Çështje tjetër që lidhet me artin e Nexhmijes është bashkëpunimi i saj me kompozitorin tonë Rexho Mulliqin. Jo vetëm për këngët e saj emblemike, “Baresha” dhe “Një lule”, që i referohen këtij bashkëpunimi, por, para së gjithash, për shkak të një bashkëpunimi të jashtëzakonshëm të dy artistëve të veçantë, të cilët pa ndërprerë e frymëzonin njëri-tjetrin, zbulonin në njëri-tjetrin hapësira të reja mundësish, thjesht bashkëpunim të dy artistëve në mes të cilëve qarkullonte një energji e një kreativiteti të lartë. Për aq sa ata njëri-tjetrit i dhanë, për aq fitoi kënga jonë.

RAMIZ KELMENDI:

Nexhmija

Si lum e lum ata të rrallë ,për ata, si u thotë populli, që lindin me yll në ballë, e pse jo, madje dhe hiç më pak, lum e lum edhe për atë popull që i lind, që i ka, që i nderon (pse e nderuan) dhe mjafton t’u zësh në gojë vetëm emrin, ose vetëm mbiemrin, e ta kesh saora

parasysh tërë figurën, personalitetin, veprën. Se me gjithë çfarë bënë, bënë emër. U bënë emër. U bënë të merituar e të nderuar. Të çmuar.

Një emër i tillë në muzikën shqiptare, një emër i tillë në mbarë kulturën tonë kombëtare, është dhe emri: **Nexhmija**.

Se jo në çdo popull dhe jo çdo ditë lindin talente nga më të rrallët, artistë nga më të mëdhenjtë, emra që nderojnë dhe krenojnë kombin, qytetërimin e tij, kulturën e tij.

Populli ynë, përkrah emrave të mëdhenj, prijatarë nga më të ndryshmit, pati jo pak dhe femra prijatare, duke nisur nga Teuta. Bënë emër dhe na bënë nder Elena Gjika - Dora d'Istria, Laskarina Bubulina, Nora e Kelmendit, Shote Galica, Gonxhe Bojaxhiu - nëna Terezë, Motrat Qiriazi, Sevastia dhe Parashqevia, e në këtë artin e Nexhmijes, më e para dhe më e madhja: Tefta Tashko Koço dhe, shoqja e saj Marie Kraja.

Nexhmija, falë pakujdesit dhe mospërfilljes së atyre që vendosin për rrugët e zhvillimit të mëtejme të talenteve nga më të rrallët, nuk studioi kanton në Konservatorin e Parisit si Tefta Tashko Koço, as në Konservatorin e Romës si Jorgjia Filçe (Truja), as në Konservatorin në Austri si Marie Paluca (Kraja).

Artisti, thonë, krijon me gjallje bazamentin e përmendores së vet, ndërsa ardhmëria është ajo që ia vë (ose jo) bustin. Më e mira soprano - koloraturë shqiptare, Tefta Tashko, nga të 37 vjetët e jetës, 22 i kaloi jashtë vendit të vet, vendit i cili mezi ia siguroi, asokohe, një piano. Shoqja më e denjë e Tefta Tashkos, mbase këngëtarja më e madhe dhe më e çmuara e këngës sonë poulllore, e cila do të ketë ca më vonë një motër të vet më të re në Kosovë, të denjë t'i vihet përkrah, Nexhmijen, Marie Kraja, me Konservatorin e mbaruar në Austri, u emërua mësuese e gjimnastikës në një shkollë të Shkodrës.

Edhe Nexhmija, e përgëzuar dhe e pagëzuar si "Bilbili i këngës shqipe", "Zëri më i bukur dhe më i ëmbël i Kosovës", "Ambasadorja jonë e kulturës", "Artistja jonë e madhe e këngës popullore shqipe",

që për shumë vjet me radhë shkriu veten, energjitë dhe trohët e fundit prej artisteje të madhe në bazamentin e përmendores së vet, zor të ketë qenë dhe zor të jetë e kënaqur. Jo pa ndjenjën e borxhit bukur ta madh që i kemi dhe i mbetemi, u desh t'i mbushë të gjashtëdhjetat dhe Shkupi të gëzojë nderin (u qoftë aferim atyre që u kujtuan dhe e organizuan!) për të mbajtur një akademi solemne.

Populli që nderon njerëzit e vet të mëdhenj, njerëzit e vet të rrallë, shkrimtarët, artistët, shkencëtarët, para së gjithash e mbi të gjitha, nderon veten. Një popull që u ngre përmendore figurave dhe personaliteteve të veta më të nderuara, ai popull, para së gjithash e mbi të gjitha, i ngre përmendore kulturës së vet, qytetërimit të vet, historisë së vet. I ngre përmendore vetvetes.

Unë kam një kënaqësi të rrallë që, të paktën me këto fjalë përrurimi e përgëzimi, fjalë të përvuajtura e të vockëla për punën e madhe dhe artin e lartë të Nexhmijes, po e thyejmë me njëfarëdore atë ligjin tonë të pashkruar që nuk na bën nder: jo t'u ndërtojmë më të merituarve tanë, qoftë larg, bustin, por as t'ua çmojmë e t'ua nderojmë, t'ua vëmë në spikamë e t'ua kujtojmë madje bazamentet e busteve të tyre kurrë të ngritura nga pasardhësit, që pandehnin se me ta nis bota. Lodheni mendjen një çikë dhe pale a mund t'ju kujtohet fare qoftë edhe një përmendore e vetme në të gjitha trojet tona etnike këtej kufirit me shtetin tonë amë, përmendore e ndonjë shkrimtari, artisti a shkencëtari shqiptar! Asnjë! Asnjë fare! Dhe, përse ta fshehim: jo gjithmonë që i huaji ai që nuk na lejoj këtë! Jo gjithmonë. Mbushi dhe kaloi të treqind vjetët e vdekjes i linduri në Gur të Hasit, skaj Prizrenit, dhe i vdekuri në Prishtinë, 363 vjet i vjetri, po më i lashti dhe më i merituari punëtor, aq i mençur i këtyre trojeve, Pjetër Bogdani, po nuk mbahet mend, sot e treqind vjet, t'i jetë kujtuar ndonjërit nesh: o, burrani! T'ia ngrehim bile Pjetër Bogdanit një përmendore, qoftë në Gur të Hasit, qoftë në Prizren, qoftë në Prishtinë!

Nuk e di dhe s'ma ha mendja gjithaq se ndoshta me këto ngushëllova sadopak Nexhmijen për pakujdesin dhe pamiradinë tonë karshi meritave dhe artit të saj, që do të mbetet përgjithmonë një vlerë e shquar në kulturën tonë shqiptare dhe një perlë, një yll, në panteonin e muzikës sonë, një rruazë smeraldi në gjerdanin e këngës popullore shqipe.

Për një popull, si ky yni, i vetmi a më i madhi përjashtim ndoshta në krejt rruzullin tokësor, NJË popull i ndarë në DY pjesë, në TRI fe, në PESE shtete, me SHTATË milionë banorë, po ama jo më pak se me NJËQIND E NJËZET E SHTATË parti, paraparti e pasparti, mbiparti, mesparti e nënparti, me gjithëfarësoj shoqata e korporata, nuk është mençuri, është luks i madh, është në të mirë të së keqes sate, është dëm, është gabim, është e pafalshme, është kundërproduktive dhe kundërkombëtare, të harrosh, të mos çmosh dhe të mos nderosh njerëzit e tu të mëdhenj, të mos vlerësosh vlerat e mirëfillta të tyre, të zvogëlosh madhështinë e tyre duke privuar kështu vetveten nga begatia e jashtazakonshme e tyre.

Jo çdo ditë lindin Nexhmije.

Lindën shumë këngëtare në ndërkohë. Këngëtare të mira dhe shumë të mira.

Por një këngëtare mbetet e paharruar, mbete atje lart, në majë të këngës shqiptare: Nexhmija. Prandaj, Nexhmije, të na rrosh edhe shumë vjet dhe ta paçim borxh!

(28. 5. 1993)

MARIE KRAJA:

Nexhmije Pagarusha është një grua e mirë, e mençur dhe e bukur. Ajo ka një brendësi të vullkanschme plot muzikalitet, me shpirt të madh, me një botë të madhe, me një zë të mrekullueshëm. Unë kam pasur rastin ta takoj në Prishtinë dhe ajo, përveç që është këngëtare e veçantë, është edhe grua e mrekullueshme dhe mike e madhe.

Shpirti i saj i madh bëri muzikë të madhe. Unë e admiroj Nexhmijen.

VAÇE ZELA:

Këngët e Nexhmijes, jo vetëm i kam interpretuar, por edhe i kam ndjerë. Ajo ishte një artiste e madhe dhe e papërsëristshme. Kam pasur shumë takime me të dhe mund të them se Nexhmije lind njëherë në njëqind vjet. Unë jam krenare që kisha rastin t'i interpretoja disa këngë të saj. Nexhmijen e ndjeu populli, artin e saj e "preku" dhe e shijoi populli. Ajo ishte këngëtare e masës dhe e shijes së tyre. Kam shumë kujtime të mira me të dhe të paharrueshme.

Ju që i keni hyrë një pune të tillë keni bekimin tim.

Ju lumtë! Ju bëni një punë të mrekullueshme.

AVNI MULA:

E quaj veten të nderuar që mund të flas për Nexhmije Pagarushën, aq më shumë jam i nderuar të flas për personalitetin e saj.

Nexhmija është një grua elegante, e gojës, e mendjes, e sjellshme, moderne dhe e xhymertë. Këto fjalë janë tiparet që i kam parë te Nexhmija. Por jo vetëm kaq. Ajo është një artiste e vërtetë, një patriotë e madhe, ajo është edhe një politikane e zgjuar dhe me një diapazon të gjerë. Me Nexhmijen jam takuar me dhjetra herë dhe vazhdimisht kam fituar përshtypjen se Nexhmija, përveç që është artiste e madhe, është edhe njeri i madh. Ajo është aq e madhe si artiste, saqë as vetë nuk e di. Artistit nuk i majfton vetëm zëri. Nexhmija, përveç zërit, kishte edhe sjellje të një artisteje në skenë, kishte ngjyrë dhe stil që shumë këngëtarëve u mungojnë. Nexhi, siç e thërras unë, u ka lënë brezave që vijnë visare të padiskutueshme të artit tonë popullor. Faleminderit, Nexhmije për atë që ke bërë për artin dhe kulturën tonë.

INVA MULA:

Unë isha shtatë vjeçe kur me babain (Avniun) dhe nënën (Ninën) asistova në një koncert të Nexhmije Pagarushës. Isha e vogël të gjykoja për vlerat e Nexhmijes, por e di se, në atë koncert, kam qarë nga emocionet. Prej atëherë kam një respekt të jashtëzakonshëm për Nexhmijen. Ajo ishte një këngëtare e mrekullueshme, që ne mund të mburremi me të. Është mëkat që nuk kishte mundësi ta shkollonte zërin, sepse ajo do të ishte e madhe, sado që kjo nuk ia ul prestigjin si këngëtare. Ajo më ka mbetur në kujtesë dhe tani kur dëgjoj këngët e saj, e shoh se sa e madhe ishte.

Gjykoj se asaj nuk i është dhënë vendi dhe tretmani i merituar. Ajo meritonte një status të veçantë, sepse edhe vetë ishte e veçantë. Admiroj punën tuaj, për ta bërë Monografinë e Nexhmijes. Ju dëshiroj suksese!

REXHEP MUNISHI:

Fenomeni Nexhmije Pagarusha

Të flasësh sot me pak fjalë për Nexhmije Pagarushën është e nevojshme që t'i zgjedhësh fjalët, që shprehin shumë për një personalitet interpretues që, me praninë e vet, shënoi një epokë të caktuar në kulturën dhe në artin tonë muzikor. Të thuash sado pak fjalë për të, duhet t'i flakësh epitetet konvecionale e të stërpërsëritura si dhe kortezinë për një karrierë të shkuar të shkëlqyeshme. Nexhmijen duhet ta konsiderojmë, jo vetëm sinonim të këngës shqiptare, por si dukuri për të cilën duhet thënë e shkruar në formë analitike nga aspekti specializues profesional. Ajo që do të mund të thuhej me këtë rast do të sublumohej në pika të shkurtra.

Nexhmija, me zërin e saj, biologjikisht i identifikoi gjenet e trashëguara të të kënduarit të bukur shqiptar. Interpretimi i saj ishte sintezë e harmonishme e stilit tonë kombëtar dhe e përsosmërisë së të kënduarit profesional-artistik. Ajo me ngjyrën e shkëlqyer dhe me diapazonin e gjerë të zërit, me qëndrimin e saj

prej artistjeje të madhe, me aftësinë realizuese, si dhe me muzikalitetin e saj, i përvetësoi të gjithë ata që patën fatin ta përjetojnë këngën e saj. Pikërisht kjo bëri që atë ta admirojnë me të njëjtën masë të gjitha shtresat e muzikëdashësve e, njëherazi, t'i përmbushë kriteret estetike të tyre. Ajo u bë fenomen artistik, definimi i së cilës duhej të bëhej sa ishte në skenë, sepse publicistika nuk arriti ta shpjegojë sa e si duhet fenomenin Nexhmije Pagarusha. Për Nexhmijen nuk ka nevojë të filozofohet, nuk duhet as patetikë, sepse cilësitë e saj interpretuese refuzojnë sentimente të panevojshme.

Përkundër afirmimit të lakmueshëm që arriti, mendoj se, në kushte të tjera, sikur t'i ishin ofruar më shumë mundësi, realizimi i saj artistik do të ishte më korelativ me mundësitë interpretuese - kreative që ka. Përkundër kësaj, fenomeni socio-kulturor e artistik Nexhmije Pagarusha do të mbetet i shënuar në historinë e kulturës sonë muzikore, kurse emri i saj do të jetë krenari për ta përmendur.

ENGJËLL BERISHA:

Të flasësh për Nexhmije Pagarushën duhet të kesh një dell poetik. Nexhmijen, në këngën tonë e bëri të njohur koha e gjatë në skenë, zëri i saj i bukur, karakteristik e pa sforcim artificial (dy oktava e gjysmë), korelante dhe këndimi nazal.

Nexhmija, në këtë anë të kufirit dhe Luçie Miloti, Naile Hoxha, Hafsa Zyberi, Vaçe Zela etj., në atë anë, e bënë atë që s'e bënë ndër ne ekonomia, as politika shqiptare e asaj kohe. Pa Nexhmijen ne, në Kosovë, do të ishim më të vonshëm dhe më të varfër.

PRANVERA BADIVUKU:

Më bëhet se tash kemi të rinj, të reja, që po merren me kompozime. Mirëpo, ata më tepër po orientohen nga zhanri që po i flet më tepër moshës së tyre - nga ro-muzika... Ata edhe po e ndjekin më tepër. Sa i përket kompozimit, nuk po përcaktohen për muzikën popullore, madje po më duket se pak po e ndjekin këtë.

...Me kënaqësi i pata hyrë kompozimit të këngës për Nexhmijen. Mirëpo, nuk isha e kënaqur me punën që kam bërë, ngaqë edhe teksti, edhe kompozimi është dashur të jenë shumë më të fuqishme! Sepse, Nexhmija meriton shumë më shumë...

ESAT RIZVANOLLI:

Nexhmija ishte këngëtare e vrullshme. S'ka dyshim se, si rezultat i bindjes për t'iu përkushtuar muzikës, ishte vetëdija për materialin muzikor të pasur që dispononte, dashuria e madhe që ushqente për muzikën dhe, para së gjithash, qëndrimi që kishte familja, e sidomos babai i saj, për parqitjen në skenën muzikore të Kosovës.

Erudicioni dhe ngrohtësia e zërit për vetë Nexhmijen që ajo me të cilën mposhti çdo dyshim në rrugën e saj, për t'u bërë një interprete e mirëfilltë.

Me paraqitjen e Nexhmijes në skenën muzikore dhe në eterin muzikor të Kosovës, muzika popullore shqiptare fitoi një këngëtare të denjë dhe reprezentative. Ajo, jo vetëm që u prezantua para publikut kosovar, por krijoi një kontakt të fortë edhe me atë jashtë Kosovës. Nexhmija, muzikës popullore shqiptare, ia rriti vlerën e afirmoi atë dhe nëpërmjet saj, afirmoi vlerat kulturore të popullit shqiptar.

Me zërin e saj të ngrohtë depërtues, lirik e dramatik, Nexhmija joshi shumëkënd.

Nexhmije Pagarusha, me veprimtarinë e saj të gjatë, la gjurmë të thella në artin e interpretimit, të cilat u shërbyen dhe do t'u shërbejnë, si udhërrëfyese, brezave të tërë të këngëtarëve tanë.

JUSUF GËRVALLA:

Kur është fjala për Nexhmije fenomenale, kualitetet zanore dhe interpretuese të së cilës historia e muzikës sonë i njeh si të atilla që nuk mund të përsëriten, së paku për një gjysmë shekulli, mund të thuhet se nuk jemi as afër t'i dalim borxhit.

Veçmas kur dihet se ky borxh reflektohet në mnënyrë regressive në favor të kulturës sonë muzikore.

Nexhmija shpesh na përmalloi duke na kthyer disa dekada prapa, kur ishte e para dhe e vetmja lule e denjë, me të cilën çelte pranvera e këngës shqiptare në Kosovë. Nexhmija ishte këngëtare fisnike dhe kishte qëndrim e shpirt artisti të madh.

EKREM KRYEZIU:

Një artiste siç është Nexhmija, ka një butësi të shprehjes, që ta sugjeron medimin në mënyrë bindëse, është karakteristikë e aktoreve të mëdha. Me plot të drejtë them, lindi një yll i ri i filmit - Nexhmija.

Kurse mua më vjen mirë që mora pjesë në këtë lindje, duke e angazhuar Nexhmijen në film. Kur para disa vitesh pata xhiruar këngën “Çou, more Rexho”, prosedeu im regjisorial ka qenë i atillë që këtë këngë ta shkoqis në mënyrë dramatike. Detyra e Nexhmijes ishte shumë delikate, por ajo ia doli ta kryejë me sukses. Atëherë jam bindur se kisha të bëja me një artiste, që ka vlera të larta interpretimi. Dhe, mund të them se ajo ishte artiste e lakmuar.

VALENTINA SARAÇINI:

Arti i të kënduarit të Nexhmijes

Këngët e interpretuara nga Nexhmije Pagarusha me ndjesi aq të thellë, aq krijuese, të përmend disa si “Baresha”, “Një lule”, “Lulzoi fusha, lulzoi mali”, do të thosha **JANË KLASIKA E KËNGËS SONË**, të pleksura me motive nga më të bukurat të sfondit të pasur të folklorit tonë burimor...

Nexhmija tërë jetën ia kushtoi artit muzikor, duke i dhënë vulën e vet, të këndimit artistik, të vlerave të vërteta. Në një nga veprat e filozofit të madh gjerman Niçe, veç të tjerash hasim një thënie të tij për artin, ku veçon se arti thith forcën e vet nga fuqia transformuese e dehjes, magjepsjes dhe dashurisë. Niçe po ashtu mendon se arti nuk e shpjegon jetën, por jeta me të bëhet e mundshme në përgjithësi. Dashurinë për artin muzikor, për këngën në veçanti, dhuntinë e mundësive të mëdha vokale

Nexhmije Pagarusha me mjeshtëri dhe subtilitet diti t'i ngërthejë në artin e të kënduarit. S'është pastaj për t'u çuditur pse zëri dhe të kënduarit e Nexhmijes deri më sot nuk mund të krahasohen me ndonjë tjetër në hapësirën kulturore shqiptare.

Në kulmin e karrierës së saj Nexhmija, nga ekspertët e huaj të muzikës është krahasura me Maria Kalasin.

Në kohën kur Nexhmija do të këndoje në koncertet e "Shotës" dhe do të afirmojë nëpër metropolet evropiane këngën dhe kulturën shqiptare, Kalas këndonte në Metropoliten, Skalën e Milanos... Nexhmija, fatkeqësisht, nuk ka pasur, përkrahjen e insitucioneve përkatëse kulturore të Kosovës që do të investonin në karrierën e saj prej operisteje, që do t'i shkonte Nexhmijes dhe padyshim do të kishte suksese të mëdha. Sidoqoftë, edhe kur ka pasur oferta prej të tjerëve për të bërë karrierë prej solisteje jashtë vendit, Nexhmija qëllimisht i dha përparësi vendit të saj, Kosovës, publikut të saj dhe afrimitit të këngës shqiptare që e brumosi me vlera të interpretimit artistik.

Nexhmije Pagarusha dhe këndimi i saj fituan vendin e veçantë dhe janë kreu i të arriturave në fushën e muzikës shqiptare kosovare. Arti i të kënduarit të Nexzhmijes, në veçanti, mundësitë e mëdha vokale prej toneve të ulëta plot thellësi, deri te një koloraturë e natyrshme përplot lirikë, ishin provokim, inspirim, por edhe sprovë për kompozitorët. Vlen të theksohet se Rexho Mulliqi ishte nga ata kompozitorë, bashkë me Lorenc Antonin, Krsit Lekajn, ndër të rrallët që ditën të shkruajnë këngët më të arriutra nga repertori i saj. Do veçuar bashkëpunimin e Nexhmijes me Rexho Mulliqin, jo vetëm se ishin bashkëshortë afro 12 vjet, por se gjatë kësaj kohe me këngët e shkruara nga Mulliqi, Nexhmija përfundimisht do të dëshmojë artin e këndimit të saj, do të thosha - të këndimit Nexhmijan.

Fakti që deri më sot nuk është botuar ndonjë monografi për Nexhmije Pagarushën, dhe që kemi aq shkrimtarë e krijues të gjeneratës së Nexhmijes që kanë mundur ta bëjnë këtë punë, flet

për një sindrom tonin shqiptar: nuk duam ose s'dimë ta çmojmë dhe ta afirmojmë sakrificën dhe vlerat e krijuara të atistëve tanë as në fillim, as në mes, as në fund të karrierës së tyre. Edhe pse sot të gjithë e dinë dhe ndjejnë artin e të kënduari të Nexhmije Pagarushës, më shumë se kurdoherë më parë. Ky botim është për t'u përshëndetur edhe për faktin që do t'ua lehtësojë brezave që vijnë njohjen e këngëtares më të çmuar, yllit të këngës shqiptare - **NEXHMIJE PAGARUSHA.**

(3 prill 1995)

SHPRESA GASHI:

Jemi mësuar, jemi rritur me konstatimin se Nexhmija është bilbil i Kosovës.

Ky krahasim, sado që i nxit emocionet, megjithatë nuk arrin ta shpjegojë fenomenin NEXHMIJE PAGARUSHA, nuk i jep përgjigje pyetjes pse me të identifikohet muzika popullore kosovare, cilësia e saj.

Dikush rëndësinë e saj në krijimtarinë muzikore kosovare e gjen në veçantinë e vokalit, mundësitë e mëdha interpretuese, skenike etj.

Mirëpo, edhe me këto analiza, sado të sakta, nuk arrihet të zbërthehet rëndësia e saj, pesha e saj, fenomeni i saj.

Për mua rëndësi të madhe ka koha kur ajo u paraqit në skenën muzikore. Ishte ajo kohë e transponimit të traditës sonë në vlerë institucionale dhe duhej gjetur çelësi. Ajo, jo vetmë që gjeti çelësin, por instaloi një vlerë që ne të gjithë e aspironim, orvateshim ta arrinim dhe në këto përpjekje, shpesh të mundimshme, ne, të prirë nga Nexhi, krijuam vlera institucionale dhe përcaktuam indentitetin e muzikës popullore kosovare.

Nexhi i dha vulën, i mundi ndikimet e huaja, na rrëfeu rrugën. Ajo ishte e para.

Ajo u shndërrua në institucion, ku u strehua tradita jonë, ku u krijuan vlerat e reja muzikore të këndimit shqip.

Përmes saj u ringjall gjeniu popullor, në kohë të vështira kur hutia ishte e madhe, ndikimet e huaja aq më të mëdha, humbja e identitetit muzikor realitet.

Kosova sot ka shumë bilbila, interpretë me mundësi të mëdha vokale, larmi specifikash, por Nexhi ishte e para që e transponoi traditën tonë muzikore në vlerë institucionale, instaloi modelin me të cilin sot e gjithmonë do të matemi, hapi rrugën për zhvillimin e veçantisë sonë muzikore.

Asaj ne nuk duhet t'i falënderohemi, ngaqë ajo nuk ishte e vetëdijshme se gjeniu popullor ligjëroi përmes saj, por duhet të konstatojmë rëndësinë e fenomenit të saj. Në këtë mënyrë ne ndërgjegjësohemi për vlerën tonë muzikore për të ngritur kështu një barrierë të pakarpërcyeshme për shundin.

FAHRI BEQIRI:

Me Nexhmijen më lidhin shumë kujtime të mira, njëherë si udhëheqës shumëvjeçar artistik i ansamblit "Shota" e më vonë edhe si kompozitor i disa këngëve të interpretuara nga ajo.

Nexhmija vazhdimisht ka qenë figurë qendrore e çdo koncerti dhe ylli vokal i tij. Tek ajo, në rend të parë, shquhet pastërtia intonative dhe dëshira e tepruar për të dhënë maksimumin në paraqitjen para publikut, qoftë edhe vetëm tre minuta.

Ajo dinte të vinte kontakt të ngrohtë me publikun dhe t'i përfitonte ata. Kishte sjellje korrekte në skenë dhe çdo lëvizje e saj ishte me shije të mprehtë. Ajo e ka merituar epitetin "ambasadore" e kësaj treve për melosin popullor. Përpunimet për kor mikst e orkestër me Nexhmijen, si soliste, kanë mbetur vulosje atraktive e një periudhe të papërsëritur. Unë, si kompozitor, jam nderuar në "Akordet '72", ku mora shpërblimin "Okarina e artë" për këngën "I dehur jam", të cilën aq bukur e këndoi Nexhmija. Edhe meloditë e rralla, nga fundi i karrierës së saj, i kam realizuar me orkestrën e SHKAA "Ramiz Sadiku", të cilës i prija unë. Nexhmija ishte e madhe dhe e pazëvendësueshme.

LUTFI TURKESHI:

Këngët e Nexhmijes janë pellg emocionesh artistike që kanë rrjedhë si Orfeu drejt Adës... Motivi i saj nuk është mungesë ose nostalgji për tjetrin, euridice për shembull, për të ndaluar vrapin shpejt, për të rigjetur të kaluarën, për të vendosur atë urëkalim midis gjeneratave, që në këngën e parë me cilësi dhe dhunti të çmuar artistike, me impenjim artistik gjithnjë në rritje, bëri përçapje të palodhshme për të pasuruar muzikën tonë.

Lëvrimet dhe kërkimet në thesarin e pashtershëm të traditës sonë ajo i pasuroi me zërin e vet të bukur. Ajo gjithnjë u paraqit edhe si kërkuese. Të jesh kërkuese në art do të thotë të hedhësh i pari hapin në rrugë të pashkelura, të thyesh normat tabu, do të thotë të rrezikosh. Nexhmija, e udhëhequr nga qëllimet e pastra ideo-estetike, eci, rrezikoi, hodhi shpesh hapa të parë dhe arriti deri në panteonin e muzikës sonë...

KRIST LEKAJ:

Të kompozosh për Nexhmijen është nder i madh, por edhe përgjegjësi e madhe. Unë kam kompozuar këngën "Rinia e humbur", të cilën Nexhmija e ka kënduar aq bukur dhe aq bindshëm, ashtu siç di dhe mundet vetëm Nexhmija.

Me Nexhmijen kam edhe miqësi familjare. Mund të mbetet simboli i bukurisë dhe i madhështisë.

Nexhmija në penën e krijuesve

Nexhmija ishte vetë poezi poeti

VIII

Sabri HAMITI:

NEXHMIJE PAGARUSHA

*Jeta nuk është këngë,
A fustan i qëndisur-
Mish i gjallë e gjak.*

*Se kush do një copë bukuri,
Të fsheh huqet e veta...
Edhe qorri, edhe shurdhani.*

*E gjithkujt po si e kurrkujt:
Madhëshritë e drunjtja
Pijnë ujë në pusin e ëmbël.*

*Del në derë me sy të njomë,
Ndihet jehonë e Bareshës,
Rexha nën patkonj të Kalit.*

*Kënga s'ia çon bishtin kandarit!
Ankthi ngjitet në qiell.
Mish i gjallë e gjak.*

(Trungu ilir, Prishtinë, 1979, f. 159)

Mirko GASHI:

VOX, VOCIS

*Plimi i bilbilave të fishkur
lulëzon,
sirenat-harpitë
hupin si kokrra e kripës
në zjarr,
Odiseu
nga veshët heq dyllin,
me frymë
bariu mbush fyellin,
Enriko Karuzo e Zhyliet Greko
heqin dore nga koncertet e veta,
Ima Sumak harron
prejardhjen e vet mbretërore
e shikon
fluturimin e kondorit,
në bebëzat e mia
ngjallën
ibis dhe papa avis,
në pyll
këlyshët e vet i harron arusha,
se ia thotë këngës
Nexhmije Pagarusha.*

Musa RAMADANI:

NEXHMIJE QUHET KJO POEZI

-Bilbilit të Kosovës-

Një ditë

*Zogu vari veten pse këngën e harroi,
Bjeshka sharroi n'tokë pse ushtimën e shkundi,
Lumi qau djepin pse rrjedhën e ndërroi,
Fyelli ia theu gishtat pronarit pse e humbi.*

Një ditë,

Pasi një hije e para me dritën u ndërrua!

Tani përditë

*Nexhmije-vajton zogu n'mëngjes
Nexhmije - gjëmon bjeshka pa shpresë,
Nexhmije - thërret fyelli përditë.*

Përditë

Pasi një lule n'melodi natyrën e zgjoi!

Adem ISTREFI:

PAGARUSHA

*Këndona ti, këndona ti,
shpirt i këngës - Pagarusha!*

*Fiu-fiu fishkëllen era...
Në livadhin e gjelbër s'vallëzojnë lulet
dhe shkunden gjethet, përtypen vjershtat
dhe thërret kanga me zanin e saj:*

“Digju, digju në shpirtin tim!”

*E lehtë e si era rrëshqet kanga nëpër bar
dhe lahet bari në vesën e saj
dhe këndon era kangën e saj.*

“S'më lanë lotët djalë me të pa ty...”

*Tufa-tufa mblidhen çikat
tufa-tufa shpërndahen çikat.*

*Oj zhanga-zhing kërkëllima e zinxhirëve
shkundet udhëve,
oj zhang-zhing zani i tyre lidhet nyja
dhe digjet kanga në shpirtin e tyre.*

*(Atje, në qoshe të rrugës, të pështynë Nexhmije.
Atje, në qoshe të rrugës, të gjuajtën me gurë.
Dhe re nën mjegull, nën shqelmat e tij. Mjekra
e një hoxhe të rrinte mbi krye. Dora e tij të
gjuante me gurë. E syni gjak lagej në shi.*

*E zani gjak klithi në shi:
Copa-copa po të më grini
copa-copa do të këndoj.)*

*Kaq shi pikëllimi s'pat asnjë re.
Udhëve me shi u rrit kjo kangë,
si lis në shkëmb e gjethegjelbër.
Këndona ti, këndona ti
shpirt i kangës Pagarusha!*

*“Digju, digju në shpirtin tim”
krejt u dogja në shpirtin tand.*

Shpirt i kangës Pagarusha.

*(Nga Përmbledhja,
Dritat e fjalës, Tiranë, 1972, f. 70, 71)*

Nexhat HALIMI:

Ç'PO NDODH ME ZJARRIN

*Copëza e përgjakur e ballit ndez qiririn
po sytë Nexhmije me vjet verbuar*

njerëzit harruar malet thinjur e fajkoi lart

*me zjarrin ç'po ndodh vaj me të gjeturat
gjuhës plagët i përlocasin për fyell
zogu i lashtë vjen mbi ëndërr*

*këputur nga mishi im i mërguar
hiri fluturon e prapë lind nga hiri*

*sepse ti këndon mbi glob mbi shpatë,
bashkë me trimat qëllon kafshën e zezë
vetëtima në gemb shndërrohet
nga kafka ime dhe vetë Pagarusha*

gjeli fluturon mbi portën e vjetër

*unazat lëvizin
zogitë e zi në varre të reja dasmat mort
daultet e pikëllimit*

mitit gjaku i rrjedh për veshë

*e fajkoi lart dhe njerëzit me male në zemër
ti këndon në një gur Nexhmije vajton
në një flamur*

mbi ëndërr zogu i lashtë fluturon

(Ankara, 11 shtator '80)

Edi SHUKRIU:

BARESHA E THANËS

Nexhmije Pagarusha

1. Erë e malit djepin përkundte

*Në mjegullirën e lartësive,
kreshtat e Pagarushës ndjenin
në prehër një lindje mbanin*

*Erë e malit djepin përkundte
pranë vatrës foshnja
ninulla vetes këndonte.*

*E,
në prag të njohjes,
mësuesi me shkronja në zemër
e peshë mbi supe,
ç'është dashuria mësonte.*

*Historinë e Pagarushës
bilbilat nisën
këmbëzbathur shpatijeve*

*Me rritën e gërshetave
zambakët e Prizrenit u gërshetuan
e Kalaja jehonën
e zuri në gji.*

2. Trete në ne

Këngë

trete në ne

nga ne vrujon jehonë

si

aromë dheu kosovar

ah flladitës në fushën mall

mbarsur

gurgullimë burim që miklon thellësitë

dhe çon peshë shekujt.

Ngjitesh Bjeshkëve të Nëmuna

me plakun që ruan kohët e kulçedrave

zbret në mrizë me nënën

në pshtjellak fsheh ditën e urisë.

Ti je ajo “ani mori nuse” që

në heshtje i përshpërit dashurisë

e zgjon mallëngjimin në skajet e botës.

3. Në gjah të bukurisë e dhimbjes

Pallatet grishnin

zgjodhe Olimp

kasollet tona.

Në kohë

zure frymë shqiponjë

në lartësi shpure.

*Bareshë apo Hyjneshë
të të them,
o bijë e Thanës?*

*Endesh përherë Zanë
fushave të mbarshura
e zemrave bjeshkëndritura
në gjah të bukurisë e dhimbjes.*

(Syri i Natës, Rilindja, Prishtinë 1986, 45-47)

Burim BARDHI

KUR TË RRITEM...

*Në më pyesni - Ç'ëndërroj,
Kur të rritem - tha Lidusha,
Me zë t'ëmbël të këndoj
Si Nexhmije Pagarusha!*

Nehat S. HOXHA:

NGUSHËSLIMI

*Sonte ngush'llim
unë kërkova
këtu pranë kësaj gote
se në të e pashë,
kujtova-
që fytyra jote.*

*Ankthi e dyshimi
sonte më mundojnë
shpresa e durimi
së bashku më tradhëtojnë.*

*Tash mbush gotën,
çohu n'këmbë,
or ti shpirti im,
gjuhën e kafshoj
me dhëmbë
për mua s'ka dashuri!*

Nuhi VINCA:

SHIU DHE LOTËT
(Nexhmijes)

*Sa e gjatë rruga e shiut shok,
Nga djepi rruzull në djepin tok!
Sa e afërt rruga e lotit
Nga hezimi vesë gjer te plaga e zezë!
Sa e gjatë biografi e dhimbjes,
Sa e dashur jeta e lindjes!
Sa e ngrohtë pika e shiut,
Sa përvëlues loti i fatziut!*

...

*Udhëtimi juaj shira prorre përjetohet
Thellësia juaj lot prorre ëndërrohet.
Kënga juaj, o shira, këngë e blerimit
Kënga juaj o lot, baticë e durimit.*

*Sa e qartë rruga jote, o shi,
Sa e fshehtë e lot, juaja biografi!*

*Ku buroni, pakkush ju sheh,
Kur rigoni, gjithkush ju njeh.*

*Atëherë lehtë ju njeh çdo fëmijë
Pakkush e kupton tuajën biografi.*

*Udhëtimet tuaja, o shira, prorre përjetohen
Thellësitë tuaja, o lot, prorre ëndërrohen.*

Marrë nga "Rilindja" 23 korrik 1988

Florë BROVINA:

NEXHMIJE PAGARUSHËS

*Brenda kafazit
merr rrugë,
gurgullon e rrjedh,
t'i përkujton muret
anë e mbanë
nëpër të qara
arrin në majë bjeshke
bilbil kafazi është
mbi supet e bareshës
në kullat tona
na zbukuron ditën
primadona zog kafazi
prek telat rreth e rrotull
kur shtrydhë shtrëngon
gulçim e mall,
zëri i saj ngrihet valë,
gurgullon e rrjedh
si loti, si dhimbja
dhe nuk i ndahesh
kurrë ledhatimit
të këngës saj
bilbilit në kafaz.*

Mehmet HAZIRI:

ERA E BLIRËVE

*Çupëza ime vetullylbhtë
më e bukura në Dardani,
Kënga e shqipes i përkund
lehtë e lehtë djepat me fëmijë...*

*Nga Gërmia fladi i verës
buzëmbremjeve krahët i shtrin,
Sa bukur kur ndezen dritat
në rrugën e blirëve n'Prishtinë!*

*Gazi i fëmijëve hyn nëpër vjersha,
trëndafilat çelin nëpër vargje,
Një këngë e Nexhmije Pagarushës
përhapet si fresku nëpër lagje...*

Nga cikli: "Mëngjeset në Prishtinë", 1980.

Qerim ARIFI:

PLISAT FAQENDRITUR MARSHUAN

I

*Ndalu për një moment. Këtu në këtë mehallë
Fillon një madhështi. Tingujt rrëqethin barin, në fund
det*

*Liqeni drishërin nga puhia e zërit të këngëtares, mbi
kodra*

*Blerimi kaplon; malet dalldisen në magjinë e toneve
Rrafshi i Dukagjinit vallëzoi me grunajet shtatë ditë e
net*

Ku mbaron dashuria fillon dashuria. "Në fillimin tim është fundi im"

Që nga kujtimet për Teutën

Dardanët kënduan,

*Përpara portave krushqit hoqën vallen. Fshtrat pritën,
Përcollën pranverën me bilbil në duar - që diti t'ia thotë
Këngës për rrudhat e tyre në ballë. Për shuplaka të lëna
ndër ara.*

*Dallgë-dallgë valët nga eteri erdhën dhe mbetën në ne
Na ajo na. Për të filluar diçka duhet të mbarojë.*

Nexhmija e ju.

*Dhe fshtarët me këngën për punën. Ju këndonin këngën
e tyre*

*Ata këngët tuaja - Koha mbaron tempuj e ruan tempuj.
Tempujt dhe tingujt tani përjashtojnë
pamjen e tyre të sfiungosur!*

II

"Kohë e tashme dhe kohë e ardhshme, janë ndoshta
 prezentë në
 kohën e kaluar"Edhe pse pas jetës do të mbetën gjurmë
 jete. Edhe
 Pas pranverës mbetën gjurmët. Kënga jehon
 Çdo herë në lugaja...
 Bilbili edhe shumë të tjerë këngën ua mësoi
 ata s'e harruan
 Të parin e tyre
 Anëmbanë, në çdo pore,
 jehoi krenaria
 Paepur... dëllinjat zgjatën degët e tyre duke
 pritur mirësinë,
 Plisat faqëndritur marshuan shesheve, kejeve-
 me vegjëli!
 Tëmtarët e fabrikave mësuan këngëtimin
 që në vete mbante magji!
 Vaporet në të katër anët shpërndanë vetëm
 muzikë, lumturi...
 Baletanët vallëzuan të ngashnjyera
 nëntë vite, pranë
 Gurrës me ujë të ftohtë udhëtarët u
 freskuan nëntë herë
 Kjo murosi shekujt më parë dhe shekujt
 pas të palosur-
 Liria diku në antikë zbukuroi për një
 Orfe të Ri. Andaj përpara Lumit vashat rrijnë dhe janë duke pritur
 gondolat e fateve
 Një këngë tënden dhe për ty do ta këndojmë,
 Nexhmije.

Shkëlzen ZHUBI:

LOT GËZIMI
(*N. Pagarushës*)

*Fytrëhëna veten ia fali
unit
e jetën këngës
refrenet ia dhuroi bilbilit
e
poetit fjalën
shpirtit ia rriti etjen
e
lotët i bëri gëzim,
duart iu mbushën me lule
sa
për shumë pranvera
(Puthje me lot, Fjala 1994, f. 98)*

Donika GASHI:

*Kur këndon Neshmija
Zgjohet zogu i verës
Bashkë me ëndrrat e mia.*

*Kur këndon Nexhmija
Shtat lëshon lulëkuqja e fushës
Me zërin e ujëvarës së Mirushës.*

*Kur këndon Nexhmija
Gufon rrjedha e lumit
Edhe në krahët e pëllumbit.*

(Nga përmbledhja, Ti je çdo gjë, Rilindja, Prishtinë, 1994, f. 49)

Sejdi BERISHA:

NEXHI

(Nexhmije Pagarushës)

Në skenë

Edhe një jetë zë përvëlues

Abetare

Tha njëri nuk di ç'është kënga,

Kërkova bilbilin

Më kaploi kënga deri sa më zuri gjumi,

Me ty e Fletën e përqaftuar e zgjova

Pranë oxhakut na rrëshqet flaka

Rini e plakur,

Ra perdja përgjithmonë.

A thua, Nexhi,

Zgjodhe aromën e jetës?

(Nga përmbledhja, Simfoni pritjeje, Dukagjini, Pejë, 1995, f. 80)

Ramiz KELMENDI

NEXHMIJE NË "GALERI LAFAJET"

Parisi është plot me shtëpi të mëdha mallrash. I ka, të thuash, në çdo hap: "Prentan", "Bazar d'Otel de Vil"...

Por, shtëpi mallrash mbi shtëpi mallrash është pa mëdyshe "Galeri Lafajet", një nga më të mëdhatë kësodore jo vetëm në Paris, po ndoshta edhe në mbarë botën.

Pa tepri: po të duash të vizitosh çdo stendë të kësaj galerie, të shikosh vetëm vitrinat e tyre e tërë ata artikuj të ndryshëm të ekspozuar me shije, si të ishte vërtet ndonjë ekspozitë e jo magazinë, shtëpi mallrash - njeriut i nevojiten të paktën një javë.

Për "Galeri Lafajet" mund të thuhet me plot të drejtë se në të mund të gjejë njeriu çdo gjë - nga gjilpëra deri te lokomotiva.

Kisha dëgjuar e lexuar edhe unë për "Galeri Lafajet".

Dëshirova, prandaj, ta vizitoja sa më parë, të bindesha edhe vetë.

Fillova njëherë të vështroja stendat me radhë, po kur pashë se koha po kalonte shumë shpejt e unë s'do të arrija deri në mbrëmje të shikoja as dy kate të saj, vendosa: po shikoj vetëm çfarë më intereson posaçërisht.

Me një pritje diskofili në kohë të fundit, zura të kërkoja atë pjesë të "Lafajetit", që mirret me shitjen e disqeve.

Pasi kalova një varg labirintesh të katit të parë, kur iu afrova pjesës ku ishin ekspozuar televizorët, radiot, tranzistorët, magnetofonët e prodhimet e tjera kësodore të çdo lloji, e dita: aty afër duhet të jenë disqet.

I gjeta më në fund.

Diskofilit, tek e sheh tërë atë mori disqesh në një vend, si të ishte shtëpi disqesh, i bëhet sikur ka arritur në parajsë dhe mahnitet.

Kahdo të sillesh: disqe. Kahdo të shikosh: disqe. Të gjitha me kopertina këngëtarësh më të njohur botërorë.

Megjithatë: myshteriu mund të orientohet menjëherë. Madje shumë lehtë. Në një vend shiten disqet e muzikës serioze, në një tjetër ato të muzikës argëtuese, mandej ato të muzikës popullore e të tjera. Në “Galeri Lafajet” ka stenda të posaçme edhe të disqeve të këngëtarëve më të popullarizuar, sidomos të muzikës argëtuese.

Kështu bie fjala, pashë standin e pagëzuar “Festivali i Sharl Aznavurit”. Aty afër: Zhilber Beko. Mandej: Edit Piaf.

Në atë të soditur të asaj begatie, thashë: pa le të shikoj mos është ndonjë disk në gjuhën shqipe.

Pasi flitet aq shumë për të, e thonë se s’ka gjë që lypet e nuk mund të blihet në “Galeri Lafajet”, thashë: ja, pra, unë dua të blej një disk shqip. Një të Nexhmije Pagarushës, m’u mbush mendja. Dhe, vendosa ta lyp në mjedis të Parisit, mu në shtëpinë famëmadhe të mallrave.

E dija se do t’i zë në mat-pozicion, qysh përpara. Iu afrova asaj pjese ku shiten disqet e muzikës popullore. Njërën nga ato katër-pesë shitëse e pyeta:

- Ju lutem, keni ndonjë pllakë të Nexhmije Pagarushës?

Po, mu kështu i thashë. Pa kurrfarë shpjegimi tjetër. Pa i treguar cila është Neshmije Pagarusha, çfarë këngësh këndon, a ia ka dëgjuar njëherë zërin, se mos është e detyruar ajo në Paris të dijë për një Nexhmije që jeton atje diku, kushedi ku, në njëfarë qyteti të vogël të Ballkanit.

- Si urdhëroni, zotëri, - ma ktheu ajo me buzëgaz dhe, pa më lënë të vij mirë në vete, më vuri përpara një pllakë të Nexhmijes me katër këngë shqipe, titulluar “**Shanson popuyller dë Skipetar dë Jugosllavi**”. Po, në ato mbështjellëse të bukura të këtij disku francez, lexova edhe emrin e Nexhmije Pagarushës.

Natyrisht s’e zgjata më tutje. Si mund të më bindte ndryshe “Galeri Lafjet” pos kështu?!

(“Rilindja”, 1965)

Ibrahim KADRIU

ARSYE PËR TË SHKRUAR

(Reportazh)

Vetëm atëherë kur s'i kemi në bashkëkohësi, krijohet ajo kërkesa (standarde), për shënimin e datëlindjeve ose të datëvdekjeve... Ndërkaq, kur autoritetet e ndryshme e arrijnë ndonjë shkallë pleqërie - nuk i shohim, nuk i dëgjojmë: bëhemi mospërfillës individualë e, besa, edhe kolektivë... Mandej, në ndonjë rast protokolar, sa për sy të opinionit, na merr malli për do kohë dhe na pëlqen të shëtisim në hapësirat e dikurshme të autoriteteve... Në ato raste, bie fjala, me krenari themi: "Na ishte dikur Nexhmije Pagarusha", duke harruar se ajo është edhe sot.

Është në Prishtinë. Njëmend nuk është në atë moshën e dikurshme, por është e tëra, me famën që e kishte dhe që do ta ketë dhe me autoritetin e të parës këngëtare shqiptare kosovare, me fizionomi të plotë profesionale.

Është në banesën e saj, në Prishtinë, e shoqëruar me moshën e saj dhe me telashet shëndetësore, të cilat që para dhjetë vjetësh, nuk e lënë të këndojnë... Është ndanë mospërfilljeve individuale e, besa, kolektive, është me vetminë. Ndoshta kjo është fjalë e madhe, ama kështu duhet të thuhet për rastin e kësaj artisteje, e cila, përmes telefonit, të përgjigjet me një zë të mbytur, zë që referon lodhje... E ke parasysh Nexhmijen e hareshme. Nexhmijen këngëtare, aktore..., kurse ajo, me atë zë të lodhur, të bën me dije se, pas sa kohësh, ja pikërisht në atë moment - e ka të ndezur një cigare. Çudë. Ajo kurrë nuk e kishte në qejf duhanin, domethënë është e mërzhitur.

Desha të lëshoj receptorin, sikur të mos prezantohesha menjëherë...

- Të pashë në gazetë, prandaj të telefonova.

- Se ndryshe nuk do të kujtoheshe?

- Më erdhi mirë për mbrëmjen artistike që organizohet në SHOË dhe mora obligimin që ma thanë kolegët të shkruaj, që të bëj një reportazh nga ajo mbrëmje. Kohëve të fundit kemi mbetur në mëshirën e videokasetave me këngë e kolazhe gjithëfarëshe. Ndërkaq, derisa e shikoja atë reklamë në gazetë për mbrëmjen artistike thashë: nuk mbaj mend të jetë bërë ndonjë videokasetë për (ose me) Nexhmijen. Dhe, një kështu, e gjeta një arsye të fortë për të shkruar.

- Për këtë më ftove?

- Po, që ta di çfarë do të jetë disponimi yt i sontëm: çfarë do të na këndosh?

- Më kanë thënë se para orës njëzet do të vinë të më marrin dhe do të shkoj. Do të gjendem aty vetëm me prani, por jo edhe me këngëtim.

- Kur i pashë emrat e bartësve të atij programi kulturor e artistik kisha arsye të plotë që t'i sillja numrat e telefonit tënd, ndërkaq e kam ndërmend të vij sonte në atë program që ta shkruaj reportazhin.

- Pikërisht sonte?

- Po, mendoja se do të këndoje, se do të dëgjoja atë Nexhmijen e dikurshme, por, nejtë... A ke arritur të bësh ndonjë organizim për publikim e ndonjë videokasetë?

- Aman, të thashë se e kam ndezur cigaren, jo nga dëshira, por nga mërzia. Çfarë videokaste, bëj! Asgjë nuk kam, asgjë! Krejt çka kam bërë - ka mbetur diku në sirtarët e Radios dhe të Televizionit. Nuk kam haber se çka ndodhur me ato incizime të mia. Atëherë, kur merrej vesh se ç'do bëhej, u thosha njerëzve që mund të bënin punë: aman, nxirrni çka mund të nxirret, që të ruajmë diçka nga ajo vlerë që e kemi krijuar me dekada... Por, nuk di ç'u bë. Nuk kam haber.

- Nuk e dija këtë.

- Kjo është e vërteta për mua: asgjë nuk kam.

- Sidoqoftë, programi i sontëm është shumë i qëlluar. Ju lumtë atyre që e kanë organizuar. Në ç'kohë do të fillojë ky program?

- Nuk e di, por e di se janë vendet e rezervuara.

- Do të përpiqem të rezervoj një vend.

- Do të më vinte mirë, po qe se arrin të rezervosh, - tha Nexhmija me atë zërin e saj të lodhur, zë i trashë që ta përkujton varioncionin melodik të “Bareshës”, atë kontrastin karakteristik të papërsëritshëm.

Zëri i saj i lodhur, më nuk shpreh nuanca melodie, por revoltën për humbjen e jetës kulturore institucionale... Shkaku i kësaj humbeje tragjike, e njerëzve të cilët e kanë për obligim moral të qëndrojnë gatitu para autoriteteve që, në periudha të ndryshme, e mbajtën gjallë frymën tonë.

Nexhmija ishte ajo që shëtiti gjithandej ku duhej të shëtiste, që ofroi gjithë atë që mundi të ofrojë, por që, ja tashti, në këtë ndërkohë hipokrizie, e kishte ndezur atë cigare dhe ishte e mërzitur.

Ishte vetëm në banesën e saj, në Prishtinë. Ishte duke pritur të vinin e ta merrnin për ta çuar atje ku do të takohej me mysafirë, të cilët s'i kanë parë me vite të tëra.

Për motiv të këtij shkrimi, pra, u zgjodh mentaliteti ynë i çuditshëm. A jemi të tillë apo jo?

Ali OLLONI:

ZONJA ME BORZILOK

Ditë uikendi, paradite, zbret shkallëve para Postës dhe vazhdon mbi platonë e “Kurrizit”. Nga larg duket se zbret një zonjë, me atë hapin e ngadalshëm, por të sigurt dhe, sa më afër që i shkoj, më del përpara një zonjë e rëndë me fustanin ngjyrë gri, me flokët e lidhura tubë të cilat i mbante një krëhër ngjyrë kaf, me një buqetë borzilok (fasligen) në dorën e majtë dhe me qese najloni në dorën e djathtë ku shiheshin perimet e freskëta.

Nexhmija!? Po po, ajo qenka.

Ashtu si dita e kësaj vere, edhe Nexhmije Pagarusha e ka ulur shikimin kah toka dhe sikur numëron pllakat e platosë. Për një çast (ende pa iu afruar), gati si në ëndërr, më doli ajo zonja e rëndë, me fustanin e gjatë plot ngjyra, atë natë kur u shënuua 25-vjetori i vdekjes së Katarina Josipit e kur Nexhmija nuk mund të fliste nga duartrokkitjet e të pranishmëve, më doli edhe ajo zonja e koncerteve të Panumërta në të cilat mahniste me zërin e saj të ëmbël: më dolën disa “Akorde të Kosovës”, po edhe turnetë e saja, pastaj një sekuencë filmike...

Dhe sa më afër që i shkoja, e “shikoja” në shumë vende, në skena të ndryshme, në udhëtime, para publikut që aq shumë e deshi, pastaj në kasete e disqe, në muhabete të punonjësve të kulturës e të dashamirëve të artit. Zonja me borzilok tashmë ishte krejt afër. Nuk desha t’ia prishja atë qetësi të vetmisë verore, kur i ngriti sytë si para kamerave, buzëqeshi dhe ma ktheu përshëndetjen me një “mirëdita” dhe me zërin e saj të ëmbël që nuk e paskam dëgjuar moti.

Vazhduam në drejtime të kundërta. Tashmë mu kishte “këputur” shiriti i së kaluarës dhe më mbeti në kujtesë zonja me fustanin ngjyrë gri, me flokët e lidhura tubë që i mbante një krëhër ngjyrë kafe, me një buqetë borzilok në dorën e majtë dhe me qese najloni në dorën e djathtë ku shiheshin perimet e freskëta.

Ajo tash i gjason datës.

Nexhmija në intervistë

Nuk i dua shkrimet sensacionale dhe gazetarët që ngarendin pas tyre.

N. Pagarusha

IX

Rexhai SURROI:

JU PREZANTOJMË NEXHMIJE PAGURUSHËN

“Zani i saj, i pastër si uji i burimit, i buçitshëm si rrjedha e buçitshme e ujit në ujëvarë, i këndshëm si puhija freskuese në pikë të verës - asht i tillë, që e kaplon njeriun për vete, e lidh të thuash e magjeps, duke e detyruar që të ndjekë deri në fund rrugën dredharake, me kthesa të pandieshme, të këtij zëri”.

Nuk ka nevojë të flas për biografinë e saj. Në vend të shënimeve më pak interesante, zgjodha 14 pyetje, të cilave Nexhmija iu përgjigj kështu:

1. Kur keni kënduar për herë të parë para publikut?

- Kaherë. Isha në klasën e katërt të fillores në Rahovec. U organizua një shfaqje për nxënësit. Unë këndova, natyrisht, pa përcjellje muzikore. Nuk prisja se kënga ime do t'u pëlqejë aq shumë mocanikëve të mi.

2. Ndoshta kjo paraqitje e parë nuk ka qenë vendimtare për zgjedhjen e rrugës tuaj jetësore. Çka ju lidh për këngën aq shumë, saqë u bëtë ihtarë e saj e vendosur?

- Isha nxënëse e gjimnazit Prishtinë. Melihat Hasani, shoqja ime e shkollës, në atë kohë këndonte në Radio Prishtina. Një ditë më ftoi për të shkuar në audicion. Vazhdimin mund ta merreni me mend edhe vetë. Inçizova disa këngë. Më vonë edhe disa këngë të tjera. Dhe hyra “në këto daulle”.

3. *Nuk na thatë ende kur u paraqitët për herë të parë para publikut serioz, si këngëtare?*

- Vitin 1950, shkova në Beograd për të vazhduar mësimet në shkollën e mesme të muzikës. Kriteriumi i provimit pranues ishte shumë i ashpër. Në audicion këndova vetëm një këngë dhe... U pranova. Si nxënëse e shkollës u regjistrova në shoqërinë kulturo-artistike të Beogradit "Ivo Lolla Ribar". Vitin 1951 kjo shoqëri organizoi një mbremje në sallën "Brozhidar Axhija". Këngët që këndova u pritën shumë bukur. Si kishin për të thënë gazetarët, duartrokitjet qenë frenetike e shumë të gjata. Së shpejti mbërrita edhe para mikrofonëve të Radio Beogradit. Si anëtare e ansambllit të radios, këndova edhe në sallën e Universitetit të Kollarcit.

4. *Repertori i këngëve që këndonit është shumë i madh. Cilën prej këngëve doni më shumë se të tjerat?*

- "Unë ty të kam dashtë". Një kohë të gjatë nuk e kisha inçizuar këtë këngë e mandej nuk e këndoja as në koncerte. Kjo është kënga ime dhe e këndoj atëherë kur më këndohet. Më tepër për vete dhe qejfin tim. Mos më keqkuptoni. Megjithëse ekzistoj për dëgjuesit e mi, kam të drejtë të mbaj për vete të paktën një këngë.

5. *Në kohët e fundit jeni duke paraqitur edhe mjaft melodi argëtuese. Mos jeni para dilemës: popullore apo zbavitëse?*

- Është fare i vogël numri i melodive argëtuese që më pëlqejnë. Dilemë nuk ka. Çdo muzikë e bukur është e këndshme, qoftë popullore, qoftë serioze.

6. *Ju po shkolloni zanin në Beograd?*

- Po. Të gjithë njerëzit po shkollohen, për të qenë më të aftë. Edhe unë kam këtë dëshirë. Mund të them se profesori im Nikolla Cvejiqi është mjaft i kënaqur me përparimin tim.

7. *Cilin çast e konsideroni me të rëndë në jetën tuaj?*

- Çastin e vdekjes së babait.

- *Po në jetën muzikore?*

- Para një viti, kur shkova për të shkolluar zërin. Kisha bindjen se isha duke humbur ngjyrën e zërit, prandaj në audicion u frikësova shumë. Frika ime ishte e pavend.

8. *Sikur të hapesh opera në Prishtinë, çfarë do të dëshironit të interpretohej në hapjen e saj?*

- Një oper e shkruar në gjuhën shqipe. Mos ma merrni për keq: në këtë operë kisha dëshirë të debutoja si këngëtare e të mendoja edhe njëherë për mundësitë e hapjes së operës në Prishtinë. Më duket se mbarë zhvillimi i jetës sonë, pra edhe i jetës muzikore, paraqet përditë e më shumë nevojën e krijimit të një ansambli të vogël të operës në qendrën e Kosovës.

- *Cila operë klasike të do vinte në kondisrim, sipas dëshirës tuaj?*

- Nuk mundem të them. Veprat klasike janë kolosale e të rënda e ne, tani për tani, s'kemi shumë këngëtarë.

9. *Kantata e Rexhep Mullajt është një prej të arrirave tona më të mëdha në lëmin e muzikës serioze, ju keni interpretuar me mjaft sukses pjesën tuaj në këtë kantatë. Pse nuk paraqiteni para publikut edhe me pjesë serioze?*

- Unë jam e gatshme të dal edhe tani para publikut me një koncert të posaçëm, i cili do të ishte mozaik i veprave të popullarizuara të mjeshtëreve më të vjetër e të popullarizuara. Por, fatkeqësisht, tani për tani nuk ka organizator të një koncerti të këtillë. E më duket se do të kem rastin të paraqitem më vonë në njërin prej punimeve më serioze të Rexhep Mullajt në lëmin e muzikës.

10. Ku e kaloni kohën e lirë?

- Kam dëshirë të dëgjoj këngë të operave, të shikoj pjesë teatrale dhe të lexoj. Pasi kënga për mua nuk është vetëm profesion, por edhe pasion, edhe ajo merr pjesë në kohën time të lirë.

11. Në cilin vend keni pasur deri tani pritje më të përzemërt?

- Nuk kam mundur të bëj ndonjë ndarje. Shumë më lehtë jam munduar të them ku nuk më kanë pritur mirë. E unë kam marrë pjesë deri tani në nja 300- 400 koncerte.

12. Cilët janë këngëtarët që adhuroni?

- Në muzikën popullore duetin Gjini-Hoxha.

13. Cilat vende e shtete kishit dëshirë të vizitonit?

- Italinë, djepin e operave dhe të muzikës së bukur.

14. Cila është dëshira juaj?

- Të hapet opera në Prishtinë; me gjetur këngëtarë shqiptarë, të cilët kishin të shkolluar zërin dhe Radio Prishtina të organizojë më tepër koncerte publike në krahinën tonë dhe jashtë saj.

ZANI I RINISË, 1968.

SHOQE E KE FJALËN

(Bisedë me Nexhmije Pagarushën)

**JETA KA LULE E GJEMBA: LUM AI QË I PËRVISHET
PUNËS**

“DASHURIA IME E MADHE - KËNGA”

Redaksinë tonë, në të vërtetë lexuexit tanë, i intereson rruga juaj jetësore. Pra, si filluat, kush ndikoi, për kë keni fjalë mirënjohjeje?

- Rruga ime jetësore ishte e ngjashme me atë të të tjerëve. Diku në mesin e zhgënjimit dhe ngazëllimit. Kjo është shkallë jetësore ku shpesh gjendet jeta vetë. Dikur shumë kanë dëshiruar të bëhen mësues, dashuri të cilën padyshim e mbolli profesioni i babës tim që tanë jetën, si mësues, u mor me edukimin e brezave. Po pranoj se gjithmonë shpirtin rehat nuk ma la arti: kalova mbi dërrasat e teatrit, si artiste, por, kënga gjithmonë më tërhiqte andej nga mundem me e prezantuar veten dhe këngën e popullit tim. Për këtë, borxh i kam babait tim, i cili diti dhe munda të më kultivonte dashurinë për këngën. Ai vdiq një ditë me dëshirë të madhe që të bëhem ajo që jam.

- Keni mbërri zenitin në këtë degë. Si e ndieni veten dhe ku e shihni perspektivën tuaj?

- Kurr nuk mund të mbërrihet zeniti në art. Në rrugën time artistike gjithmonë me shoqëron dëshira që të mbërrij sa më tepër.

- A u mban shpresa se po rriten talente të rinj (këngëtarë e këngëtare), të cilët do të mbërrijnë diçka në këtë lamë?

- Patjetër. Ka talente të cilët do të më tejkalojnë, mbasi kjo është gjë normale. Këtë, zaten, e mundësojnë edhe kushtet e tashme për punë.

Çdo njeri e ka nga një dashuni, hobi. Cila është për ju ajo gjë të cilën e doni shumë. Njëherë, na thoni cilën këngë e doni më shumë dhe pse?

- Dashuria ime e madhe është kënga, mbasi ajo për mua është mjet me të cilin shpreh disponimin tim. E dua, shumë e dua këngën, dhe ndoshta për këtë arsye asnjëherë nuk jam përpjekur, nuk kam synuar, që ajo, ose zëri im të jetë burim i ndonjë kapitali. Këndo se dua këngën e jo se dua dinarin. Kënga më shërben për t'u treguar njerëzve se i dua, se e dua publikun, të gjithë njerëzit e botës. Kënga "Unë ty të kam dashtë" është kënga që më pëlqen më shumë. Mendoj se me dashtë është shumë madhështore.

- Tani na thoni diçka për këngën shqipe: a është ajo shprehje e folklorit tonë apo ndonjë përzierje me ndikime prej së jashtmi?

- E dua këngën tonë shqipe. Atë e interpretoj ashtu siç e ndiej, ashtu si e ka kënga formën e fituar gjatë shekujve me anë të artistëve dhe interpretuesve. Përpiqem me kontribue në përsosjen e mëtejshme të këngës sonë në pikëpamje artistike. Kjo nuk ka lidhje me mënyrën e interpretimit të këngëve të huaja.

- Këngët popullore nga Shqipëria, tashmë po depërtojnë edhe në Kosovë. Çfarë vlerësimi keni për këngëtarët që jetojnë në Shqipëri?

- Mendoj se nuk ka nevojë të flas për shkakun e popullarimit gjithnjë e më të madh të këtyre këngëve. Mund të them se interpretuesit janë të shkëlqyeshëm, kurse për origjinalitet nuk ka nevojë të flas pasi dihet mirë se kënga atje lind pa kurrfarë "përzierjesh". Kam përshtypjen se zgjedhjes së këngëtarëve që dalin para mikrofonit i kushtohet kujdes i posaçëm gjë e cila e ngriti nivelin e interpretimit. Unë dëshiroj të këndoja disa këngë mirëpo ende nuk kam pas mundësi për t'i mësuar si duhet. Përndryshe: o mirë, o hiç!

- Keni shëtitur në shumë vende të botës. A mundeni, atëherë, të bëni një krahasim mes këngës së atyre vendeve dhe këngës sonë?

- Çdo popull me anë të këngës shpreh edhe disponimin karakteristik të kombit. Por, pasi njerëzit, nëse guxoj të them, janë

të njëjtë, edhe muzika nuk ndryshon shumë. Mundem me thënë se gjithëkund, ku kam qenë, kënga jonë shqipe është më e mirë.

- *Në fund të bisedës, lidhur me këngën, a mundeni të bëni një krahasim rreth zhvillimit të këngës sonë popullore dhe argëtuese?*

- Kur është fjala për muzikën argëtuese ma merr mendja se është herët të flasim për ndonjëfarë shprehjeje kombëtare. Muzika popullore është diçka por, ajo ka lindur në popull dhe është karakteristikë e tij, është pasqyrë e zhvillimit...

- *Zani i rinisë ka shumë lexuese femra. Ju lutem, a mos keni ndonjë këshillë për to?*

- I përhëndes të gjitha lexueset e “Zanit” të cilat gëzohen, për këtë revistë, bashk me me mua e sa për këshilla, e ka një që për të keq, është pak konvercionale, por vlen të përsëritet edhe një herë: puna e vendosur i tejkalon të gjitha vështirësitë dhe dëshpërimet në jetën e përditshme.

- *Kur keni qenë vajzushë, sigurisht keni pasur momente të ndryshme dashurie. Nëse meditonit për atë ditë, atëherë çfarë mendimesh u sillen në krye?*

- Me dashtë sinqerisht!

- *Gati harrova të pyes diçka për publikun dhe për njerëzit. Çka u pëlqen e çka jo te ta?*

- E çmoj dhe e dua pamasë publikun, pa marrë parasysh se i cilit vend është ai. Përgatitem për koncert me njëmijë të dridhura në trup, me frikën se nuk do të mundem t’i kënaq. Për fat të keq, disa herë publiku nuk i çmon sa duhet përpjekjet e këngëtarit. Në raste të tilla, as rrethi nuk i gjykon këto ekscese që ndikojnë aq keq në shpirtin e këngëtarit ose këngëtares. Te njerëzit e dua shumë sinqeritetin dhe urrej pamasë e tepër e urrej, fjalën mbas shpine. Është “devizë” e jetës sime që të shikoj vetëm punët e mia. Oh, sa mirë do t’ishte që gjithëkush ta bënte këtë punë. Një gjë tjetër po

shikoj te ne: nëse i çmon njerëzit, nëse je i afërt me ta, ata disi përpiqen me të nënçmuar me të përqeshur. Kushedi pse?

- *Në fund kisha dashtë me u tregue edhe këtë: kur iu shohin në rrugë, sigurisht, njerëzit thonë: “qe po kalon Nexhmije Pagarusha”. A u pengon kjo?*

- Gjithësesi. Shpesh gjindem në situata të pakëndshme e kjo padyshim është pasojë edhe e “rrugës me gjemba” nëpër të cilën kam kaluar dikund, duke mos hasur në mirëkuptim e diku bile edhe duke bërë përpjekje me më nënçmuar. Kështu edhe tani, kur dëgjoj fjalët qëllimmira që fliten për mua, padashtas m’i kuptojnë edhe momentet e vështira të jetës sime. Mirëpo, koha, puna dhe durimi e bëjnë të vetën. Mbesin vetëm disa kujtime të arta, në ditët e vështira, sikur e gjithë ajo të ishte vetëm një ëndërr e dikurshme.

Në fund, mbas gjithë kësaj bisede, nuk kam gjë tjetër për të shtuar, por iu falenderoj juve që më dhatë rastin të flas para lexuesve të “Zanit”.

“Zani i rinisë”, 1967

Rushid RAMABAJA

Intervistë e vogël

NEXHMIJA - ARTISTE E PAVARUR

Deri më tash në këtë rubrikën tonë të përhershme, lexuesit tanë nuk kanë patur rast të lexojnë për **Nexhmije Pagarushën**, jo pse ajo nuk meriton këtë vend, por se kjo këngëtare jona me popullaritet është ose në rrugë, ose e zënë, ose...

- *Nexhmije, disi është e vështirë me ju gjetë?*

- Jo aq shumë sa po mendoni. Po shkoj nëpër turne, koncerte të ndryshme, vizita, por qendrën e kam prapë në Prishtinë, në shtëpi, ku bëj ushtrime.

- *Tani jeni artiste e pavarur, mund t'ua shpjegoni këtë më hollësisht lexuesve tanë?*

- Kjo do të thotë se nuk jam e "lidhur" me asnjë themelatë, vendpune, "Estrada e artistëve" në Beograd na "gjen punë" - organizon koncerte, ose bën ndërmjetësime e na fton të shkojmë në një turne, koncert, etj. Materialisht kështu është më mirë, por ajo kryesorja është se kështu kam rast më shumë me i përhapur këngët tona, bile jo vetëm në Jugosllavi.

- *Të bëheni e pavarur erdhi si rezultat rasti, apo dëshirës tuaj, pasi e njihni fuqinë artistike?*

- Jo rasti. Megjithatë e kam ditur se kam forca të ekzistoj si e pavarun, nuk kam mundur me ba ballë me dalë prej Radio Prishtinës, por, kam përshtypjen se disi qenë ngopur me mua, nuk më çmonin aq sa vlej (përveç drejtorit, i cili është sjellë gjithnjë shumë mirë). Dy vjetë nuk inçizova asgjë, e, mandej më dhanë një punë teknike nën kushte të vështira. Nuk munda të duroja... Dola.

Nja tre muaj kisha drepresion, mendoja vazhdimisht: “Si ban me dalë prej radios, shtëpisë sime, së cilës i nevojitem?”, por nuk qe e mundur të vazhdoj më. Dua të them dhe se këto inçizime që dëgjohen tani në radio, janë të vjetra.

- *Ju vizituar Izraelin, Bullgarinë, ç’përshtypje na sollët?*

- Shumë të mira! Në ato vende përfaqësova këngët tona. Çfarë reklamash më bënin, veçanërisht në Izrael! Shkova për pak e vetëm, në Izrael mbeta një muaj e gjysmë. Natyrisht, atje jam paraqitur si artiste e pavarur.

- *Sigurisht atje jeni takuar me prishtinasit e dikurshëm ebrej?*

- Po, disa më njihnin mirë dhe më thirrën edhe nëpër shtëpia. Bisedonim gjerë e gjatë: vazhdimisht pyesin për atdheun e tyre të vërtetë, madje për rrugët me baltë të Prishtinës, sepse nuk mundën t’i harrojnë, kanë qejf t’i vizitojnë.

- *A kënduat në Tel Aviv “Hava Hagilla”?*

- Këtë kompozim ebre e këndova dhe më bënin lajka duke thënë se asnjë i huaj nuk e ka kënduar me aq origjinalitet, veçanërisht, akcent të drejtë.

- *Si këngëtare universale, çka këndonit më me ëndje?*

- I dua shumë këngët popullore. Melosi ynë popullor ka diçka shumë të çmueshme, artistike - këtë thonë shumë ekspertë. Klasiken e çmoj shumë.

- *Çfarë keni adhuruar dhe është realizuar, e çfarë jo?*

- Kam ëndërruar për një koncert me arie operistike, të cilin e organizova vetë me shumë mundime në prillin e vitit të kaluar dhe i cili më është shumë i dashur. Fatkeqësisht vetëm ju keni shkruar për të në “Rilindja” dhe asgjë tjetër. Thosha: “Të dalë me sukses koncerti, mandej edhe në vdeksha...”. Nuk më është

realizuar, për faj timin, ëndrra të regjistrohëm në akademi, edhe pse profesorët e njojtur madje më thirrnin vetë!

- *Çfarë këshille u jepni këngëtarëve të tij?*

- Të jenë modestë. Mbas një suksezi, të mos kujtojnë se u ngjitën në qiell. Të mundohen të mbërrijnë një nivel e të mbesin në të. Unë jam e kënaqur se që 15 vjet kur nuk isha aq lart, sa një ditë të bie poshtë. Këngëtarët duhe të fitojnë popullaritet. Radioja t'ju organizojë koncerte edhe jashtë. Ne kemi këngëtarë shumë të mirë. Nuk jam unë e vetme siç mendohet.

- *Po "Akordet" a janë shprehje e vërtetë e forcave tona?*

- Besoj se duhet të vazhdojmë, por këto të sivjemet më kanë dëshpëruar pak. Ne mundemi më shumë, jam e bindur se të gjithë krijuesit tanë nuk marrin pjesë në të. Mandej, ata që vendosin fatin e kompozimeve, të ndërrohen, kështu që të çrrënjoset familiariteti.

- *Një pyetje intime: cili kompozim, pjesë muzikore, me fuqinë e vet artistike të pëlqen më së shumti dhe bën që nga entuziazmi (e jo prekja sentimentale) të dalin lotët?*

- Po, - dhe iu ndërrua menjëherë ngjyra e fytyrës - uvertyra e "Traviatës" dhe "Vjeshta" e Rexhep Mullait - burrit tim.

"Rilindja", 1970

Maksut SHEHU

Bisedë e së shtunës.

BILBILI I KOSOVËS, KËTË HERË, FLET!...

Nexhmije Pagarusha: “Kënga ime është një porosi: kur dëgjoni tingul, jeta është më e bardhë!...”

Sa shumë kam biseduar me atë... Emrin e ka të thjeshtë, fare...

Të dashur shumë - Nexhmije Pagarusha...

A duhet edhe diç?...

Zbërthejmë këtë emër: “bilbili i Kosovës!”...

E kompletojmë këtë emër. “Emër për skenat botërore”...

E përsërisim këtë emër: Gjithmonë këndojmë, këngë bëhet jeta”...

E lavdërojmë këtë emër: S’kemi fjalë për ta lavdëruar për t’ia dhënë hakun”...

Krenohemi me këtë emër: “Vetëm një Nexhmije kemi, një plus, një plus shumë, vetëm një e kemi”...

E harrojmë këtë emër: “Me këngë të re ajo na përkujton se është yll që nuk fiket dot”...

E hedhim në botë këtë emër: “Të gjithë e pranojnë, e nderojnë, e duan, dëshirojnë të kenë një Nexhmije, së paku çdo ditë në skenat e tyre, para ekraneve me e pa ngjyra, në disk, me më pak e shumë të sjella”...

Bisedojmë me Nexhmijen, unë disa herë kam biseduar dhe gjithmonë fillimin e muhabetit e kemi hedhur në fund, që të mos ketë fund ajo bisedë, që të jetë një ditë e kompletuar, një jetëshkrim me jetë dhuruar artit, këngës dhe këngën duke e përcjellë në botë, këngën e bukur shqipe...

Në çdo bisedë me Nexhmijen shtrihej mes nesh modestia, në momentin më vendimtar, lutje: njëherë tjetër, nuk kam fjalë, s’kam fjalë t’i thur vetes kurorë...

Edhe poetët thurën, me fjalë më të bukura, me fjalë e vargje, jetë që kanë, thurën kurora lavdie, emrit - Nexhmije Pagarusha.

Para shumë e shumë vjetëve, në një shoqëri të lartë, në Marsej, sillej disku i Nexhmijes mbi gramafon, derdhej zëri mjalt e pushkë prej gushës së Nexhmijes, e dëgjonin francezët me alamet kulture dhe secili sish bëri nga një “Bis”. E lëshoi diskun edhe njëherë, edhe njëherë, edhe shumë herë dhe si me komandë, me një zë, u munduan ta lavdërojnë:

“Zëri i saj do të robërojë botën, miq!...”

Heshta...

Njëri, më pyeti:

- Nuk pajtohesh, mik?...

U pajtova dhe, ç’është e vërteta, u nguta dhe thashë:

- Nexhmijen e njoh!...

Më shikuan dhe vetëm që nuk më thanë: - “gënjeshtër e kurdisur, në këtë moment...”

Mirë!...

Ja, po vërtetoj se kam patur të drejtë, ta pyesim Nexhmijen:

- *Trego të lutem, prej kur më njeh?...*

- Kur isha kaq, një pëllëmbë e katër gishta!...

- *U rrite shpejt, Nexhmije?...*

- Si çdo filloriste e Prishtinës, një kokërr grur çdo mëngjes, e kur binte shiu ndofta edhe nga dy kokrra gruri në ditë!...

- *E si u bërë kaq e madhe?...*

- Me trup jam, më duket, mesatare!...

- *Po përsëris pyetjen: kur u bërë kaq e madhe, këngëtare, fenomenale, e vetme, bilbil i Kosovës?...*

- Dëgjoja këngën e bilbilit, dëshiroja të bëhem bilbil. Përcillja këngën e kumërisë, ëndërroja kumëri të bëhem. Dëgjoja gurgullimën e përroit, zemrën dëshiroja ta gdhend për atë shushurimë, që vetëm natyra di të na dhurojë!...

- *Në fillim paske nisur me imitime, apo jo?...*

- Kur dëgjova zërin tim, nxënëse e gjimnazit, u befasova, u frikësova, këndova edhe njëherë, edhe dhjetë herë. Frika më pështillte, mos është vallë një burim i rastit, do të shteret shpejt, dhe nisa të këndoj, para shoqeve e shokëve, në shkollë e jashtë saj. Njerëzit pas këngës sime duartrokisnin dhe kërkonin të këndoj edhe më!...

- *Zemra të ishte e mbushur me këngë, vullkan, Nexhmije, shpërthente zjarri, nuk fikej, apo jo?...*

- Po! Ndofta edhe jam munduar nganjëherë ta fikë atë zjarr vetë, në momente të vështira!...

- *Po, kuptova, ke dashur të ikësh prej këngës?...*

- Thonë se kur e mëson bilbili këngën e tij, të vetmen këngë, nuk i ndahet gjer në vdekje, e njeriu di aq shumë këngë, të dashura, secila si kënga e bilbilit, si mund të ndahet prej këngës, si, unë nuk di, beso!...

- *Mos ta kthejmë kokën pas, sukseset e gjertanishme t'i harrojmë, trego të lutem, në cilin olimp të këngës ia ke mësy tani?...*

- Jam, tani profesionaliste, këngëtare. Dua të këndoj si të kem dhjetë, njëmijë bilbila në fyt. Kënga ime është e imja gjersa gjendet në mua, në zemrën time, kur nisat në udhëtim, publikut, ajo është e secilit njeri, unë humbas e ata fitojnë, prej shumë këngëve, së paku një që u fle në zemër!...

- *Diç më konkretishti Nexhmije?...*

- Çdo gjë është konkrete në jetën time. Këndoj, se këngën e dua. Kënga nuk ka qenë asnjëherë për mua ai çelësi magjik, i artë, i gjithëfuqishëm, që do të ma hapte derën e një suzam të madh, prej nga mund të marrë para, pa numëruar fare, të bëhem pasanike. Unë e dua këngën dhe nuk e shes dot për para!...

- *Çudi! Unë kam menduar se këngë shitet me dinarë e me valuta?...*

- E shesin! Unë jam e kënaqur me një jetë modeste. Me një banesë të vogël. Dikur me katër rrotët e "Fiqës" e tani me këmbët e mia dhe me autobusin e qytetit. Jam e kënaqur kur më falin një lule të vogël dhe një buzëqeshje të madhe. Jam e kënaqur kur dy e tri herë sillet rresht disku me këngën time. Dëshiroj të dëgjoj

atë fjalë magjike: “Bis, bis, bis” dhe këndoj edhe aq sa nuk mundem!...

- *Nuk të lodh kënga, Nexhmije?...*

- Kënga dhe më lodh e edhe është pushim për mua. Kur është e bukur kënga, kur pështillet për zemrën time, kur ma ndez fytin, dua një minutë e më parë ta hedh prej kraharorit, si një flakë që s’fiket dot, si zjarr e llavë vullkani!...

- *T’i ndez zemrat e njerëzve?...*

- Jo, melhem është kënga. Ajo e copton merimangën më të koklavitur në zemrën e njeriut. Kënga është hyrje për ditë të bukur, për çaste të lumtura. Ajo shporr errësirën nga bebëzat e njeriut dhe sheh bardhë, dritë, ditë, sa e mban këngën në zemrën e tij!...

- *Sa jeton në ty një këngë?...*

- Për secilën këngë kam nga një çerdhe në zemrën time, e secila, që e këndoj unë, është e dashur për mua, e paharruar, e këndoj ose e pëshpëris pa nda, shumë e shumë herë të njëjtën këngë!...

- *Mirëpo flet bota për ty! Sa t’u besojmë fjalëve, Nexhmije?...*

- Ata që flasin mirë për mua i falenderoj. Kudo që kam qenë në botë, më kanë ftuar, përsëri. Nuk di, shpesh kam pritur të udhëtoj dhe ca aranzhmane ngelën të parealizuar!

- *Mos je më e “vyeshme” tani?...*

- Kudo që më thërrasin, është publiku im, do të shkoj, do t’u këndoj dhe kur të më thonë përsëri, do kthehem të këndoj në atë vend, qoftë afër apo larg!...

- *Të them: “Rruga e mbarë” në suksese!” Jo, jo, po të pyes edhe diç: sa është jeta e një kënge?...*

- Një, dy, dhjetë intepretime, një muaj, një pranverë, një vit, pesë vjet ose një fshikëllimë, një uaaa!...

- *Po ca këngë të tua jetojnë sa edhe motet e tua të këngëtares?...*

- Kënga e bukur jeton sa një brez. Mbetet si një trashëgim i bukur dhe brezave të ardhshëm, sigurisht!...

- *Po këngëtarja e mirë, Nexhmije?...*

- Nuk di, vërtet!...

- Të faleminderit, shoqe Nexhmije, si të thonë, Bilbili i Kosovës që sot u ndave nga kënga dhe na fol pak...

Rilindja, 14. 6. 1970

Mexhide MURSELI:**E LUMTUR JAM!**

- *Çfarë mendoni për profesionin e këngëtarit?*

- Gjeneracioni im është viktimë e profesionit. Kam hasur në mosmarrëveshje edhe te vetë publiku. Nga ana tjetër, kam dhe adhurues, sigurisht. Moti do ta lëshoja frontin sikur të mos ishin ata të cilët më mbajnë, më japin zemër të këndoj dhe më bëjnë ta dua profesionin mbi të gjitha.

- *A keni ndonjë model, të cilin do ta imitonit?*

- Në fillim të punës, atëherë kur isha vetëm 19 vjeçe, adhuroja Tefta Tashkon. Ajo ka qenë ëndrra ime. Por, me kohë, kam formuar stilin tim, tani vetëm i adhuroj me radhë.

- *Si duhet të jetë një këngëtar?*

- Të ketë talent dhe të punojë shumë. Këto dy komponente nuk qëndrojnë dot të vetmuara.

- *Çfarë është më e rëndësishme, Nexhmije?*

- Shëndeti, pastaj qetësia.

- *Po, më e dashur?*

- Shpërblimi i Dhjetorit i ndarë para disa vjetësh. Të dashura më janë edhe shpërblimet e ndryshme ato nga akordet muzikore e të tjera.

- *Çfarë do të këndonit në akordet e sivojete?*

- Një kompozim të Severin Kajtazit, emrin e të cilit akoma nuk e di dhe një këngë popullore të Fahri Beqirit.

Kur përmendët këngët zbavitëse dhe popullore, cilat adhuronit më tepër?

- Gjithësesi këngët popullore, linda me to. Në to kam shpirtin. Ato më janë dashuri e parë, nëse mund të them kështu.

- *A i zgjidhni këngët që i interpretoni?*

- Jo! Ka kompozitorë më të mirë dhe më të dobët, por në çdo këngë gjej diçka të bukur, që më pëlqen. Këndoj zakonisht këngën e parë që më ofrohet.

- *Çfarë doni?*

- Fëmijët dhe lulet. Por, mjeshtrit, s'mund t'i kultivojë e ato duan kujdes, përndryshe veniten e unë udhëtoj shpesh, së këndejmi kjo më është e pamundur.

- *Ngjyrat tuaja?*

- E zeza dhe e bardha. Këto janë mbretëresha të ngjyrave.

- *Moda, ç'është me të?*

- Për modën mendoj vetëm kur paraqitem në skenë, kur jam para mikrofonit, përndryshe ditëve të tjera s'kam kohë të mendoj për të. Blej pallto të gjatë vetëm pse nuk gjej tjetër e kështu me radhë.

- *A është vështirë të jesh e popullarizuar?*

- Natyrisht, e veçanërisht kur dëshiron në rrugë të jesh anonim e të jetosh në skenë.

Kosovarja, Nëntor, 1971

Maxhide HASANI:

ZËRI QË NUK HARROHET

Atëbotë, kur profesioni prej këngëtareje nuk ishte shumë i çmuar për mesin tonë, aty në vitet e para të pasluftës, kur Radio-Prishtina kishte dy dhoma; një stuao e mikrofon, një vajzë nga Pagarusha, bijë e mësuesit të para të asaj ane, zuri të këndonte ndryshe nga këngëtarët tona të tjera.

Në zërin e saj poetët dalluan dhimbjen dhe krenarinë e njeriut tonë, natyrën e bukur dhe të vrazhdë të Kosovës. Ndoshta për këtë e quajtën edhe bilbili i Kosovës. Po kush mund ta interpretonte, ashtu me shpirt, dhimbjen e madhe të nënës shqiptare për birin e humbur, siç e bënte ajo me këngën popullore “Çou, more Rexho”.

- Ishin ato kohë të tjera, kohë entuziazmi. Të udhëhequr nga kjo ndjenjë, punohej edhe në lëmenjtë e tjerë të jetës, - thotë sot Nexhmije Pagarusha.

Puna e këtillë plot dashuri e vetëmohim Nexhmijes i solli vërtet të gjitha ato që mund t'i dëshirojë një këngëtare, me përjashtim të të mirave materiale.

Në dhomën e saj të errësuar nga arkitektura është një piano, disa piktura miqsh e adhuruesish të këngës së saj, artikuj të shumë gazetaresk të klasifikuar në albume speciale me dashuri të madhe. Por asgjë, apo shumë pak gjetëm prej asaj hareje, të këngës e të ambientit që e ndjeu aq shumë dhe e interpretoi aq fuqishëm kjo këngëtare.

- Natyrisht e dua shumë, - na thotë dhe shton se, sikur të kishte mundësi të zgjidhte, do të jetonte në fshat. - Më pengon tollovia, papastërtia që mbretëron në qytet. Në fshat jeta është më e qetë, më e pastër.

Kam mundur të bëj më shumë

- Jam e kënaqur me publikun që pata, por jo edhe me punën që e bëra. Kam një disk të madh të inçizuar para pesëmbëdhjetë vjetësh, disa kaseta që i prodhuan shtëpitë diskografike prej atij disku të vetëm. Një kujdes më i madh punës sime i është kushtuar aty nga fundi i karrierës. Në shiritin filmik ka ngelur vetëm një emision prej 15 minutash dhe disa interpretime nga manifestimet publike. Këto i kërkoi këto ditë një ekip i Televizionit të Shqipërisë, që bëri një bisedë me mua. Nuk ka kurrëgjë, i thanë në Televizionin e Prishtinës. Nuk di a nuk deshën t'i japin, apo i fshehën edhe ato të paktat që ishin. Di vetëm se kolegët e mi nuk u treguan të kujdesshëm të bënin ndonjë incizim e xhirim më shumë, e t'i hedhin në arkiv. Ndoshta ndonjëherë do të hynin në punë. Në rrugë vazhdimisht, ashtu kalimthi, më kanë thënë se duhet ta bëjnë një portret gjysmorësh prej këngëtareje dhe e tëra mbetej me kaq. Pse nuk u realizua, nuk e di.

- A ju mungon kënga, publiku, meqë i latë qysh para gjashtë-shtatë vjetësh dhe ku janë arsyet që u tërhoqët ashtu?

- Çudi, por nuk e ndiej këtë mungesë, edhe pse nuk është normale. Ndoshta më ka kapluar kjo e keqe e madhe e jona, e ngapak edhe hallet personale, kështu që nuk ndiej ndonjë zbrazëti. Më preokupojnë mjaft edhe punët e përditshme të shtëpisë, ato më marrin mjaft kohë, si çdo gruaje tjetër. Nuk dal edhe shumë prej shtëpisë. Kam shprehi të rri brenda e, siç duket kjo më ka mbetur nga koha kur isha shumë e angazhuar me turne, me koncerte, e, kur vija në shtëpi, pushoja mirë! U tërhoqa se mendoja se nuk mund të këndoja si dikur... Kam edhe miq, të profesionit e thjeshtë të miqësisë, takohem me ta, llafosem për situatën e përgjithshme e, edhe për problemet e secilit prej nesh. Vitin e fundit, posaçërisht po më preokupon kjo që ndodhi me fatin tonë e, edhe të këngës e të artit në përgjithësi.

Vendimin për ta lënë punën e mora vetëm disa ditë para se të pensionohesha. Mbylljen e Radiotelevizionit tonë e përjetova

rëndë. Kurrë nuk e kam marrë me mend se mund të ndodhte diçka e tillë. Një ditë shkova në Radio, desha të hyj me dhunë, pasoi protokol i tërë aty ku kish lënë rininë e shëndetin. Nuk mund të besoja se askush prej nesh nuk ishte më aty. Shkova pastaj në televizion për të marrë stazhin e realizuar për pension. Ka punë shumë, më thanë dhe më lanë të pres një kohë të gjatë në rrugë. Më vinte vështirë të qëndroja në rrugë. Portieri as emrin nuk dinte të më shqiptonte. Nehmije më quajti dhe me paturpësi më la të prisja gjatë.

Koncertet që mbaj mend

Prej koncerteve dhe turneve të shumta që pati gjatë punës detyrëqësore Nexhmija dallon pritjen madhështore që iu bë në Shqipëri. Për herë të parë në këtë vend shkova më 1971, privatisht, me kolegun tim Zef Tupecin. Ai shkonte për të takuar të atin e unë të shihja Shqipërinë, vendin për të cilin më kishin treguar aq shumë, vendin që e ëndërroja dhe ku kishte aq shumë këngëtarë të mirë, sa vetja më dukej si këngëtare...

Sapo mësuam se jemi atje, na gjetën shoqëruar. Më lutën të këndoja në një koncert të ansambllit të këngëve dhe të valleve popullore. Publiku më pati entuziazmuar, kështu që atë përjetim nuk mund ta harroj kurrë.

U xhirua koncerti dhe intretimi im. Pastaj u bënë xhirime në rrugë, gjatë shetitjeve, vizitave. Ishte një pritje çfarë nuk e prisja dhe në vend të katër-pesë ditëve, sa planifikova të qëndroja, ndenja pesëmbëdhjetë ditë. Jam mirëpritur sa herë kam shkuar në Shqipëri. Atje kam xhirime të shumta dhe, siç u informova, edhe këto ditë nga drejtori i Televizionit të Tiranës, të gjitha materialet ruhen dhe po qe se i duhen dikujt ndonjëherë, aty janë. Më shtatë shtator TV Shqiptar emetoi edhe bisedën e zhvilluar para disa ditësh në Prishtinë.

Koncerti tjetër, ku mora sukses të madh, ishte edhe një manifestim muzikor para njëzet vjetësh në Berlin. Më kujtohet si

sot ajo pjesëmarrje ku këndova, “Bareshën” dhe këngën, “Sytë për ty i kam plot lot”. Publiku u entuziazhua nga kënga shqipe dhe e priti me ovacione të mëdha.

Të nesërmen shtypi i këtij vendi mua dhe pjesëmarrjes sonë i dha një publicitet dhe vlerësim të lartë, ndryshe nga shtypi ynë që nuk e pa të udhës as të shënonte.

- *Cila është kënga juaj më e bukur dhe cilën doni më shumë?*

- Çdo këngë artisti e do si fëmijë. A mund të mos e duash fëmijën? Ashtu është edhe me këngën. Secilës prej tyre jam mundur t’i jap zjarr e shpirt... “Baresha” është një këngë artistike që intepretohet vështirë dhe nuk kam mundur ta këndoj gjithmonë. Ka aty një opus tonesh të larta, të cilat nuk kam mundur gjithmonë t’i nxjerr. Këtë këngë e ka kompozuar Rexho Mulliqi. Në televizion gjithmonë kjo këngë ka shkuar me plejbejk.

Me emocione të mëdha kam interpretuar edhe këngën, “Çou, more Rexho”. Kam pasur shumë sukses me këtë këngë, e këndoja ashtu si e ndieja, si këngë vajtimi. Këtë e kisha vazhdimisht në repertuar kur udhëtoja me Ansamblin “Shota”. Rolin e nënës së Rexhos e kam interpretuar edhe në dramën e Ymer Shkrelit, “Rexha i Lokes në grazhd të kalit”. Kam patur dëshirë që kjo dramë e bukur të xhirohet edhe filmikisht, por ja edhe kjo nuk u realizuar. Hajt sot, hajt nesër, mbeti pa hyrë edhe në shiritin filmik. Ka qenë vërtet një dramë e madhe.

Nexhmija u dëshmuar edhe si aktore e mirë. Luajti edhe në disa filma, si “Fluturimi i micakut”, “Lepurushi me pesë këmbë”, “Tre vetë kapërcejnë malin”, “Dasma e përgjakur” dhe “E kafshoja terrin”, ku dhe fitoi një shpërblim për interpretim të suksesshëm të rolit...

Tash kur e keni lënë këngën, nuk keni as role, çka ju preokupon më së shumti?

- Si edhe të gjithë shqiptarët, edhe mua më brengos e keqja e madhe që na ka kapluar, si do të zgjidhet e tërë kjo. Po mërzitem shumë, por edhe po më mban shpresa se do t’ia dalim në krye

kësaj çështjeje. Kemi njerëz të urtë, të mençur, siç është Ibrahim Rugova, Qosja etj., të mos i numërojmë, të cilët ditën, ma thotë mendja, ta orientojnë popullin si duhet, ta kultivojnë durimin, mençurinë. Gjendja jonë është me të vërtetë e rëndë, pengohet fjala shqipe, kënga shqipe, shtypi në gjuhën amnore. Të gjitha këto flasin se ne nuk jemi të lirë. Liria, demokracia, nënkuptojnë fjalën e lirë në gjuhën amtare e jo të dënohet njeriu me burg pse dëgjon në shqip këngë popullore.

Ajo që po më pengon është mostoleranca jonë. Ne në këtë situatë të rëndë nuk kemi njerëz për të humbur për çkado. Kjo praktikë nuk na shpie askund. Ka kohë kur duhet të mendojmë për njerëzit që i kanë bërë dëm popullit. Duhe t'i masim kritikën mirë. Njerëzit janë të ndjeshëm. Ata që kanë bërë keq, vetë do të ballafaqohen me gabimin e vet. Duhet të kemi kujdes nga thashethemet e të mos ua ndalim hovin njerëzve që dinë dhe duan të punojnë.

Nuk e kam të qartë pse njerëzit nuk mund të merren vesh me fjalë të mira, pse kanë nevojë të grinden. Ai që flet keq për tjetrin, më duket se është po aq i keq sa edhe ai që bën ndonjë vepër të keqe. Mund të kritikohemi sy më sy, e jo ta shfrytëzojmë gazetën për këtë qëllim. Në këtë tollovi e rrëmujë të përgjithshme duhet t'i ruajmë njerëzit tanë. Secili po mundohet të ndihmojë në mënyrën e vet dhe me aftësitë që ka. Nuk është koha as për të kërkuar që dikush të na ngrihet në këmbë se kemi bërë diçka të vlefshme.

Nuk është mirë as që po na largohen kaq shumë të rinj nga Kosova. Mendoj se vendi duhet të lëshohet vetëm për ndonjë zor të madh. Çdo i ri që del jashtë, duhet ta dijë se duhet të kthehet sa më parë dhe të ketë kujdes si sillet atje, duhet ta ketë vazhdimisht parasysh se cilit komb i takon dhe të lërë mbresa të mira te të tjerët. Thellë po e ndiej edhe dhimbjen e nënave që i kanë humbur bijtë apo i kanë ushtarë. Unë në lëkurë të tyre nuk isha. Mirëpo, kam fëmijë dhe di me sa druajtje e pres çdo vonesë të birit tim, qoftë edhe në qytet.

- *Sa janë të pranishme këto motive në këngët që po lindin këto ditë? - e pyesim Nexhmijen.*

- Çdo ngjarje, pothuaj çdo ndodhi, po zë vend në këngët tona. Herë-herë ka edhe teprime, ma thotë mendja. Nuk po dëgjojmë gjë tjetër përveç gjërash tronditëse. Kjo veçanërisht po i trondit fëmijët. Po e shoh time mbesë sa rëndë po i përjeton këto motive se kënga e ka rolin edhe të na bëjë ndonjëherë të harrojmë katandisjen, në të cilin kemi rënë. Motivet e këngët si ngjarje të këtilla duan edhe një trajtim më me pietet. Kur nuk kam mundur të kuptoj si vallëzohet kur këndohet kënga për Ganimete Tërbeshin apo këngë të ngjashme. Më duket se kur interpretohen këngët e tilla, duhet të qëndrojmë gatitu.

Nuk di pastaj sa jemi solidarë. Kam frikë mos ndokush po materializohet nga mjerimi i dikujt. Nuk di sa vizitohen familjet, të afërmit e atyre që kanë pësuar dhe a ju ndihmohet atyre nga këngët dhe nga shoqëritë në fjalë.

Solidarësia në këto ditë të vështira edhe materiale është shumë e rëndësishme. Kemi sot mbi 70 mijë të nxjerrë nga puna, gjashtë mijë arsimtarë që iu morën ditarët. Kurrë nuk mund ta harroj ndihmën e tri kolegeve të mia pensioniste, që ma ofruan në pesë-gjashtë muajt kur mbeta pa kurrfarë të ardhurash dhe kur im bir e nusja mbetën pa punë.

Mbyllja e shkollave është e rëndë për fëmijët, të cilët nuk patën as pushim të rehatshëm, e mezi pritën zilen të takoheshin me shokë e me arsimtarë. Atë ditë shumë fëmijë kam parë me lot në faqe. Mezi i kam pajtuar edhe mbesat e mija. E marr me mend si i kanë përjetuar edhe mësuesit e arsimtarët, të cilët janë të gatshëm të punojnë dhe nëpër shtëpi, vetëm e vetëm të mos i lënë nxënësit në rrugë. Janë treguar të denjë edhe vjet kur tërë kohën punuan pa të ardhura personale...

Kështu foli Nexhmija dhe në zërin e saj edhe tashti, si në këngën e saj të dikurshme, hetohej dhimbja dhe krenaria.

Dukagjin GORANI:

BLUES PËR “BARESHËN”

Një banesë dydhomëshe mbi “Kurrizin” e Prishtinës sot është bota e tërë e një zonje, e cila zërin dhe buzëqeshjet ia fali trevës së vet, ndërsa fatkeqësitë e jetës - shpirtit të vetmuar të pleqërisë. Sa e kotë është të mundohesh që në katër faqe të “KOHËS” t’i përmbledhësh katër decenie të përkushtimit të pafund ndaj artit dhe muziks, të tregimit të jetës së “Bilbilit të Kosovës” - të Nexhmije Pagarushës, legjendës së këngës shqipe dhe sakrificës njerëzore, të fëmijës së parë të mësuesit dhe patriot të madhe shqiptar, Vesel Pagarushës nga fshati Pagarushë.

Nuk besoj se që të dy, gazetarët e kësaj reviste, së bashku të kenë pasur më shumë vjet moshe sesa zonja e zërit të parë, e cila bisedën me mysafirët do ta fillojë me turpërim vajzëror duke kërkuar ndjesë për shëndetin e lig, për të qenit e pamësuar me shtyp, me pikëllimin për të sotmen dhe me mbresat e veta mbi tubimin e ca ditëve më herët, të mbajtur për hir të personalitetit dhe veprës së artistit dhe intelektualit tonë - Jusuf Gërvallës.

“Vërtet s’di ç’të them. Kënga është ajo që e dija më së miri. Nuk e di se si do t’ia filloja evokimit të jetës për një kohë kaq të shkurtër. Nuk kam asgjë që do të mund të fliste për mua. E gjithë puna dhe kujtimet e mia janë gati tërësisht të humbura: inçizimet e radios, televizionit, teatrit... Janë kohë të rënda dhe të pashpirta këto që kalojmë. Por, sidoqoftë...”

Por, sidoqoftë, do të jetë 1947-shi i pasluftës, periudha prej së cilës do të fillojë rrëfimi i saj - vit që solli të atin mësues dhe familjen e Nexhmijes 15-vjeçare në Prishtinë, pas rrugëtimit të

mundimshëm fshatrave dhe qyteteve të Kosovës së “çliruar” të atëhershme.

“Po, babain e kam pasur mësues. Ishte njeri i jashtëzakonshëm dhe atdhetar i madh. Si e vogël, më kujtohet se kemi ndërruar mjaft vendbanime për shkak të punës së tij dhe problemeve me pushtetin. Edhe sot, në bibliotekën e fshatit Pagarushë mund të gjeni dorëshkrimet e tij, të alfabetit dhe abetares së përshkruar nga ai...

Para se të vendosemi në Prishtinë një kohë jetuam në Rahovec dhe Prizren. Isha tepër e re kur erdhëm në Prishtinën e pasluftës. Çka të them për ato ditë? Kënga? Më vijnë ndër mend shoqet e mia që s’i harroj, ato të ditëve të para të rinisë në Prishtinë, çfarë ishte Zyhra Mula. Sa herë që më kujtohen fillimet e të kënduarit, ajo më del përpara. Ishte këngëtare e përkryer dhe ishte e para ndër ne që këndonte. Ka vdekur, ndjesë pastë. Ishim shoqe për tërë jetën. Jemi vizituar rregullisht, të gjitha këto vite, përveç kur s’isha më në gjendje as të dal. Më kujtohet, më telefonuan për vdekjen dhe varrimin e saj... Edhe asaj i kanë humbur incizimet. S’e kam asnjë këngë me zërin e saj. Aq bukur këndonte, Zyhraja. Kishte një stil aq të afërt për publikun, për popullin tonë.

...Mandej, Melihate Hasani, këngëtare e madhe e atëhershme. Sot është profesoreshë e gjuhës angleze, më duket se është në pension. Sa bukur këndonte. Më kujtohet, ecnim rrugës, pas shkollës: ajo këndonte, unë e përcjellja. Bile, Melihatja ishte ajo që më shtyri ta bëj incizimin e parë, për radion e atëhershme të Prishtinës: “Duhet të këndosh në radio”, më tha, “e ke zërin për atë punë”. Unë s’doja, ajo insistonte dhe, në fund, shkova. Më kujtohet ndërtesa e vogël e Radio Prishtinës, që pati filluar punën. Mbaj mend ditën e audicionit, dy kthinat e vogla të ndërtesës në lagjen e “Bllloqeve” (që sot i thonë “Kuarti Kinez”), dhe Gjeto Lekën e ndjerë, gazetar e që ishte në audicion. Këndova, për herë të parë. Një këngë të bukur që titullohej “Dashnor t’u bana”, të cilën e mora dhe e mësova nga një disk i vjetër dhe i gërvishtur

gramafoni. E këndonte Tefta Tashko e pavdekshme e Shqipërisë. Zot, sa shumë e kam adhuruar Tefta Tashkon! Kisha dëshirë të madhe të këndoja si ajo. Bile, sa isha në Shqipëri, ma dhuruan edhe librin për të. Ka vdekur shumë e re. Më kujtohet më vonë, kur, si nxënëse, banoja në Beograd në një banesë private, djali i pronarit, duke e parë se jam shqiptare, më dëftoi “për një këngëtare nga Shqipëria që quhej Tefta Tashko” e që pati mbajtur një koncert në Beogradin e paraluftës. Më rrëfente për zërin e saj magjepsës, fustanin e bardhë dhe qëndrimin modest. Ishte e pavdekshme...”

* * *

Në tentim të përkujtimit të vitit të prezantimit të parë, zonja Nexhmije kërkon falje për atë se gjithmonë ka pasur vështirësi në mbajtje mend të datave dhe emrave, përveç të aytre më të dashurve. “Ndoshta sepse gjithnjë që dikush pranë meje që kujdesej për këto, ku ta di. Unë e kisha këngën para syve. Sidoqoftë, do të duhej të ishte 1948-shi”, shpjegon. Në Teatër të Qytetit të Prishtinës.

“Atëherë edhe u hap teatri. Aty u punësova aktore. Mbaj mend, ishim tri vajza, shoqe dhe aktore të reja: Meribane Shala, Katarina Josipi dhe unë. Si aktore punova dy vjet. Edhe pse për hir të dëshirës së madhe për muzikën mu desh ta lë atë, teatrin e desha shumë. Jam e lumtur që gjatë karrierës, kohëpaskohe, pata rast ose të ekzekutoj, ose të luaj në ndonjë pjesë teatrore apo filmike... Epo, atëbotë kisha dëshirë të madhe të shkoj në shkollë të muzikës. Më thoshin se kisha talent. Kështu, si 18-vjeçare regjistrohëm në shkollën e mesme të muzikës në Beograd, të cilën e vazhdova vetëm deri në vitin e tretë të saj. Më kujtohet, shkova vetëm në një qytet në të cilin s’kisha qenë kurrë përpara. Tani, s’do të kisha pasë kurrë aso guximi. Mirëpo, rinia... S’e kisha as s’e njihja kë atje. Mbaj mend se për provim pranues këndova “Dashnor t’u bana” të Teftës, pa fije të frikës apo hamendjes. Mirëpo, pas provimit, mbeta filliklat vetëm në korridor të shkollës. S’dija se jam pranuar apo jo. Kisha

të holla vetëm për t'u kthyer në Prishtinë. Më kujtohet kur nga zyra doli drejtori i shkollës, Pleshtiq e quanin, i cili u ndal para meje. Ishte shumë i vjetër, ndoshta shtatëdhjetë e disa vjeçar. Më kujtohet kur, pasi më pa se isha e humbur krejt, më pyeti: “ç’po pret këtu, vogëlushe?” S’ke qenë ndonjëherë në Beograd? Kur i thashë se ishte hera e parë, se kisha ardhur me mund të madh, se kisha ardhur për t’u regjistruar në shkollë dhe se s’kisha ku të rrija e të flija, më mori me vete, në shtëpi të vet ku banonte me të shoqen dhe dy bijat e tij, me moshë më të madhe se unë. Para tyre më prezantoi si “një vajzë e talentuar shqiptare nga Kosova, nxënëse e shkollës së mesme të muzikës në Beograd”. E shoqja e tij, zonjë tejet e kujdesshme, e kishte të afërt drejtoreshën e internatit të vajzave në Beograd tek e cila shkuam të nesërmen, së bashku. Ajo i tregoi për mua, për “vajzën nga Kosova” dhe e luti të më siguronte dhomë në internat. Punë kjo që u bë dhe që më ndihmoi pamasë, sepse internati ishte afër shkollës.

* * *

Kthimi në Prishtinë, për znj. Pagarusha do të pasojë punësimin e saj në Radio Prishtinë dhe fillimin e një karriere, e cila, përkrah suksesit, kontraversat dhe furtunat e jetës, vështirë që do të mund të krahasohet me ndonjë të tillë të artistëve të muzikës sonë të pasluftës. I kujtohet viti 1955, martesë me Rexho Mulliqin, kompozitorin dhe artistin e shquar kosovar, krijimi i familjes dhe vështirësitë e mbajtjes së hapit me estradën... Por, edhe vdekja e të atit, Veselit, të cilin aq shumë e deshi dhe mungesën e të cilit zonja Nexhmije s’do ta përballojë për dekadat që do të vijjnë.

“Nuk jam këngëtarja e parë në Kosovë, thashë. Ndoshta e para që tentoi të shkollohet, sepse kisha dashuri të madhe ndaj muzikës klasike dhe arievë operistike. Para meje ishin pra, Zyhraja, Melihatja, Meserete Çavolli dhe shumë vajza të tjera që s’guxojnë të harrohen. Edhe sot më kujtohen këngët që këndonin... Mirë, u

punësova në Radio Prishtinë, fillova të incizoj dhe të këndoj. Atëbotë, aty punonin të ndjerët Rexho Mulliqi, Lorenc Antoni, njerëz të dëshirës së madhe për melosin dhe këngën popullore, për stilizmin dhe pasurimin e saj me rikëndime dhe aranzhime të bukura. Kishim orkestër simfonike të një numri të madh të virtuozëve brilantë.

Gjithsesi ndër më të mirët në Jugosllavinë e asaj kohe. Rexhoja punonte me ta, i përgatiste dhe i ushtronte për ekzekutime e incizime. Për vitet që do të vijjnë, brenda mureve të ndërtesës modeste të radios së asaj kohe do të incizohen dhe përpunohen disa nga margaritarët më të mëdhenj të muzikës popullore shqipe.

S’di, por më duket se kompozimet dhe përpunimet e atëhershme të këngëve shqipe ishin të një niveli vërtet shumë të lartë, ndoshta të paarritshëm edhe sot. E di se publiku i mirëpriste, vërtet. Atëbotë, kurrë s’është insistuar në prekjen apo ndërrimin e konceptit, të themelit të këngës që këndonim. Ajo gjithmonë mbeti siç ishte: popullore dhe burimore. Merreni shembull përpunimin e Rexhos në këngën, “Një lule”, atë staccato e fillimit, përcjelljen korale... Aq harmoni i jepte, aq madhështore ishte. E, Lorenci... Ai ishte punëtor i madh. Gjatë punës, pat mbledhur dhe përpiluar libra të tërë të partiturave të melodive dhe të teksteve të këngës folklorike, të cilat fatkeqësisht, sot rinia jonë nuk i përdor fare. Nuk besoj e as që di nëse ato ekzistojnë. Aty njeriu mund të gjejë aso tekstesh të bukura, për të rinj, ritme të cilat mund të moderohen dhe zbukurohen. Kuptohet, duke mos prekur në themel të tyre, në vlerën e pavdekshme. Muzika shqipe është aq e bukur, nuk e di pse sot shkohet në imitime të melodive turke apo greke.

Nuk di pse sot, në muzikën tonë bëhet kjo që bëhet. Po që se vërtet ka ardhur koha e përpunimeve “për hirë të modës” atëherë le të jenë këto përpunime të këngës shqipe, e jo të asaj aziatike e indase, të cilën më vonë e prezantojnë si burimoren tonë. S’e besoj se kjo do të na shpjerë diku... Shumë jam pesimiste për këtë, për besë. Tradita nuk guxon të shuhet për hir të parasë apo

popullaritetit që zgjat një muaj. Ekziston aq potencial i madh i këngëtarëve te ne! Është mëkat të lihet pas dore gjithë kjo pasuri...

Pra, ndoshta neve na duhet që gjithmonë të jetë dikush që do të na rrijë mbi kokë, të na kontrollojë: “bëje këtë, mos e bëj këtë”. S’më duket se dimë edhe aq për lirinë dhe për atë se si duhet çmuar dhe pasuruar atë.

Sot, vërtet s’di ç’të mendojë për këtë. Ndoshta është më mirë të mos flas fare. Mund të jetë që gaboj. Mirëpo, duhet ta dini se i takoj një gjenerate që kurrë nuk ka fituar nga puna e vet. Gati fare. Bile, të shumtën e herëve, kemi qenë të përqeshur dhe të fyer për punën tonë, të cilën megjithatë, nuk e bënim për para. Thjeshtë, e donim atë. Pamasë. Dashuria ndaj arti është kushti i parë për të qenë artist, apo jo?”

Mesi i të 60-ve. Kosova kishte vetëm një qendër, e në të, një shoqëri të entuziastëve të cilët përgëzonin dhe prezantonin krijimtarinë burimore të këngës dhe valles sonë brenda dhe jashtë kufijve të saj. Një ansambël idealistësh, drejtoresha e tij dhe një këngëtare, pa të cilën ai s’paramendohej dot. Ndoshta kështu do të duhej filluar rrëfimin nostalgjik të dashurisë së ndërsjellë gjatë viteve mes Bilbilit të Kosovës - Nexhmije Pagarushës dhe ansambllit më të famshëm të këngës dhe të valles sonë të të gjitha kohëve, “Shota”.

“Mbajta shumë koncerte me “Shotën”. Më të mirat. Të gjitha ato të cilat kam dëshirë t’i kujtoj ditëve të pleqërisë. Zot, sa dëshira kisha të jem në rrethin e tyre. Për mua, “Shota” ishte ansambël i jetës. Po çfarë disipline ka pasur aty, çfarë pune dhe përkushtimi të pafund!... Çdo lëvizje, çdo cikërrimë ushtrohej deri në përkryerje. Sa herë që flas për këtë, më bien ndërmend udhëheqësit e mrekullueshëm të “Shotës”, Skënder Gjinali, aq i dashur për të gjithë, Nahire Surroi, e shoqja e Rexhait... dhe, hapat e saj elegantë pas perdeve, dërsia me brenga dhe vëmendje përcillte prezantimet tona para publikut.

Më pastaj, Xhemajli Berisha, me ardhjen e të cilit “Shota” merr krah, vërtet. Të gjithë e kanë dashur pamasë ansamblin dhe të rinjtë e saj. Më kujtohet, gjithnjë e kishim shprehi të mblidhemi në garderobë, bile dy orë para fillimit të koncerteve. Sa biseda, sa qeshje, sa këngë! Me “Shotën” kam udhëtuar shumë. Nëpër koncerte të mëdha, të rënda, por madhështore. Kurrë s’do t’i harroj”...

Udhëtimet e turnetë, zonja Nexhmije Pagarusha do t’i mbajë mend vetëm përmes sallave, publikut, autobusëve, trenave, aeroplanëve dhe... këngës. “Nuk kam pasur shumë sish thotë.- “Bile jo më shumë se të tjerët”.

Shpjegon se turnetë nëpër Kosovë u mbajtën shumë më vonë se sa ato jashtë saj.

Flet për kohën e “vëllazërim-bashkimit”, dërgimin e artistëve sipas çelësit nacional, një shqiptar, një serb, një kroat...

“Pas 1971-shit fillova të këndoj para publikut të Kosovës. Më kujtohet koncerti i parë. Me “Shotën”. Kishte ardhur publik nga e gjithë Kosova. U hap me këngën, “Po vijnë krushqit”... E, paharrueshme, vërtet. Isha me veshje kombëtare - fustan të gjatë e të bardhë... Atë vit vizitova Shqipërinë, që e kisha ëndërr. E atje, miqtë dhe kolegët e mi, Avni Mulën, Gaqo Çakon, Bik Ndojën, Ibrahim Tukiqin e shumë të tjerë.

S’mund t’i kujtoj të gjitha koncertet, mos më ngushtoni. Mbaj mend Italinë, Gjermaninë, Zvicrën, Austrinë, Amerikën. Janë shumë, vërtet. Bile këndova edhe në Izrael, në Tel-Aviv dhe Jaffa. Ndoshta, ai në Berlinin Perëndimor, diku rreht 1975-1976 mund të merret ndër më të suksesshmit. Bile, sa i përket publicitetit. Ishte festival ndërkombëtar i interesimit të madh. U prezantova me “Bareshën” dhe “Sytë për ty i kam të njomë”. Kisha frikë të madhe. Më kujtohet, kur, pasi këndova këngët, m’u duk sikur e tërë salla ishte e zbrazët. S’bëzante kush, për çaste të tëra. Mandej filluan ovacionet. Mbrëmje e paharrueshme. Të nesërmen u kthyem me tren, rrugëtim i gjatë dhe i mundimshëm. Një javë më

vonë morëm letër nga ambasadori, s'më kujtohet emri dhe, në kuvertë, një ekzemplar të gazetës ditore të Berlinit me fotografinë time në faqe të parë”.

Dëshirën e madhe për operën dhe solokëndimin operistik, zonja Nexhmije do ta fillojë me kujtimet e saja për ata të paktë, për të cilët muzika përmbushte jetën e tyre.

“Mbj mend se njërën nga kthinat e sallës së radios e kishim shndërruar në dhomë për prova, të cilat i mbanim pas orarit të rregullt të punës. Mbj mend dimrin e madh dhe mëngjeset, kur me një tufë drunjesh e ngrohim sallën për prova. Deri vonë në mbrëmje, aty ushtronim ariet nga “Traviata” e Verdit, “A. Perfido” e Beethovenit, “Madam Batërflaj” të Puçinit, e shumë të tjera. Të gjitha këto, të shqipëruara për mrekulli nga dora e Kolë B. Shirokës, njeriut dhe punëtorit shumë pedant dhe të përkushtueshëm.

Sidoqoftë, prezantimin e parë të klasikes e patëm në Teatër të qytetit, i cili natën e premierës ishte përplot. Më kujtohet kur Rexhoja, i cili kurrë më heret s'pati dyshuar në këndimin tim, atë natë para koncertit, më afrohet pas perdeve dhe më pyet se mos kisha frikë. I thashë të mos mërzitej fare. S'kishte gjë që mund të më ndalte. Dola dhe këndova. Pa koncertit më thanë se e kisha përfunduar për mrekulli. Ata që merren vesh në solo-këndimin operistik thonë se “A. Perfido” është arie mjaft e rëndë për ta kënduar. Më vonë e mbajtëm edhe një koncett të tillë. Dhe kjo ishte e tëra. Nuk mbeti asgjë e incizuar, asgjë e ruajtur... Kushedi ku janë icizimet, nëse janë ende. Gëlltisnin pluhur diku nëpër arkivat për të cilat nuk kujdeset askush... Çuditë se si nuk iu kujtua askujt që momentet e tilla t'i shpëtojë. Asnjëri prej nesh s'do të jetojë përgjithmonë. Bile, mudi ynë ka mundur...”

Të '80-at. Incizimi dhe paraqitja e fundit në karrierën e Nexhmije Pagarushës.

“Më duket se është dueti me Ismet Bogujevcin. Po, ishte kënga e bukur “Një tufë gërshetë...”. Ishte viti 1982, me sa më kujtohet. Ndërsa, hera e fundit që dola para publikut sarajevas. As vetë nuk e di se si e përfundova këngën. Isha nën preson shumë të madh, shpirtëror dhe fizik.”

Njëmbëdhjetë vjet më herë se dita e sotme, do të përmbillet karriera profesionale e njërës nga artistet e pavdekshme të këngës së kësaj treve - Nexhmije Pagarushës. Mirëpo, larg publikut dhe estradës, në jetën dhe shpirtin e saj do të fillojë drama e gruas - ajo mbi përkushtimin dhe sakrificën mbinjerëzore të një gjysheje që do të shndërrohet në sytë e vetëm dhe në botën e tërë të mbesës së saj të verbër. Këtu do të fillojë saga e vetmuar mbi radhitjen e viteve, të decenieve të mundimeve dhe të dashurisë së pafund për Fletën e saj, për gëzimin e jetës, siç thotë zonja Nexhmije Pagarusha. Prej këtui, skena e ndritshme e mbretëreshës së popullores sonë do të zëvendësohet me shkollat e harruara për fëmijë të verbër, me vetminë që s'përballohet, me ndërrim të vendbanimeve dhe jetë në skamje, dromcat e së cilës, megjithatë, Nexhmija do t'i kujtojë me mall të pashuar, saherë që para syve i vjen fytyra e Fletës, mbesës së saj të bukur.

Ishte ajo Nexhmije Pagarusha, Bilbili i Kosovës, zëri i parë yni, ambasador botëror i traditës sonë kombëtare dhe mbretëreshë e parë dhe e vetme e këngës së bukur shqipe.

“Koha”, 15. 11. 1995

Sami PIRAJ:

NUK KEMI NEVOJË T'I KOPJOJMË TË TJERËT

Vështirë është të gjesh dashamirë të këngës shqiptare, të cilët nuk komunikojnë vazhdimisht me vlerat riproduese të solistes sonë Nexhmije Pagarusha. Ajo mbeti sinonim i vlerës me të gjitha implikacionet, që sjell kënga. Vizita jonë e gëzoi, jo nga fakti se ka emocione që flet për gazeta e revista, ngaqë këtë e bëri ajo sa e sa herë, por ngaqë në këto kohëra të jetës paksa të moshuar, i ka ënda t'i shfaqë idetë dhe preokupimet e veta, të cilat nuk i ndan nga preokupimet e të tjerëve.

Biseda jonë ishte spontane. I erdhi keq pse s'mundi të na nderonte me kafe, meqë restriksionet e rrymës elektrike e bënë të veten. Disi si me shaka ajo na tha se kafënë megjithatë do ta pimë, po qe se do të vemi më shpesh. Si padashje biseda u ndërlihdh me fillimin e jetës koncertale, e cila në ditët e sotme rrumbullaksohet në 55 vjet. Kjo zonjë e skenës i mban mend të gjitha sakrificat që u bënë për këngën, për perspektivën e saj. Kurse sot dikush përpigjet ta rrënojë atë bukuri magjepse.

n'Art: - Zonja Nexhmije a mos keni frikë për perspektivën e këngës sonë?

- Në këto kohë të gërshetimeve të melosit të huaj në këngën tonë, jam shumë e brengosur. Jo nga fakti se muzika shqiptare mund të shlyhet nga kujtesa, por për shkak se në këto kohëra të deinstitutionalizimit të artit tonë pasojat janë fatale.

n'Art: - Mund të shpresojmë se këto shartime do të mënjanojnë shpejt?

- Dashtë zoti që kjo të bëhet sa më shpejt. Nuk bën të rrimë indiferentë. Rinia po rritet me këtë melos të gërshtuar. Kam drojë që do ta pranojë si këngë të veten!

n'Art: - Cili është propozimi juaj që t'i shmangemi kësaj dukurie të shëmtuar?

- Ka shumë mënyra. Megjithatë, në këtë kohë, kur na mungon radioja e televizioni ynë, organizimi i festivaleve dhe i koncerteve të shumta do të ketë efektin e vet. Të kuptohemi, këto programe patjetër duhet të jenë në baza të shëndosha artistike, e jo të motivuara nga qëllimet e komercializmit, siç po na ndodh me botimin e disa kasetave.

Jam dëshmitare e disa programeve që u organizuan te ne, dhe më besoni, efekti i këtyre programeve me vlera artistike ishte shumë i madh. Për shembull, përvjetori i “Kastriotëve”, që u shënua me një program artistikisht në nivel, bëri të kënaqeshin mëse tre mijë shikues. Dhe asnjëri prej tyre nuk e kërkoi këngën e “importuar”.

n’Art: - Si të thyhet barriera e masave të dhunshme në sallat tona koncertale?

- Më duket se më e logjikshme është që të gjejmë formën e mbrojtjes nga tëhuajzimi i këngës sonë, pa marrë parasysh momentin se masat e dhunshme janë dëshpëruese për ne. Megjithatë është momenti, të thuash i fundit, që të ndërmerret diçka.

n’Art: - Është interesante se këtë lloj të muzikës ka filluar ta pëlqejë edhe publiku i Shqipërisë?

- Jam e dëshpëruar shumë, posaçërisht për shkak se ata i kanë mundësitë ta ruajnë e ta çmojnë vlerën. Nuk kemi nevojë të kopjojmë askënd.

n’Art: - Si i shikoni nga kjo distancë kohore këngët e kompozuar dikur dhe sot?

- Ne punonim ndryshe. Rexhoja (Mulliçi) ishte shumë studioz. Me përpikëri i kompozonte këngët. E çmonte harmonitë e këngës. Melodia konceptohej me të gjitha primesat e së bukurës. Nuk mendonim për elementet komerciale. Dhe, si të tilla, lindën këngët: “Baresha”, “Lulëzoi fusha”, “Një lule”, “Sytë për ty i kam të njomë” etj. Ndërkaq, sot kënga shikohet nga një prizëm i biznesit.

n'Art: - *Vite me radhë "Baresha" ishte krenaria e këngës sonë popullore. Ç'kënaqëi ju ka shkaktuar kjo këngë?*

- Vite me radhë e kam kënduar në koncerte te ne edhe në botë. Në fillim është pritur me skeptizëm. Për shembull, në Mitrovicë, kur e këndova për herë të parë para 30 vjetësh, asnjë duartrokitje nuk u dëgjua, ndërkaq ajo sot e ka publikun e vet. Kjo këngë bazdimisht ka qëndruar në repertorin tim. Gjatë një koncerti në Berlin, kjo melodi është pritur aq mirë, saqë e tërë trupa jonë që në qendër të vëmendjes përmes gazetave gjermane, të cilat edhe sot i ruaj.

n'Art: - *A ka mbetur ndonjë këngë anash nga repertori juaj, e që keni pasur dëshirë ta realizoni në studio?*

- Po. Ishte kënga "Po t'përbej, pash perëndinë!" të cilën e interpretonte mrekullisht bukur Xhejlane Gutiqi. Gjithë e mbaj këtë dëshirë në vete, ngaqë e doja shumë këngën. Mirëpo, nga respekti i interpretimit të bukur, nuk doja ta prishja atë imazh. Trandem kur më kujtohet rasti i heqjes nga programi i Radio Prishtinës vetëm se përmendej perëndia.

n'Art: - *Ekziston një bindje se repertori juaj i këndimit munda të jetë më voluminoz?*

Kjo është e vërtetë. Karrierën time e kam ndërtuar ngadalë, sikur muratori ka shije. Ishte vështirë, sikurse edhe sot të kompozohet kënga e mirë. Pastaj kriteret atëherë kanë qenë mjaft të forta. Mbase këtu qëndron edhe arsyeja.

n'Art: - *Cili këngëtar yni këtu iu ka lënë mbresa me interpretimet e veta?*

- Po ai është Ismet Koshutova, me të cilin herët e kam pasur një duet. Ishte dhe është ende këngëtar i mrekullueshëm. Për shkaqe politike e mënjanuan nga skena. Do të ishte mirë që ky potencial të shfrytëzohej me realizimin e ndonjë kasete. Editorët nuk do të zhgënjeheshin e aq më pak publiku me shijen e prezantuar muzikore. Edhe Haxhi Maqellara më bënte përshtypje me intrerpretimin e këngës "Ganimete - krenaria jonë". Kjo është sikur më bënte të rrija gatitu nga respekti i tekstit dhe i melodisë.

n'Art: - *Po vlerat operistike sa ju shoqërojnë?*

- Jo vetëm sot, por gjithmonë. Nuk mund të mbetet njeriu indiferent ndaj gjërave të bukura. Ato duhet të shijohen.

n'Art: - *Thonë se edhe në turnetë e ndryshme, edhe në ndenjje të rëndomta e të posaçme, kurrë nuk keni qenë e ekspozuar. Është kjo vryrtyt apo indiferencë?*

- Gjithmonë e mbajta parasysh se prezantoja popullin tim. Kultura çmohej edhe nga ky prizëm. Tërë potencialin e shkrija në skenë, prandaj ishte e tepërt ta shfaqja edhe gjetiu.

n'Art: - *A mundet të mbetet këngëtari apolitik?*

- Në këto kohëra është e pamundur. Së paku unë s'mund të mbetem e tillë. Jam e interesuar për fatin e popullit tim dhe vazhdimisht komunikoj përmes gazetave.

n'Art: - *Cili është mendimi juaj për shtypin tonë?*

- Më bën përshtypje "Kosovarja" me një fizionomi adekuate. Më ka ra në duar edhe një revistë e re e pagëzuar "Teuta", që më pëlqeu. Më pëlqen edhe informacioni i ditës nga "Bujku", kurse komentet politike sikur shpesh nuk nevikosin, ngaqë opcionet e prezantuara nuk po i dëgjojnë të mëdhenjtë.

n'Art: - *Cili do të jetë mesazhi për perspektivën tonë, pra, për rininë?*

- Jemi në një kohë kur gabimi i një individi është barrë edhe për kombin, prandaj duhet të kihet kujdes tejet i madh në këtë drejtim.

n'Art, nr. 1, Dhjetor, 1994.

Abdyl BUNJAKU:

intervistë e imagjinuar:

KU JE MOJ NEXHMIJE!

Më në fund, pasi kërkoja në Radiostacion dhe gjetiu, para teatrit u takova me Nexhmije Pagarushën, “Bilbilin e Kosovës” si e quajtën kolegët seriozë.

- Kur i pyeta kalimtarët për ty, disa më thanë “Ah, Nexhmija” e disa të tjerë “Uh Nexhmijen po kërkon, a!

- Ah, paske takuar njerëz të mirë. Uh, - po ku u takove edhe me atë...

- Nexhmije, për ty jeta është këngë e ti çka je për jetën?

- Kurr gjë. Guri në të cilin ajo po merr në thua, por nuk po e lëndon ajo këmbën për mua po ma heq nga një copë.

- Mos thuaj se je pesimiste, se unë, mbasi nuk di të këndo, më duhet të bëj vetëqeverisje. Ma thuaj një këngë të përpunuar, jo nga Lorenc Antoni prej teje?

- Pa gëzim po shkoj në punë...

- E çka të bën të lumtur pra?

- Shëndeti.

- E unë, e shokët e tjerë që ke...

- E po ty nuk po të shkruan në ballë se më ke shok, se je njeri i mirë. Do të ishte mirë, bre vëlla, në letërnjoftim të shkruante rubrika ç’njeri është? Atëherë lehtë: kur të njoftohesh me dikend më para ja kërkon letërnjoftimin...

- Pak modë: si e ndien veten më mirë, me dimi, mini apo maks?

- Pa asnjërën. Me pantallona.

- Pse po mërzhitesh kur je shëndosh e mirë?

- Se në rrugë po takoj shumë buzëqeshje artificiale.

- Çka ka lidhje “qentë lehnin e anija lundron”.

- Varet ç'qen lehin. Nëse lehin qentë e mëdhenj ose shumë sish, nuk të lanë të flesh rehat.

- Kam dëgjuar se në Shqipëri të kanë pritur shumë mirë dhe se kënga jote kënaqi zemrën e publikut?

- Këtë mos e shëno në gazetë se të gjithë atyre që thonë “Uh, Nexhmija” u pëlçet zemra...

- Nexhmije. Dr. Ali Sokoli përdor atë fjalën “mos u bafsh me të qajt Rahoveci”. Atë nuk e pyeta çdo të thotë kjo, por më trego ti mbasi edhe ti je e asaj ane...

- Pyete Aliun se ai e di më mirë mbasi ai ka takuar shumë intelektualë tanët, të cilët i prishën mushkëritë duke rrahur gjoks se janë dikush. Ata janë bërë për t'i qarë Rahoveci...

- E ti çfarë mushkërish ke?

- BO

- Një gazetar më tha se dëshiron të bëhet dush e ti të lahesh nën të?

- Kurrgjë puna e tij. Unë lahem në kadë.

“Thumbi”, 1972

Letrat - respekt dhe dashuri

Asnjë letër nuk mund të veçoj, të gjitha i kam të dashura.
N. Pagarusha

X

Nexhmija ishte e adhuruar nga të gjithë, pa dallim moshe, kombi e gjinie.

Ajo mori shumë letra me përmbajtje të ndryshme, që shprehin respektin dhe dashurinë ndaj idolit të tyre - Nexhmijes.

Vetëm për dy muaj ajo mori mbi 100 letra.

E dashurua Halla,

26.03.88

Shumë gjam gjyq që kam a kam marë lëtin lëndë,
shumë fatimindëtinë. Këtu, kam gjoni miri, në
fund të të jani, kam qeshim shëllori as diti.
Ka këta mabë dëllë dhe vire, që ljen shis tani
kolin. Veq çaki diti me pasi diti kam miri
për tani. Shumi e ka ^{marë} edhe një shqiptari për
shpirtin e vet. Është dhemi shumë me paki në a para tëz që e ka ho.
E para hazi, mabë ka mujt, me që për shkatërinë që e ka dhimit. Tëll, me
miri shiti.



Halla gjoni, kur që mendoni me me ardhë në shpi kista? Është qeshim
kacii, shqiptar të lëtin halla. Në me diti a miri me peshon në ngjellë..
Babi shiti të punon shumë, të i shpirti qishat me të optik, pi pastion.
Edhe s'maf shiti punimi mabëti.

Si gjoni tani? Qishat, kaka Tikit, Bakani, shqiptar, të atë.

E kam të një kakt që e jani, kam këtij, e ardhë me punon me mi për
dashurinë, ka shani që e kam miri.

Shpirti si gjoni të kështu shka gjoni të shku me mabë për shkatërinë shqiptar
shumi miri, për shkatërinë e për fletë.

Edhe gj diti komi me e marë notat në shkatërinë.

A për punon miri Marjati? Përfaqë shumë qishat. Si shiti bika, shiti?

Mirëza ka me shku me shkatërinë me majon maf për a jani, në "puna
në marë shumë a bika në shkatërinë.

Shpirti që ka me në shku shqiptar, për a punon lëtin lëndë!

Tani me që bojim të futa,

gite jani,

Aida

U.S.A. Detroit, Mich.

Nov. 7, 1969

Postovana Narodna Umetnicë
 Za pluć 'Diskos' sam se oslušan
 Vaš glas, pošto albanški 'Gazetë
 nerrazumijem, ipak me šalio
 da razumijem 'Gjepatë vashë
 Shana: 'Gjepë vashë upuejëm
 onjë s'dacëm pështitkë 'Këllë
 vashë onjë pëpëjë a vashë
 'Këllë, 'Këllë bish d'më
 p'ueta o s'bi 'Këllëzëtë
 Po onjë q'cinorë d'ostarëtë mi
 vashë 'Fotografijë, 'Primi të
 onjë Sht. 'Pogjave
 Tony Validzic Sr.

Oho, s'kur të isha s'boritë
 post - kista për të 'në kështu p'ovin mi të s'kur
 në bote! 'S'kuritë repënjit të tëllëzëtë ato mo-
 mente i kam incirua repënjit të 'Videës reu-
 s'oritë në 'Videës kësht' oho, 'Gj'ë të mi 'Shëpëjë
 si 'qelës i musijës tonë - 'Shëpëjë - 'Kështu për 'Gj'ë
 'mijësitë q'ë të mi 'qelës i musijës tonë 'Shëpëjë
 në 'Videës reu-s'oritë na me në hapë për musijës me
 'Nëshëpëjë tonë!

Mjafton të përmendet emri Nexhmije Pagarusha dhe të kujtojmë një kult të legjendës së këngës, e cila hyri në këngën, gjatë dhe shpirtin tonë. U mirthërua në qenien këngës, vajin dhe aspiratën e motit tonë në të përditshme. Në kopëtimin e blerur, mirëkorrë muzikës bozhurë të këngëve shpirtërore-krenare.

Ndërhat e njohjes epitetet e kohës që ia vunë: «Bilbili i Kosovës», «Tempulli i këngës», etj. emri i saj është rritur dhe dëshirë e pasur e sotrisë sonë muzikote. Ajo që shkruaj tërë qenien e vet në këngë, edhe vërtet mbeti këngë e përjetshme. Tash bëri i saj po dëgjohet pak në radio dhe pak po emetohet në emisionet e TVP-së. Athua

kaq shpejt harrohet arinat e tyre, që kanë vull të pajshyeshimë në artin tonë muzikor? Përkundrazi, Nexhmija nuk ka haruar as sot, as nesër, as kurri, por na ka harruar motin dhe shëndetin e saj, që sigurisht ajo ma kujtojta; për publikun nuk mund të këndoje më.

Është e vërtetë që kompetencitë e radios dhe të TVP-së të shtojnë një emision dokumentar apo të organizohet një koncert solistik përshëndetës nga publiku. Fund-fundit ia kemi bërë t'ia plotësojmë një dëshirë jetësore: tempullit të këngës sonë.

Marrë nga OSMANA, Istog

*Edhe pse për fat të keq nuk mujeja
me i përcjellë, përves të lehtërisht, prop
sive mbeti që merak. Jo pra, nuk pati
se pre të më mbeti, pari që lamë dilemë
nëverimë ma komentuen studentat në shk-
vllë. Secili flinte dhe spjegonte atë emis-
ion muzikore duke e ngritur në superlativ*

Ja çka i shkruaj Nexhmije
Khamaj Dukoçka nga
Bosnaka Dubina:
Qëllim i përcjellë ka
doris t'ua, kur i kam pasur
30 vjet, jam botuar an-voj
shtit t'ua ka paguar me
armin Nexhmija. Ajo më
ka mbetur 8 vjet dhe fu
litar, uosë kam mundësi
ta vjetit.
Shkruajto Marina nga Ber

lloga i shkruaj Nexhmijës që
ta rrethit.
Me shkruaj t'ua edhe
na mburrenit. Me shkruaj o
shoqe! Shpesh bisedojmë
për shëndetin e t'ua mbet-
ur dhe t'ua. Tash dhe sho-
kë e shoqet e mija ju ndih-
vojsh pa rindë.
Nexhmija marrë letra nga

adrenasit e saj të panjohur
të prej ~~Shkupit~~ Sarajevit, Hamburgut, Pe-
tës, Beogradit, ~~Shkupit~~
dhe vendave të tjera. Këtë
ta, ku edhe ka që ka letra
e vota i shprehin ndanjal-
tas fashinë.


Jam e këmbës për bukurin tuaj që aspak nuk
 kemi nderskuar, por gjithë një zëri duke u shkruar.
 Gjalpënderit prej gurë që kurrë nuk
 e kurrëvet as atomin e lëndës duke e vërtetë
 një këmbë bur për jetëtim më një gjell epokë,
 gjithë që dot jet legend e një gjeneratë bur
 jetuat që mose mose e mose mose gjuve.
 Per gjuve munde të shkruaj edhe kushte din se
 sa libra, por për përfundoj këto letra duke
 ju dëshirua gëz të mirë e lumturie më jet.

**TE FALMËNDERIT
 NEXHME!**

Pa e përfunduar këtë letër lutej për jam si njëqind që kish
 arritur në këtë kohë dhe shkruaj këto që më shpirtit për
 këmbës imaj mose dy varijet të Kështjës Elamendit

Kurr këndon shkruaj këndon malli e këndon këmbës
 Kurr këndon një shkruaj këndon këmbës e këndon këmbës

si je molla molla molla molla të shantë imaj Selatit nja
 molla molla molla molla



Nexhmija dhe "Lidhja" e saj
me vendlindjen

XI

Nexhmija është e lidhur ngushtë me vendlindjen - Pagarushën. Por, megjithatë nuk arrin që ta vizitojë shpesh. Është krenare që i takon një fshati bujar dhe fshatarët e donë shumë. Sa herë që gjendet në mesin e tyre, derdh shumë lot gëzimi e përmallimi.

Kohë më parë Nexhmija pat marrë një iniciativë që, në vendlindjen e saj, të formohet një bibliotekë. Atëherë pat thënë: “Meqë s’kam bërë pothuajse asgjë për vendlindjen time, lutemi që ju shkrimtarët, të më ndihmoni që, në fshatin tim të lindjes - Pagarushë, ta formojmë një bibliotekë, me ç’rast do të organizohej edhe një manifestim”.

Një ditë qershori 1990 Nexhmije Pagarusha - Bilbili i Kosovës, u gjend në çerdhen e vet. Në atë takim solemn, shkolla tetëvjeçare e fshatit Pagarushë, “Jera e re” (tani Vesel Pagarusha) u bë me bibliotekë në sajë të angazhimit të solistes sonë të mirënjohur.

Në Pagarushë atë ditë ishte atmosferë e këndshme dhe prekëse. Në shenjë falënderimi e respekti asaj iu dhurua “Sofra e demokracisë”.

“Të faleminderit, Nexhmije! Lum ne që të kemi”, thanë fshatarët e urtë të Pagarushës. Kurse Nexhmija, e përmalluar, u dëshiroi atyre përparim edhe më të madh, ashtu si edhe i ati i saj, Vesel Pagarusha.

Kushtuar pishtarit të dritës e mbretëreshës së këngës

(*VESEL E NEXHMIJE PAGARUSHËS*)

Krismë mbet emri juaj, baba e bijë, që skalitët një emër. Emrin e Pagarushës, emrin e shekujve, emrin e krenarisë sonë. Ajo kodër rrëzë bjeshkës, që qëndron si përkrenare e këtij fshati, Vesel Shaban Pagarusha. Jetoj në netët e gjata polare, kur kësaj Malësie i vinte era tym e barot, kur rrëbeshe kohe ranë mbi ne. Ai deshi ta shkruante historinë tonë, jo si tregimtar, po me shkronja të arta. Ata i thanë që po thonë edhe sot, se historia juaj nuk shkruhet, po lahet me gjak. Burri i kësaj Malësie përgjigjet me të madhe: “Në qindra herë lamë me gjak historinë tonë, qindra herë ngritëm murana, ndërtuam qindra kështjella eshtrash, prandaj dua t’i derdh shkronjat e gjuhës së nënës mbi historinë e popullit tim”. Betimin e dha m’u para atyre gurëve mijëravjeçarë, ku historia jonë gjenë gjurmët e lashtësisë. Sa më të rënda që bëheshin prangat e jetës, aq më i fortë bëhej Malësori, duke vazhduar rrugën e krenarisë sonë. Jeta i shtroi për para dy rrugë: ose ta shkruajë gjuhën e nënës, ose të heshtë para ugruzinjve shumëfish mizorë. Po Biri i kësaj Malësie, me mprehtësinë e shpatës, zgjodhi të parën: të shkruajë dhe vetëm të shkruajë historinë e popullit të tij. I thanë e ç’ nuk i thanë. Po Ai ecte, me lahutën e tij të mprehtë grisi perden e atyre netëve të gjata.

Juve mbretëreshë e këngës, Juve, o bilbil i Kosovës me lahutën e babait jetik i këndove këngët e pakënduara, që i mbante të fshehura m’u në zemër yt atë, e ju ia kënduat rinisë, ia kënduat popullit. Ato libra që na ke sjellë për fëmijët tanë janë rreze drite, është pena e babait tënd, e birit të kësaj Malësie. Porosinë e babait me nder e kreve. Populli dhe rinia e kësaj ane është betuar se një ditë eshtrat e Birit të vet, do ti ngrerë në një kështjellë krenarie! (R. Kryeziu).

Një ditë e rëndomtë
e Nexhmije Pagarushës

XII

Si duket një ditë e Nexhmijes në këto ditë të “vetmisë së madhe”. “...Ditët e mia janë gati të njëjta, nuk kanë fare specifikë, faktikisht janë të njëtrajtshme. I kam disa miq fqinjë, që më vizitojnë edhe në këtë kohë, kur nuk e dimë a do të zgjohemi nesër apo jo.

Sot jam zgjuar diku në orën tetë, pak më vonë se rendom. Mbrëmë kisha mysafire mikeshën time të dashur Liliana Çavollin. Liliana në mëngjes më disponoi mirë, sespe ajo edhe ashtu, nga natyra, është më e disponuar dhe di të krijojë një atmosferë optimiste. Sot vërtet ishte e mrekullueshme. Pastaj erdhën fqinjë të tjerë, me të cilët biseduam për gjëra të ditës. Që nga ora 12, e mbetur vetëm, rashë në gjumë. Me t’u zgjuar, duke mos ditur çfarë të bëja, mora ftesë nga disa miq. Mysafire isha në një familje, në të cilën dominon moshë e rinisë. Vajzat hetuan se jam e padisponuar, thuj si zakonisht dhe nisën të vallëzojnë duke krijuar atmosferë të këndshme. I falënderova se kalova bukur.

Shpresoj se sonte do ta kem një mysafire e cila edhe do të bujë. Ajo është një vajzë e cila nënën e ka në spital dhe bësoj se edhe sonte do të kalojë mirë. Sot mora një lajm të gëzuar: Më telefonuan nga Ferizaj dhe më njoftuan se një çmim i Festivalit tradicional, “Kosovarja këndon” që mbahet në këtë qytet, tash e tutje do të mbajë emrin tim (Nexhmije Pagarusha). Jam e lumtur dhe i falenderoj të gjithë ata që më nderuan në këtë mënyrë.”

Bilbili që (më) s'këndon dhe aktron

XIII

Artistja s'mund të këndojë më, perdja, por nuk i lëshohet dot, lëshohet inçizimi dhe të bëhet se Nexhmija ia thotë vetë, "Bareshës"... Ohoja, me shikimin e saj, po lufton me kohën. Megjithatë, ajo e vë kontaktin shpirtëror me artin dhe publikun, ashtu pa zë, me qëndrimin dhe me gjallërinë e vet kreative. Arti i është mishëruar me trupin. Ndalni magnetofonat. Arstisja po këndon, po e ndjejmë, e di rrugën e vet, edhe sikur të shurdhohen të gjithë njerëzit (Bet'hoveni i shurdhër qe, kur kompozoi veprat më të mira!). Nexhmijen e ndjejmë edhe sikur të pushonin të gjithë altoparlantët! Zëri i saj gurëzohet në bebëzat tona si një skulpturë.

- Motër, po t'i pse i fsheh lotët?

- Qajta pa dashje, kënga është e tillë.

Nexhmija nuk aktron, nuk improvizon, dhimbë. Ajo e ndjen atë thellë, sikur qan e qesh bilbili.

- Po bilbili a di aktrim, a i njeh këto ligje? A di improvizime? Jo, ai "qan e qesh" pa hile, këtë e ka dhunti natyre, pjesë të shpirtit dhe të mendjes...

Këngën nuk e kishte vetëm profesion, e kishte gjuhë të veten të veçantë. Këngët e Nexhmijes ishin piktura me të gjitha tonet, me vijat, me përmbajtjet, që i ka një pikturë-dramë. Por, mosha, ah mosha, e shtyn Nexhmijen të ndahet nga kënga që e kishte pasion, dashuri, jetë...

Por, reputacioni i saj i begatë, do të mbetet i pavdekshëm. Nexhmija u "shkri" për këngën dhe u betua në këngën, prandaj Nexhmijes i kemi "borxh të gjithë". (H. Matoshi).

Dyzet vjet më parë, cicëroi Bilbili. Dhe kurrë më nuk zbriti "prej degës së artë". Dhe dyzet vjet më vonë, ç'tragjedi: një natë gazmendi, të gjithë këndojnë ajo hesht! S'barti bjeshka shtresa

bore sa shpirti i saj duartrokitje. E quajtën me njëmijë emra. Dhe ishte pak. Kënga e saj-furtunë. Zëri i saj - tërmet. Zemrat dridhen. Bebzat lotojnë. Ajo këndon...

S'pritti lutje: këndo! Këndo! Jeta ishte pentagram, notat nga brum i zemrës. Për zërin e saj thuren këngë. Vetëm për fytin e saj. Dhe përsëri ecën nëpër tokë. Nuk dëgjon "thirrjen e perëndive" për t'u ngritur në lartësitë ku e kanë fronin ata që "lindin njëherë në shekull".

Prej gojës i rrjedh mjaltë. Ngjyen bukën edhe në kripë e ikën prej "treyezve mbretërore". Shpupurit pluhurin dhe i mbyll sytë prej dritave që ndezen "për talentët jashtëserialë". Kudo që shkoj më shoqëron: "Një lule që kam unë..." Dhe dimër e verë: lule. Dyzet vjet s'është vyshkur. Era - këngë.

Flokun të heshtur e mbi kokë secili ia sheh kurorën. Krehu çdo tepricë prej trupit. U skuq prej duartrokitjeve. U mundua t'i shlyej emrat e mëdhenj, që i meritonte plotësisht. Dhe, pas endjeve, kurorëzuar me lavdi, kthehej aty ku kishte nisur këngën. E pritën skenat e mëdha: bota ishte e saj. Në rashtë vendlindja e në zemër-njeriu. Ata që mendojnë për sot e nesër, ata që ecin në tokë, pyesin shpesh: "A fiton shumë?" Ajo përgjigjet e skuqur. "Le të ngelë kënga, për ardhmëri..."

Të tjerët palojnë - ajo këndon. Të tjerët fitojnë - ajo përsëri këndon. Gëzim e pasuri - kënga. Ardhmëria, që ia ngjesh vetes bukën, kripën e këngën. Mjafton t'i shkëlqejnë sytë diamante. S'është pak nga buzëqeshja të derdhen margaritarët. Pasuri e përherëshme - kënga.

Po motet që i rëndoj plumb këmbë e kurriz? Di mirëfilli: kënga s'plaket kurrë. S'ka tjetër në jetën e saj: të thjeshtë fare. Dhe shpesh mendon: për vendin, për vendin që do të zbrazet një ditë në skenë. Di që vendin e ka në zemrën e njeriut. Harresat s'plaken. Emri i saj, çdo germë shkruhet me të mëdha. Gjithmonë.

Hak s'mori asnjëherë. Borxh s'i ngeli askujt. Këngës nderim: në shumë gjuhë. I thoshin "poliglote". Buzëqeshte dhe përgjigje:

“Kënga ka një komb e një fe: melodinë!” Për këngët e saj pentagrami “fryhej e rëndohej” prej lartësive për një zë të artë. Çdo kopjim të stilit të saj, s’kishte ngjashmëri me jetën. Ajo ishte: në vllug të jetës.

I kujtohej e vjetra: “Bilbili këndon edhe mbi ferrë edhe mbi degë të beharit! “Publiku i saj - populli. Kënga e saj - dhuratë për të gjithë. Pa ekskluzivitet. A ishte ecja e saj për një shteg ku ecëm të gjithë që bartim shpirt, pa kontratë në kohë të cakutar? Shtyrjet ishin të kota: iku prej lartësive. Dhe ngeli përgjithmonë në mesin e njerëzve.

Një xixë prej prushit të cigares ia ndez bebzën, lotët gurrë para digës së granitit. Dikush qan. Ajo hesht. Dhe përsëri, të gjithë këndojnë. Ajo hesht. Natë e shkurtër e gazmenti i madh shumë. E bekoj kohën dhe i nëmi vitet. S’kanë të ndalur. Si prej ferrit buron një gjëmë: “Ajo po hesht!” Të gjithë këndojnë. Dhe e vërteta shqyen zemër e mushkëri: “Nuk këndon më!”

Ëndërr e rëndë!

Jo! Më përmbys zëri i tmerrshëm: “Nexhmije Pagarusha s’këndon më!”

Kënga e saj: mbi supet e shekujve. (M. Shehu)

“Do të vijnë (dhe erdhën) pas saj këngëtare të reja, edhe do të vijnë (dhe erdhën) pas këngëtareve të reja këngëtare më të reja... - do të mund të kish thënë Poeti në atë këngën e tij të njohur “Do të vijnë pas nesh fëmijët tanë, edhe fëmijët e fëmijëve tanë...”

Por një qe dhe mbeti, atë ditë e sot, Ajo: Nexhmije Pagarusha e mbiquajtur “Bilbili i Kosovës”, Ambasadorja jonë e vetme e kulturës dhe e emrit tonë asokohe nëpër botë. Me disk të saj edhe në “Lafajet” të Parisit. Nexhmija nuk këndon më, por zëri i saj i bukur e i ëmbël është i papërsëritshëm, i pavdekshëm dhe gjithmonë i ri”.

(R. Kelmendi)

I lumtur dhe i madh duhet të jetë një popull që ka dhënë një këngëtare të tillë - Nexhmijen, bilbilin e (pavdekshëm) të Kosovës.

“Unë po shkoj. Ju të rinjtë mos keni asnjë punim shkencor, a publicistik pa një rezymë në gjuhë të huaj. Bile titullin e punimit duhet ta keni në gjuhë të huaj.

Kemi bërë mjaft në këto vite dhe kemi menduar se bota do të vijë ta mësojë shqipen, por bota sot nuk ka kohë për këtë.

Ne duhet t’ia plasojmë botës atë që kemi bërë, sepse ajo (bota) nuk ka kohë të merret me ne pa e bërë ne, vetë, këtë punë...” (E. Çabej)

Summary

XV

**NEXHMIJE PAGARUSHA
THE QUEEN OF THE SONG**

Who would have ever heard of Pagarusha village if it wasn't (the shepherd" from this village, Nexhmije Pagarusha, who left the herd in the meadow and headed towards her fame - just like a hind!

Her talent blasted in the mountains of the village and she broke the wild habits of the borough in order to appear in front of a microphone one day.

Her songs (being autodidact) soon became widely popular, enriched and thus took the perfect form!

Who would have thought that from a village such as Pagarusha, a talent of music would have been born. She, with her gifted voice, will soon gain the epithet "The Kosova Nightingale"?

The wild customs the village would have thrown her in oblivion, but, her father Vesel, a teacher by profession, was the one who guided her into victory.

Vesel endured all the ironic pathos of the then provincial fanaticism, and gave his loving daughter "the right" to go on stage! He together with Neshmie outlived. Vesel, being one of the first teachers in the region, will continue to teach and bring up new generations of scholars, whereas, Neshmie with her songs conquered the hearts of many fellow countrymen.

She who once sang the pretty wedding songs will later reach the opera stage.

“The disgraced girl”, as the fanatics from her village used to call her, during the fifties, together with Zyhra Mula, Melihate Hasani, Vera Shahta, created the “from team” of women public singers. The color of her voice will attract the attention of many successful composers of the time.

With her songs “Njw lule” (A Flower); “Lulëzoi fusha” (Blossomed the Field); “Metelikun ta ka dhënë” (I Gave You the Golden Coin) and especially “The Shepherd” she won all possible first prizes. Precisely, at this period, she would try singing at the opera. She will perform “Fidelis”, “Traviata”, “Madam Butterfly” etc.

Performance, diction and warm interpretation of Nexhmie left unforgettable traces in the Albanian history of popular music.

Alike, Tefta Tashko, Marije Kraja, Naile Hoxha, Vaqe Zela, Nexhmije Pagarusha will become an ambassador of the Albanian tune in many European metropolises. She will increase the Albanian beautiful tune high and would promote it and carry it everywhere.

Nexhmie Pagarusha would try to perform on the stage and she would successfully participate in motion picture. But, the song remained her best skill. She was born to sing. She would sing for forty years without intervals. Her aged separated her from her beloved profession, but her rich reputation will always remind us of her. We feel the music life of the Albanian culture would in general remain poor if there wasn't a Nexhmie. She gave herself away to the singing, and she is the only one that could tell us how difficult it was to retire from it.

We have fastened her song tightly into our hearts and keep them safe. Nexhmije Pagarusha, “The Kosova Nightingale” will carry this epithet proudly, and we will honor “the queen of the song”.

Albumi



*Shokë të profesionit dhe të jetës:
Rexho Mulliqi dhe Nexhmije Pagarusha*



*Nexhmije Pagarusha me bashkëshortin (e ndjerë)
Rexho Mulliqin dhe djalin Leonardin - Lerin*



*Një kujtim nga jeta familjare e bashkëshortëve
Rexho Mulliqi dhe Nexhmije Pagarusha*





*Nexhmije Pagarusha, interpretuesja e shkëlqyeshme
e kompozimeve të Rexho Mulliqit*



*Nexhmije Pagarusha dhe
Rauf Dhomi, kompozitor*

*Ndërrim gjeneratash
ose vazhdimësia e
këngës së bukur*







*Muzika ishte bashkëudhëtare e
jetës sime: N. Pagarusha*





Portret artisteje






Nexhmije Pagarusha dhe këngëtari Arif Vladi



Shaqir Foniqi, Nexhmije Pagarusha dhe Arif Vladi

*Shaqir Foniqi*

Literatura

- Ali Podrimja, Duel i heshtur në mes të krijuesve, Rilindja, Prishtinë, 24. VII. 1971, f. 11
- Baton Hazhiu, Mbrëmje me Nexhmije Pagurushën, Koha Prishtinë 1995, f. 41
- Bajram Sefaj, Një pllakë që nuk është vetëm e gramafonit, Flaka e Vëllazërimit, Shkup 27. IX. 1974, f. 28
- Dukagjin Gorani, Blues për "Bareshën", Koha 1995, nr. 48, f. 37, 41
- Gani Dili, Këndoj me gjuhën e shpirtit e gjithë neve, Kosovarja, janar 1989, f. 14. 15
- Ibrahim Kadriu, Dua të këndoj e të jetoj me këngën, Rilindja Prishtinë, 27. XI. 1971, f. 12
- M. Limani, A. Zogaj, Njëtrajtshem, me vetminë, Zëri Prishtinë, 4 mars 1995, f. 22
- Maksut Sheu, Të gjithë këndojnë: ajo hesht! Rilindja Prishtinë, 25.IV. 1987 f. 10
- Maxhide Hasani, Zëi që nuk harrohet, Ora, Prishtinë 11. IX. 1991, f. 32, 33, 34
- Maxhide Murseli, E lumtur jam, Kosovarja, nëntor 1971, f. 23
- Mehmet Emërllahu, Drama e kafshoja terrin në fazën e fundit, Rilindja, Prishtinë 1978, f. 2
- Nadira Avdiq-Vllasi, Perdja pas koncertit të fundit, Forumi Prishtinë, 1994, f. 12, 13
- Natasha Lako, Shqipëria e re, Tiranë 8 mars 1973, f. 21

- Pandi Bello, Skena dhe ekрани, Tiranë, 1989, f. 29
Rajko Gjurgjeviq, Në Tiranë tregohen vice, Duga, 1987, nr. 345,
f. 46, 47
- Ramiz Kelmendi, Nexhmija në Galeri "Lafajet", Rilindja,
Prishtinë, 1965
- Ramiz Kelmendi, Kur këndon Nexhmija, Flaka e Vëllazërimit,
Shkup 1975, f. 7
- Sami Piraj, Reprodukimi dëshmi e nivelit artistik,
Rilindja, Prishtinë, 30. IV, 1, 2. V. 1982, f. 15
- Sabedin Haliti, Nexhmije Pagarusha - shpërblimi për aktim,
Rilindja, Prishtinë, 26. V. 1978, f. 12
- Shyqri Galica, Kur Bilbili kthehet në çerdhën e vet, Rilindja
Prishtinë, 17. VI. 1990, f. 13

PASQYRA E LËNDËS

<i>Në vend të parathënies</i>	5
<i>Nexhmija çfarë nuk e njohim</i>	17
<i>Aforizma të Nexhmije Pagarushës</i>	19
<i>Kënga - dashuri e përgjegjësi</i>	21
<i>Ansambli “Shota” dhe Nexhmija</i>	35
<i>Nexhmija - aktore</i>	43
<i>Thanë për Nexhmijen - Fenomenin e muzikës sonë</i>	49
<i>Nexhmija në penën e krijuesve</i>	65
<i>Nexhmija në intervistë</i>	93
<i>Letrat - respekt dhe dashuri</i>	135
<i>Nexhmija dhe “Lidhja” e saj me vendlindjen</i>	141
<i>Një ditë e rëndomtë e Nexhmije Pagarushës</i>	145
<i>Bilbili që (më) s’këndon dhe aktron</i>	149
<i>Summary</i>	155
<i>Albumi</i>	159
<i>Literatura</i>	171

CIP. Katalogimi në botim - B.K. Tiranë

Foniqi, Shaqir

Nexhmije Pagarusha, bilbili i Kosovës ; Red. Skënder Hasko - Tiranë : Toena, 2003

180f. ; me il. ; 20 cm.

ISBN 99927 1 695 9

1. Pagarusha, Nexhmije për atë

78.071(=18:497.115)(092)

929(=18:497.115)[Pagarusha, Nexhmije]

Formati: 61x86/16

Shtypur në Shtypshkronjën TOENA

Tel: (355) (4) 358 539

Tiranë, 2003



NEXHMIJE PAGARUSHA ka një zë të jashtëzakonshëm: i ngrohtë, i ndieshëm, i dridhshëm. Te asnjë këngëtare nuk kam hasur cilësitë që ka Nexhmija. Mundësitë e saj janë të pakufishme. Ajo është një artiste e madhe dhe talente e rrallë.

Nexhmijen nuk do ta krahasoja me asnjë këngëtare, sepse mendoj do ta fyeja. Ajo është unike. Me dëshirën më të madhe do të vihesh në kontakt me të. Do të isha shumë e lumtur sikur të përkthehej dhe të adaptohej në gjuhën shqipe diçka nga repertori im dhe ta interpretoje Nexhmija.

Çmimi: 480 lekë
3.5 €

BOTIMET TOENA
ISBN 99927 1 695 9